

KOÇO
KOSTA

ata të dy

e të tjerë

NOVELE

KOÇO KOSTA



Ata të dy e të tjerë

Novelë..... e thyer

SHTËPIA BOTUESE ENCIKLOPEDIKE
TIRANË, 1994

ATA TË DY E TË TJERË

1

Ky tjetri ishte i shkurtër, i rrumbullaktë, i shëndetshëm. Dhe kuqo. Me mosnë të arrirë, po i parritur në trup. Veç i rrumbullt, tërë tul. Flokët i ka të rrallë, të bakërt, diçka si të zbërdhylët dhe të rënë krejt sipër te balli i bërë si kupë gjizë e parë përmbys. Duart i ka të mbushura dhe të shkurtëra, veçanërisht gjer te bërrylat: fare të shkurtra.

Tek ai gjithçka është e shkurtër.

Tërë dimrin dhe ca kohë në pranverën e parë mban të veshur një peliçe që dikur është shitur në dyqan me emrin fëshfëshe kafe, po që ai, siç duket, e ka përdorur gjatë në gjendjen e parë si *pardesy* dhe pas ca vjetësh e ka çuar te një rrobaqepës privat dhe e ka kthyer në *peliçe*. Sigurisht, rrobaqepësi e ka shkurtuar, i ka qepur përbrenda copra të rënuara bataniesh dhe pastaj e ka zbukuruar me basme jeshile të ndarë në kuadrate me viza të verdha. Ky është astari. Kur fleta e *peliçes* është e zbërthyer përpara, era e hap dhe astari ngjan me të vërtetë i bukur. Atë kohë ndodh një hop i beftë: një kontrast i freskët.

Në dimër, në shtëpi, ku do të dalë përjashta, ai thërret: *Më sillni peliçen!*

Kështu ai ngjishet mirë brenda peliçes, mbërthen të dy pullat e para të qepura fort dhe ul kokën e shtyn duart në xhepa. Dhe, cili dëshiron, mund ta shikoje tek ecën në shëtitore, domethënë anës shëtitores, njeriu i shkurtër i qytetit me ato shpatulla tërë dhjamë, që lëvizin me pakëz mundim nën peliçen e ngjeshur.

Edhe peliçja është e bakërtë e dalëboje dhe një aktor i qytetit tonë, sa herë që e përball, duke ecur më këmbë, i thotë gati papritur:

- Po ti, pse ke dalë nga akuariumi?

Njeriu i shkurtër, i rrumbullaktë si fuçi e bërë me zemër të ndezur nga trung mani, Aktorit të estradës i ngjan si një peshk i kuq dekorativ, nga ata të cilët tek ne disa kanë vullnetin e mirë t'i mbajnë diku në dhomat e pritjes në akuariume.

- Peshk i kuq, - thotë Aktori, - pse ke dalë nga akuariumi?

Peshku i Kuq nuk mërzhitet. Ai buzëqesh dhe faqet e fryra i kuqen akoma, dhe qeskat e varura, si mollëzat e gishtit të vogël, gjithashti u kuqen.

Unë sapo jam transferuar në këtë qytet bregdetar. Në mbrëmje dal dhe e kam bërë zakon që të shëtis anës detit apo të ulem e të pi një kafe në lokalin e turizmit. Vetëm fare pak ditë e piva kafën fillikatisht. Pastaj, përnjëherësh, njëri pas tjetrit, dolën të njohur ose njerëz që dëshironin të njiheshin apo të pinin kafe me mua.

Sakaq u bëra person i njohur në atë lokal. Çdo pasdite uleshja atje për të rufitur një filxhan kafe, apo diçka tjetër sipas rastit. Po tani s'ulesha më i vetmuar.

Kisha vënë re gjithashti se në një tavolinë tjetër, në një vend pozicional, vazhdimisht, për gati dy orë, çdo mbrëmje, ndodhej atje edhe njeriu i shkurtër, të cilit Aktori i estradës i pat vënë nofkën Peshku i Kuq.

Nuk ia dija emrin, sepse gjer atëherë s'isha takuar asnjëherë me të. Dhe ai asnjëherë s'kishte treguar ndonjë dëshirë që të dredhonte për t'u ulur në tavolinën time. Cuk.

Por ai kurrë s'ulej vetëm. Qëndronte atje me një djalosh tjetër, që vishej me shije me elegancë.

Ai djaloshi që i pashëm. Kishte fiokë me të vërtetë të admirueshëm në ngjyrën e gështenjtë, me diçka në okër. Dhe ballë të bukur. Një ballë pa fjalë, të veçantë, fytyrë shprehëse,

veçanërisht sy shprehës dhe mollëza të kërcyera që s'ulërinin, por që e bënin më të hijshme fytyrën re tij me hundën e drejtë dhe buzët e trasha. Fytyra e tij e bukur është rekomanduese, e heshtur. Ajo fytyrë më rekomandonte dikë: pikërisht atë.

Ai vazhdimisht qëndronte i ulur me kujdes dhe kapardina e qepur me shije s'i bënte asnjë rrudhë. Golfi me rripa horizontale; të gjetur e të kombinuar me ngjyra të ngrohta, ngjalle, së bashku me veshjet e tjera të trupit, një përshtypje të mirë. Busti i tij, që dilte mbi tavolinë, ishte i bukur.

Përskaj tij gjithmonë do të ndodhej tjetri: njeriu i shkurtër i rrumbullakët. Midis, mbi syprinën e tavolinë, pranë secilit, kishte nga një ëmbëlsirë dhe nga një gotë me verë. Po më shpesh ata mbanin përpara nga një gotë me ponç. Vetëm nga një gotë me ponç. Atë gotë dukej se e trajtonin me kujdes: e ngrinin me elegancë, pinin pak dhe heshtazi, me lëvizje të matutra pa teatralitet, e ulnin në tavolinë. Gota me ponç qëndronte e pazbrazur plotësisht gjer në fund, gjersa ata të vendosnin që të ngriheshin. Djaloshi i Pashëm dukej se e preferonte ponçin. E preferonte jo si pije, po më tepër ndofta si një lëng të hedhur në gotën me fron të lartë dhe me ngjyrë që zbukuronte tavolinën. Vërtet, ponçi i shkonte shumë atij djaloshi të veshur bukur, që dinte të rrinte në një pozicion aq të mirë.

Ajo ishte një tavolinë krejt e veçantë. Nganjëherë Djaloshi i Pashëm ngrinte mjekrën dhe hidhte atje te perdet vështrimin e thellë. Shikonte përjashta: atje tek dërgonte mendimin ai. Dhe heshtëte. Ndërsa tjetri, atje pranë, dukej sikur respektonte atë heshtje të tij. Ai nuk e shqetësonte.

Ata qëndronin pranë njëri-tjetrit siç qëndron hidhërimi dhe gëzimi. Kështu më dukej nganjëherë.

Kur ndodhesha i ulur vetëm, te tavolina më tej, unë mundohesha të meditoja rreth atyre të dyve. Të tjerët, dikur përçark, flisnin me zhurma. Kurse ata jo. Vija re vjedhurazi, se kur i shkurtri donte t'i thoshte diçka tjetrit, shtrihej paksa mbi sheshin e tavolinës dhe i përshtëpiste. Pas kësaj mjekra e të shkurtrit prehej e ulur në tavolinën dhe tjetri nuk i fliste. Ose e

shikonte pjertazi vetëm një çast dhe përsëri mënjanonte kryet e gëdhendura me aq kujdes nga natyra mëmë. E ulte pëllëmbën dhe bërrylin që ishte ngulur diku te cepi i tavoiinës. Dhe shikonte dikur përjashta. Diku përjashta, unë e kuptoj kështu: Diku në hallat e tij, diku në dhembjen e tij apo në gezimet që priste.

Bor ai kishte një pamje krenare. Konfiguracioni i tjetrit përskaj tij ishte banal. Të paktën kështu më dukej në pamje të parë.

E megjithatë, dukej sikur ata mund të rrinin vetëm me njëri-tjetrin. Vetëm në ato orë të pasdites. Vetëm në atë lokal. Tipa interesantë! mendova.

Në shëtitore s'm'i kishte zënë syri asnjëherë së toku.

Kisha parë dy herë nga larg Djaloshin e Pashëm. Ai ecte me nxitim në trotuar dhe kapardina në atë trup të derdhur i lëvizte si mantel i Hamletit. Pantallonat me kuadrate, në fund paksa të gjëra, i lëviznin sa majtas-djathias dhe tërë veshja që në harmoni.

Ai nxitonte. Dhe ikte nëpër qytet sikur të thopshte: Jam racë krenare!

Një pasdite tjetër, unë hyra në lokal. Brodha shikimin nëpër tavolina. Ata të dy ndodheshin atje te tavolina pozicionale. Si gjithmonë. Si të ishin dy banorë që s'i hasje dot veç e veç në atë lokal. Ashtu ata përbënin një laryshi ishullore pa asnjë epërsi ndaj njëri-tjetrit.

Nuk po shikoja të njohur. Në çast u trova: s'dija ku të ulesha. Ndjeva se të dy më shikonin mua. Menjëherë u ula në tavolinën e parë në të majtë. Shtriva krahët dhe sytë më shkuan pa dashje te tryeza e tyre. Ata, secili më vete, shikonin nga unë. Atë kohë përnjëherësh Peshku, i Kuq buzëqeshi, më përshëndeti dhe lëvizi nga karrigia. Ai përshëndeti çiltër. Unë ula dhe ngrita kokën me mirësjellje. Tjetri: Djaloshi i Pashëm nuk lëvizi nga vendi. Vetëm se përshëndeti lehtë pa u kompromentuar: ai qëndronte në punën e vet dhe donte të

sillej siç ia kërkonte natyra e tij.

Peshku i Kuç pas kësaj ngriti lart krahun e shkurtër dhe më përshëndeti së dyti, duke lëvizur gishtat e vegjël të enjtur. Djaloshi i Pashëm shikoi pjerrtas, pa mlllef. Ai gjykonte në diçka që e dinte vetëm ai. Për të cilën mendohej vetëm ai!

U bëra nervoz. Ç'të jenë ata të dy, mendova. Ata të dy që pa pikë droje ulen atje dhe të shikojnë ashtu; dhe pa të njohur të përshëndetin?!

Mendoja dhe s'shikoja atje tek ajo tavolinë, tek ata të dy. Po mjekra ime zevzeke lëvizi prapë dhe sytë e mi ngrinë të shikimi i tyre. Ata, secili më vete vazhdonin të më shikonin. Nga mesi e lart trupi im dilte mbi syprinën e tavolinës. Ata mund të hetonin kështu gjoksin tim të imtë, supet e vegjël dhe kombin e grykës që më shqetëson shumë kur ma shikojnë të tjerët. Qafa ime është e dobët, e paushqyer dhe kombi del si gërdailë. Ç'ti them këtij kombi! Po aty!

Përsëri dy palë sy shikonin nga unë dhe ndjeva qerpikët që m'u shqetësuan dhe kokërrarrën e së mjerës grykë që shtoi intensivisht punën atje poshtë nën lëkurën e rrudhosur. Vjen e ulesh këtu në klub në një orë të arsyeshme një pasdite, që të shlodhesh duke rrëkëllyer apo surbur diçka dhe befaz të ngulen aty më tej dy vetë: një shkurtan dhe një... një sqimtar! Të ngulen paturpërisht dy palë sy!

Deomos që u nervozova. Ja pse dola nga apartamenti: Që të prehesha diku përjashta bregut të detit apo në klub. Se këto kohë më duhet të punoj i ulur në tavolinën e punës në dhomën e apartamentit tim. Dhe sigurisht duhet të dal nga pak.

Po tamam në këtë orë sikur dalin edhe ata të dy. Dhe ulen përbailë meje. Dhe pa pikë mëshire, pa pikë turpi ngrenë sytë e ngeshëm dhe...të shikojë drejt!

Ç'të bëj unë i ulur vetëm në tavolinë? Ç'ti bëj gishtat? A thua se ata të dy s'do të fillojnë pas pak të përgojnë për kombin eshtor të qafës sime? Apo për këto vetulla të trasha të kërcyera. që ngjajnë sikur të jenë trazuar dhe fare pa u çetuar, pastaj, përnjëherësh të kenë ngrirë?

Ja prapë! Po ç'keni o të uruar?!

Te cepi i tavolinës sime, mbi mbulesën e bardhë, kishin shënuar diçka me stilolaps si duket. Unë i thashë vetes që ta hetoja se ç'i qe tekur dikujt të zhgarraviste mbi mbulesën e bardhë të klubit?! Kështu nuk do të mendoja më se ç'mund të përgojonin ata të dy për mua.

Atje te mbulesa e bardhë...Fap! Ata po shikonin nga unë! Po shikonin nga unë. Më dukej sikur më hidhnin thumba.

Po, pse, pse në fund të fundit, nervozohem kaq lehtë? Mbase janë njerëz të zakonshëm. Mbase pak tuhafë! Pak tuhafë! Vetëm kaq. Çfarë libër të ngre nga rafti e ta shfletoj me mend? Ja, njëri syresh po shfletohet në kujtesën time. Nga njëra faqe e atij libri shkonin në trurin tim fare qartë rradhë që Englesi i shkruante dikur Bershtajnit. T'ju them juve të dyve aty më tej, se Englesi i shkruante Bershtajnit që..." Përgjithësisht mos ua vër veshin thumbave, kjo është rregulla e parë në luftë".

Përseshillëk! Më shqetësuan. Në ç'dreq lufte jam unë me ta! Në ç'dreq lufte që po thërras në ndihmë atë...Engelsin?

Ata janë karagozë, shkroi me zjarr në kompjuterun e tij truri im. Karagozët e këtij qyteti.

Unë këto fjalë i mendova. S'i fola. S'i mërmërita. I mendova me zemërim. Sepse...e, a ishin vallë karagozë?! Mos u nxito, i thashë vetes, mos u nxito, bre!

Erdhi më në fund kamarierja dhe porosita kafe. Erdhën edhe dy shokë dhe u harruam në bisedat tona.

Akoma s'ishim ngritur, kur Peshku i Kuq dhe shoku i tij, ai Djaloshi i Pashëm kaluan, pranë dhe që të dy thanë natën e mirë. Unë lëviza nga vendi dhe gjithashtu urova natën e mirë. E ç'të bëja?

Akoma pa dalë përjashta, përpara banakut, u bë gurgule. Ata të dy qenë përballur me Aktorin e estradës. Aktori i estradës befas kishte qeshur, kishte zgjatur krahun e djathtë dhe tunde gishtin tregues.

- Peshku i Kuq! - thërriste ai. - Pse ke dalë nga akuariumi?!

Peshku i Kuq më duket se u skuq edhe më, dhe të dy me Aktorin qeshën.

Pas një çikë gurguleja u shua. Aktori i estradës u përkul te ca shokë në tryezën e parë nga e djathta, ndërsa në sallë tek ne erdhi qartë zëri i tij... i Djaloshit të Pashëm që tha:

- Ky djall se ku ka vjedhur o'j hunj gardhi dhe ka bërë këmbël

Ai tha ashtu për Aktorin e estradës! Ne shikuam nën kërbizën e Aktorit te të *dy hunjtë*. Djaloshi i Pashëm ka humor dhe konceptim figurativ! Dhe mua më pëlqen humori. Deomos.

- Lëvizi një çikë *hunjtë* e gardhiu gjer në tavolinën tonë. - i foli dikush tjetër Aktorit të estradës.

Ata që folën, qeshën dhe e shikonin mikun e tyre nga mesi e poshtë.

2

Peshku i Kuq punonte brenda në qytet me një triçikël me karroceri të mbuluar me mushama të trashë. Çuditërisht, mbulesa e karrocerisë që lyer me shije. Në përgjithësi tërë triçikliti i kishin dhënë ngjyrë me shije, me përkujdesje të veçantë. Në një brinjë të mbulesës kishin shkruar edhe numra telefoni të ndërmarrjes. Sikur tërë ajo *makinë* " e rëndë " të bënte shpesh linja të gjata ndërkombëtare dhe dikur ndofta mund t'i ndodhte një aksident apo një defekt dhe që andej pastaj t'i telefononin pronarit të përtejkombit.

Kështu që, tek kalonte nëpër udhët e qytetit tonë, ajo kamioçinë dhe tek e shikonin një hop, befas njerëzit ndriçonin fytyrën. Brenda në kabinën e vogël në timon ishte drejtuesi: Peshku i Kuq. Tek e shikonin njerëzit seriozitetin me të cilin qëndronte pranë timonit Peshku i Kuq, njëherësh bënin buzën në gaz.

Në anën tjetër të mbulesës ishte vizatuar imazhi i një aparati televiziv dhe i një lavatriçeje. Kjo ishte detyra e atij triçikli: të merrte diku nëpër apartamente televizorë, lavatriçe apo frigoriferë dhe t'i çonte për riparim. Dhe s'andejmi t'i kthente prapë.

Njëherë paradite, aty nga ora dhjetë, befas pashë triçiklin me mushamanë e ngjyrosur, me numrin e telefonit të shkruar në shpinë dhe me skicat e qarta të aparateve që mund të mbarte? E pashë pothuaj në të dalë të qytetit, në periferi, pranë një magazine mobilieash.

Ndala. Peshku i Kuq s'ishte në timon. Dera e kabinës ishte e hapur përgjysmë. Diku do të jetë, thashë me vete. Më tej ishte një grumbull me gjashtë vetë. Gjithashtu brenda në magazinën me balloren e xhamtë ishte një grumbulli tjetër njerëzish.

Po shiteshin divanleto dhe etazherë për libra.

Hyra dhe dola përjashta. Disa, ata që ishin përjashta, kishin paguar dhe qëndronin pranë mallit. Ata prisnin transportierin të cilin, siç mësova, s'ua siguronte ndërmarrja e shitjes.

Pas një çike dallova shpatullat e brumta të Peshkut të Kuq. Ai sillej për qark *me indiferencë*, me duart e shkurtra të rrasura në xhepat e peliçes. Sillej dhe sakaq vështronte tinëzisht, si xhambaz. Dredhoi me shkathtësi midis dy vetëve dhe ndaloi. Ngriti kokën dhe diç u foli atyre. Pastaj tundi kryet sikur t'u thoshte: Jo, jo dhe u kthye prapas me rrëmbim. Fytyrën e kishte të përskuqur të murrëtyer.

U përballëm. Fytyra e tij qeshi dhe u afrua çuditërisht tek unë.

- Hë, - më tha, - dole këtej?

- Doia, - i thashë.

Ai më shtrëngoi dorën si të kryente një veprim angari dhe qëndroi në krahun tim të majtë. Qëndroi fare lirshëm.

Shikonim grumbullin e atyre që kishin blerë mobiliet dhe i kishin nxjerrë përjashta. Ata prisnin që t'i transportonin. Peshku i Kuq më qëlloi me bërryl te bërryli. Unë ktheva kokën. Fytyra e tij shikonte fytyrën e qiellit. Shikova edhe unë në qiell:

- Do të kullojë shi, thua?

Ngrita supet dhe thashë:

- Qiell për shi po vjen.

- Ta hedh shpejt ç'ka për të hedhur? - tha ai. Ai shikonte

akoma qiellin. Unë i gjeta sytë dhe e shikova drejt; Pse? Ai lëvizi mjekrën drejt grumbullit të atyre që kishin blerë mobilie dhe i kishin nxjerrë përjashta nën çatinë e qiellit.

- Mbase i tremb qielli me një pikë shi dhe... Hë?

Dikush i thirri.

- Një minutë. - më tha Peshku i Kuq dhe nxitoi.

Diçka po bisedonin dhe tregonin me dorë në një drejtim të largët. Peshku i Kuq tundi kokën duke shikuar shtrembër dhe u avit tek unë i pakënaqur.

- Sot s'ka punë, - tha për vete dhe triçiklin që drejtonte. -

Televizorë s'ka të prishur, as lavatrice, as frigoriferë. U zgjua dynjaja, babam dhe i rregullojë vetë! Ose: s'kanë, se nuk kanë pare! Kurse unë përgjoj të mos rrëmbej ndonjë lek!

Foli pa ndrojtje dhe e shikova drejt. Dhe e futa të tërin në trurin tim. Ky është matrapaz, thashë. Po ai tjetri, ai... *i fismi* me golfin dhe kapardinën që i mban aq pastër?!

Sidonoftë, thashë, unë do t'i vëzhgoj këta kur të më jepet mundësia. Mbase ende jam në sipërfaqen e tyre. Po thelbi, thelbi! Sili është thelbi?! Ja, bre, aty përpara hundës. aty është thelbi: matrapazi! Ai po silltet duke vjedhur orët nga puna që e shpërblen shoqëria, duke përdorur mjetin e shtetit! Dhe pastaj... Pastaj pasditeve vjen e ulet atje në lokal dhe pa pikë turpi të përshëndet e të shikon drejt. Peshk, i Kuq! Peshk i Zi! Matrapazi!

Peshku i Kuq, pas një çike, nxitoi që të ikte, por u kthye prapë. Lëvizi fytyrën nga unë dhe qeshi me çiltërsi.

E shikova nga këmbët te koka. Hë! Rrinte nganjëherë kështu i veshur më keq dhe i parruar. Dhe këtë sikur e bënte me kast që të trishtonte këdo që ta shihte. Këtë e bënte paraditeve. Paraditeve kur nisej për pocaqira.

Përsëri iku. Sytë e mi të inatosur ndoqën lëvizjet e tij të dhjamosura atje te vithet e brumta që tundeshin si dy stema matrapazi.

Shkoi deri në mes të rrugës dhe ndaloi. U kthye. I dridheshin gjunjët si gjyle dhe erdhi tek unë. Për çudi, toni i tij ishte i shpenguar dhe gazmor. Qe vërtet një tip matrapazi origjinal, i veçantë.

Tha:

- Po plasën pikat e shiut, ata do të nxitojnë dhe unë o burrani, do t'ua shpie me triçikël. Nxjerr diçka që të ulemi të ngrehosur në turizëm atje afër detit të bekuar. Që të mos prekim rrogën, është puna!

- Hajde, - i tha njëri që shikonte lartnë qiell që po sterrosej.

Peshku i Kuq më qëiloi lehtë në bërryl dhe nxitoi.

- Në darkë nga një ponç, - tha. - Për muhabet. Do të vijmë të dy.

- Mua, - i tha tjetri. - Divaneleton time!

- Mos u nxitoni, - foli ulët Peshku i Kuq. - Mos, mosni se do të rregullohemi.

Ai ndezi motorrin e triçiklit dhe e afroi.

- Oburrani se pflakosi shiu, - tha.

- Vetë kishte pflakosur në karroceri dhe ndihmonte atë që do të transportonte divanleton. Po u turrën njëherësh katër hallexhinj.

- Të gjithëve, të gjithëve, - fliste ulët Peshku i Kuq. Ai fliste dhe nuk i shikonte hiç. - Ka vend për të gjithë.

Më në fund, pranoi tre divanleto dhe dy etazherë. Njëri nga klientët nisi të grindej.

- Do ma dëmtosh, o, do të ma sifiosësh! - thoshte i pakënaqur. Ai filloi të thërriste: Çojmë njëherë timen pastaj këta.

Qielli e *tunđi* pakëz shoshën dhe unë ndjeva katër pika uji në qafë. Peshku i Kuq kërcëu me shkathtësi nga karroceria dhe iu afrua të pakënaqurit. Iu afrua fare pranë, ngriti fytyrën nën mjekrën e tij dhe i foli shkoqur:

- Po ç'ke; or t'u mbylltë? Mos u mërzi: t'a shpie si nuse. Hajt të gjithë, hajt: të gjithë pranë mobilieve në karroceri.. Dhe uleni mushamanë. Xëc, që të ndritni shtëpitë!

Ai nxitoi te motorri. Karroceria ishte e vogël sa korridori i një apartamenti me një dhomë e një kuzhinë. I një apartamenti të bërë me tepër kursime. Të tillë apartamente, në tërë planetin tonë, mbase vetëm ne mund të kemi stisur.

Peshku i Kuq iku gjashtë çapa, ndaloi, zbriti dhe doli

prapa. Ata s'e kishin ulur mushamanë. E uli vetë dhe nga jashtë s'u dukej asgjë. Unë megjithatë mendova se në trupin e tij kishte shumë limfë. Po. Matrapazët janë tipa energjikë.

Më përshëndeti i qeshur, ngriti supet, bëri me të shpejtë gjysmën e udhës gjer tek unë, ndaloi, qeshi prapë dhe tha:

- Popull! Shtresë! Ne i djegim etapat, babam! Kështu. Neee... Ej! Në darkë. Mirupafshim!

Foli kështu me eliptizëm, në një mënyrë enigmatike dhe iku.

Iku duke gurgulluar gaz. Doçka e tij si putër arushi u ngrit përsëri dhe më përshëndeti. Pastaj të dy gishtat e *doçkës* u afruan sikur të numuronin lekët.

Triçikli nxitonte. Në shpinën e mushamasë së lyer me ngjyrë të bukur u mundova të dalloja se ç'tregonte *ekrani i televizorit*. Shikova fytyrën e kuqe buçko të njeriut të shkurtër. Skërmita dhëmbët. Në mend, tingëlluan prapë fjalët e tij të fundit. *Shtresë. Ne i djegim etapat! Në darkë!*

Kurse në trurin tim të ngrohur, të trazuar e të inatosur, fytyra e shkëlqimtë e spikerës së mbrëmjes me buzëqeshjen e përnjohur e të përhershme që tha:

FUNDI I PJESËS SË DYTË

U shkunda dhe hapa sytë dhe nxitova nën ballkon pranë një librarie. Aty erdhën shumë kalimtarë dhe bënin potere. Gjithashtu shiu po vinte edhe ai me potere. Dhe buzëqeshja e përnjohur dhe e përhershme e spikerës, që më doli përsëri te mendja, te ekranin i vizatuar në mushamanë e televizorit. Dhe fjalët e saj të fundit.

3

Pasditë do!a nga apartamenti para orës 18.00. Në shëtitoren "Bulevardi i Verbër" s'takova asnjë të njohur. Në të dy

anët degët e rrapeve shushurinin ngadalë.

Lashë prapa shëtitorën dhe hyra në Qendër të qytetit. Askush. Askush me të cilin të përshëndeteshim.

Nxitova çapat dhe ata e gjetën vetë lokalin. Tavolinat ishin të ngarkuara me njerëz aty këtu. Një krah i shkurtër me pëllëmbën e kuqe si petull e fryrë që lëvizte në ajër. Ata atje ishin tre.

U ula vetëm. Dhe piva me dëshirë dhe me fund një gotë me ujë mineral. *Eau minerale naturelle*. Shumë bukur! Me shumë kënaqësi nisa të shijojë kafën.

Po sepse përnjëherësh më pushtoi zyrtia. Me siguri dukeshin i ngrysur. Shikova tek ata të tre: Peshku i Kuq dhe tjetri po qeshnin. Eh! Djaloshi i Pashëm rrinte krenar, drejt dhe shikonte diku pa përcaktim. Tjetrin e njihja. Ai që pompist në naftë dhe punonte me turne. U kthye dhe lëvizi nga karrigia dhe më përshëndeti. Gjer atë kohë ai më kishte përshëndetur disa herë, por unë s'e kisha vënë re. Sepse më që bërë mjegull përpara retinës së syve.

Si është i shkreti njeri! Befas, fare pakuptuar, diçka e ngrysur e ngacmon në palcën e shpirtit dhe ai gremiset në zyrti! Gjithmonë mund të gjendet diçka në jetën e gjatë të njeriut që mund ta ngacmojë! Të del përpara një matrapaz, të buzëqesh si të të ketë ortak dhe kështu të nxin jetën.

Pompisti dhe Peshku i Kuq qeshnin! Vetëm Djaloshi i Pashëm i shikonte ndonjëherë pjerrtas përtej supit dhe diçka thoshte. Pas atyre fjalëve Peshku i Kuq lëvizte. Bërte ca gjeste që ia njihnin njëri-tjetrit sigurisht. Dhe qeshnin. Qeshnin me zë, po s'm'u duk se shqetësonin sallën. Dy herë një pas një Djaloshi i Pashëm foli dhe ngriti krahun e lartë dhe i shoqëroi fjalët me pëllëmbën e hapur dhe gishtat e gjatë. Pastaj shikoi përsëri gjatë. Ai sikur që regjizori i bisedave.

Pompisti, i tëri i qeshur në fytyrë, uli kokën, i belbëzoi diçka Peshkut të Kuq dhe të dy riqeshën. Peshku i Kuq njëherësh u bë i vrenjtur, zgjati qafën, gusha iu tund dhe mjekrën e uli mbi pëllëmbën e vogël të hapur. Dhe shikonte te perdet i menduar. Në atë pozicion kishte diçka komike. Pompisti

qeshi me shpirt. Dhe përnjëherësh u kthye me rrëmbim, lëvizi karrigen, zgjati krahun dhe tha:

- Po eja te ne!

Nuk do të vij, mendova në çast. Dhe u solla sikur s'dëgjova. Shikova poshtë. Doja të bisedoja me vete. Vetja pak a shumë më tha: Atje është një realitet. Mbase ti akoma s'e ke zbuluar atë realitet. E pse?!

Vërtet, pse të mos ulesha një herë me ta?

- Po eja tek ne, - tha përsëri Pompisti.

U ngrita me filxhanin e kafes në dorë dhe vajta. U takuam. Djaloshi i Pashëm u tregua i sjellshëm dhe i përmbajtur. Ai mundohej të dukej i dashur.

Kështu u bëmë katër vetë.

- Ç'do të merrni? - tha Djaloshi i Pashëm. Zërin e kishte të ëmbël, të qeshur e melodioz.

- Ç'do të marrë! - tha Peshku i KUq dhe e shikoi atë me sytë e hapur. - Kush do të paguajë pastaj?

Fytyra e Pompistit u bë gati që të qeshej.

- Hë! - tha Peshku i Kuq. - Do t'i paguash ti ponçet?

Njëra vetull në krahët e Djaloshit të Pashëm u ngrit përpjetë dhe ai e shikoi me trishtim Peshkun e Kuq. Pastaj me një gjuhë zvarrë-zvarrë, më tha:

- Shiko këtë kokë! - the tregoi me gisht kryet e Peshkut të Kuq. Ai u mundua të përçmonte fytyrën e tij të bukur: Që të tregonte neveri për atë kokë.

- Ordinerë, mizerabël, pa pikë plastike. Si pjepër zurbull, - tha Djaloshi i Pashëm. Ai e shikonte pjerrtas Peshkun e Kuq.

Pompisti qeshi i kënaqur nga *dueli* që po niste dhe deshte të më aktivizonte edhe mua. Unë ndenja i heshtur se më dukej sikur llafosnin gjepura.

Erdhi kamarierja dhe ata këmbëngulën të më sillnin ponç. Në tavolinë u bënë katër gota me ponç. Peshku i Kuq uli gushën dhe më tha:

- Për besë, më thuaj si i ka nofullat ky!

Dhe tregoi Djaloshin e Pashëm. Unë qeshë i detyruar të shikoja nofullat e tij. Ai u përkujdes me aq sa mundej dhe ndjeva se në tërë fytyrën iu nxit një valë e re gjaku.

- Hë, fol të vërtetën, - tha Peshku i Kuq. - A mund të jenë elegante këto nofulla?

- Shumë elegante, - thashë.

Ashtu kot mora anën e atij Djaloshi të Pashëm. Apo për inat të matrapazit numër një? Megjithatë duhet ta pranoja se nofulla e tij ishte me të vërtetë elegante, sikundër tërë fizionomia.

Djaloshi i Pashëm qeshi shumë i kënaqur, qeshi siç nuk e prisja. Lëvizti karrigen dhe deshi të qasej më pranë meje që të bëhej më intim. Ai vuri pëllëmbën e tij mbi pëllëmbën time. I shikova shpinën e pëllëmbës. Ishte tepër e pastër. I numërohej pylli i qimeve të holla e të buta. Dukeshin atje ku dilnin nga rrënjët. Sikur vazhdimisht të bënte larje me shampo të zgjedhur. A mund të ishte ky matrapazi numër dy?

Qeshi përsëri. Akoma s'u mësova që ajo fytyrë të qeshte në atë mënyrë. I tha Peshkut të Kuq:

- Rri pak në këtë pozicion!

Peshku i Kuq u rregullua në atë pozicion që i propozoi Djaloshi i Pashëm.

- Ngrije mjekrën, - i tha Djaloshi i Pashëm.

Ai e ngriti.

- Jo, ule, - tha Djaloshi i Pashëm.

Ai e uli i bindur.

Fytyra e Peshkut të Kuq u kuq akoma dhe shikonte diku poshtë i mvrenjtur, duke u përmbajtur që të mos qeshte.

- Ashtu, - urdhëroi Djaloshi i Pashëm/

Ashtu rrinte ai.

- Tamam kasap, - tha Djaloshi i Pashëm për të.

Pompisti qeshte me tërë qënien dhe dëshironte që të qeshja edhe unë. Unë nuk qesha.

- Ja se ç'lexohet te kjo fytyrë, te tërë ky: - tha Djaloshi i Pashëm: - Kasap! Me një përparëse të bardhë llangosur me gjak; me hanxhar mbi një dru, duke prerë një kokë derri. Dhe



pas ca, përfytyrojeni në një rrugicë, kështu shkurto siç është, tek nxiton duke tërhequr pas një kokë derri të rrjepur, që e ngre fort me gishtin e mesit të kthyer si kërrabë të futur në një vrimë 'e gjuha e gjatë.

Pompisti qeshte me gjithë shpirt. Peshku i Kuq qeshte edhe ai dhe, i përkulur në tavolinë, thoshte:

- Hë në, ashtu, po. Po atë kokë unë e shpie në shtëpi dhe e fus në kazan që ta ziemë e t'i nxjerrim mishin. Koka ka mish të shijshëm.

- Në kazanin e rrobave, - tha Djaloshi i Pashëm.

- Po e lajmë me finjë, ama. Me hi e ujë të ngrohtë, para se të shtiem kokën e derrit.

Pompisti rrahu gjunjët.

- A mund t'i thuash njeri këtij? - tha Djaloshi i Pashëm. -

Shih ç'kafkë të deformuar ka! Njerëz me kafkë të tillë nuk duhet të lëvrijnë mbi tokë.

Biseda e Djaloshit të Pashëm nuk më pëlqente.

Megjithatë, krejt padashur, përfytyrova kafkën e Peshkut të Kuq dhe qesha së brendshmi: me të vërtetë ai duhej të ishte pak a shumë siç e përfytyroi Djaloshi i Pashëm.

Vështrova Peshkun e Kuq. Ai kishte sy të mprehtë, depërtues.

- Ëhë, për kafkën ka të drejtë, - tha Peshku i Kuq pa u shqetësuar. - Kafkën s'e kam gjë.

- E ke të përçudnuar, - tha tjetri.

- E kam të çudnuar, - tha Peshku i Kuq. Ai e deformoi me qëllim atë fjalë.

- Ha, ha, ha! - qeshi Djaloshi i Pashëm. - Thuaj Mikelanxhelo Buonaroti!

- Mikelanxhelo Punëbaroti, - tha menjëherë Peshku i Kuq.

- Ha, ha, ha!

Djaloshi i Pashëm qëlloi pëllëmbët e tij me njëra-tjetrën. Ato krisën. Qëlloi lehtë te syrëna me mollëzat e gishtave, qeshi me vete dhe tha:

- Më shumë se gjysmat e gërmave të fjalëve që duhet të



thotë i përdredh ligsht: ca i arreston dhe ca i harron nëpër plasat e dhëmbëve të palarë. Ha, ha! Ti duhet ta kishte emrin Beqo. Ose Pavlo; Ç'i ke ato qeska të mbushura me gjumë të përherhme nën sy! Ato rrudha .Ato duar aksidentale që trembin njeriun! Hy!

- Ashtu, ashtu, po ponçët kush do ti paguajë? Ë?

- Ti, - tha Djaloshi i Pashëm.

- Paguaj ti, - tha Peshku i Kuq. - Unë s'paguaj.

- Menjëherë. Ne sakrifikojmë: rrimë me ty, - mërmëriti fare shuar Djaloshi i Pashëm.

Pompisti qeshi dhe kërkonte që të më shtynte edhe mua në atë realitet pak të çuditshëm.

- Vërtet, - tha Peshku i Kuq dhe më shkeli syrin. - Shih ç'ballë të bukur ka qenil Ah!

- Fjalën "qen" mos e përdor kur flet për ballin tim, - tha Djaloshi i Pashëm.

- Të kam inat, po hakun s'ta ha: je elegant! Ë, si thua? - m'u drejtua mua.

- Elegant! - mërmërita. - Model i elegancës.

- Shihni mollëzat, -vazhdoi Peshku i Kuq.

- Po, - thashë.

- Po flegrat e hundër? Goja? Goja e vogël me buzë të mbushura! Ai boshllëku midis dhëmbëve s'i duket hiç. Se ka gojë të vogël të bukur, qerratai.

Unë tunda kokën. Rrëkëlljem ponç.

- Gjyshit i ka ngjarë, - tha Peshku i Kuq.

Djaloshi i Pashëm u bë i menduar. Ne heshtëm dhe shikonim atë. Ai vuri një skedë të bardhë përpara dhe me shumë lehtësi vizatoi me karbon bustin e një vajze që e kishte në kokë. Në kokë e në shpirt duhej ta kishte. E vizatoi me linjë të sfiakathtë, shprehëse, vibruese e të ngrohtë. Ajo vajzë tanimë na shikonte që nga copa e letrës ashtu paksa e turpshme. Gjoksin e kishte të zhvilluar dhe buzët tundonjëse. Qe e freskët.

Unë s'e besoja që u bë aq shpejt me karbon nga dora e Djaloshit të Pashëm. Djaloshi i Pashëm e hoqi atë pastaj nga

tavolina, bile e copëtoi pa pikë dhembjeje. Pfu! Ka të ngjarë që ai jeton edhe me ca vegime të çuditshme, të cilat i mban dhe i zhvillon në trurin e tij të ndezur, mbase.

Nuk fliste asnjë nga ne. Ai ngriti kokën dhe m'u drejtua:

- Po gjyshi ka qenë i bukur. Njëqindedhjetë vjeç vdiq. Xhins që jetojmë gjatë ne.

- Botë e ligë kjo! - belbëzoi me trishtim Peshku i Kuq. - Ku derdh të mira, s'kursehet. Gjetkë!...

- U habitën gratë e mëhallës kur më lindi mamaja, - tha Djaloshi i Pashëm. - U habitën nga bukuria ime. Megjithëse, kur linda, s'merrja frymë. Një xhaxheshë më fryu me buzët e saj. Dhe ajo, më solli në këtë botë!

E shikova me vëmëndje. S'tregonte moshë. Veçanërisht moshë e rritur. Mosha e tij kishte ngrirë. Kishte ngrirë i ngopur në të tilla dëshira dhe fantaezi, si dukej!

- S'jam i vogël, - tha. - Jam njëzetegjashtë vjeç. Po natyra është e dashur me mua. Shyqyr: asnjë rrudhë. Jo s'kam rrudha.

- Jo, - belbëzova.

- Asnjë, - tha i vendosur. Dhe pamja e tij bëhej gjithashtu akoma më e çuditshme. Po gjithsesi e pashme.

- Prit, më ngjan se po të del një, - tha Peshku i Kuq.

- Hë, or ti!

Djaloshi i Pashëm i foli me zemërim dhe preras.

- Po e ka një hall, - tha Peshku i Kuq. Ai tha kështu për diçka tjetër. Djaloshi i Pashëm e shikoi me vëmëndje: Ç'hall?!

- Hekurudha, hekurudha! Ah, dy shina hekuri!

Heshtje.

- Dy shina hekuri! - mërmëriti sakaq me dhembje Djaloshi i Pashëm. Me shumë dhembje. Dhe sikur u bë pulë.

- Pse? - pyeti me vendim Pompisti. Djaloshi i Pashëm tundi pëllëmbën me trishtim. Ai e tundi sikur trazonte akoma diçka të ngatërruar. Të ngatërruar keqas.

- Ato dy shinat e hekurit e ndanë!

Prapë u bë heshtje. Dhe fishkëllimë ajri nga goja e buzëve.

- Shtëpia jonë ngeli matanë qytetit dhe na thonë *fshat!* - tha Djaloshi i Pashëm. Unë në çast ngurrova. Ai foli dhe fjalët e tij u bënë pëllëmbë dhe pëllëmba kërciti. Kërciti edhe në fytyrën time. Dhe prapë heshtje.

- Dhe mbeti fshatar! - tha me *dhembje* Peshku i Kuç.

Djaloshi i Pashëm u zgjua dhe e shikoi me inat. Peshku i Kuç s'bëzajti. Pastaj Djaloshi i Pashëm foli sikur rrokullisej i dërmuar:

- Përkohësisht. Po...Eh... do të rregullohet. Unë punoj këtu në qytet. Eh, më zuri ky hall! Errare humanum est. Unë ditë gaboji Ne.

Ai psherëtiu dhe askush nga ne s'guxonte ta lëndonte. Jo. S'mund të bënim humor. Unë s'dija. s'po kuptoja se çfarë pikërisht quante ai gabim! Pra, u ngatërrova përfundimisht. S'isha as në sipërfaqe, as në thelbin e çështjes, as diku përskaj. ASI

- Njeriu gabon, kështu e ka natyra. - foli ai shqip. Foli Djaloshi i Pashëm. Dhe qe një e folur sikur ai donte të shmangte mërzinë që na pushtoi.

Po prapë u bë heshtje. Ai s'po fliste më tej.

- Ç'punë bën? - e pyeta më në fund Djaloshin e Pashëm. Nën qepallat ndieja lëng të ftohtë.

- Disenjator, - nxitoi e tha Peshku i Kuç.

Kur u tha fjala *disenjator*, Djaloshi i Pashëm u tërbua. Ai shau me fjalë me figura të rënda dhe të goditur që mund të gjendeshin lehtë për fizikun e Peshkut të Kuç. Por Peshku i Kuç ishte i kënaqur, apo i mësuar me asish. Ndërsa me sa dukej, ia kishte arritur asaj që donte ato çaste.

- Jam piktor, - mermërti i ~~që~~ pastaj Djaloshi i Pashëm.

Erdhi kamarierja dhe pagoi Peshku i Kuç. Djaloshi i Pashëm e shikoi një grime me vëmëndje Peshkun e Kuç. Pastaj tha:

- Kjo fytyrë kuqalashë, kaq banale edhe mund të zbutet pakëz.

Atij iu drodhën flegtrat e buta të hundës dhe, në çast, ngjau sikur u marros. Po vazhdoi të fliste shkoqur.

- Shpresoj se edhe racat e kafshëve si ti mund të përmirësohen. Sigurisht, jo me kryqëzim të racave, po me një grusht të paqëm në fytyrë, duke përfshirë këtu edhe hündët.

Peshku i Kuq u bë grusht. Ai vërtet ndjeu frikë atë kohë. Ashtu m'u duk. Djaloshi i Pashëm vërtiti shikimin përçark, vërejtji Peshkun e Kuq dhe, si ta mëshironte, belbëzoi:

- Të perpiqemi të të ngjitim dy xhufka pambuku të vetullat e çngjyrosura. Për hije. Mbase bëhet diçka. Mbase!

Fliste kështu dhe, ngadalë, Djaloshi i Pashëm sikur përpiqej të provonte se ishte më vete, i vetëm, një filozof.

Dolëm. Djaloshi i Pashëm ecte në krye me Pompistin. Unë dhe Peshku i Kuq ecnim prapa. Unë s'dëshiroja që të ncodhesha në atë situatë të nderë që u krijua në fund. Ç'ishte ajo situatë e ngarkuar, e nderë? Pse u krijua? Ngaqë unë e pyeta Djalosin e Pashëm se ç'punë bënte? Dhe sepse përnjëherësh Peshku i Kuq tha: Disenjator?

Dhe pastaj Djaloshi i Pashëm, si volli kundër Peshkut të Kuq, i cili nxitoi të përgjigjej, mermëriti: Jam piktor. Domethënë: S'jam disenjator. Çudil! S'po kuptoj! Një gjë është e vërtetë: Djaloshi i Pashëm u zemërua në palcë me Peshkun e Kuq. Sepse Peshku i Kuq e emëroi me profesionin: Disenjatori!? Jam i detyruar të përdor pikëpyetje e pikëçuditëse të njëpasnjëshme. Sepse ndihem tepër i ngathët për të zhbiruar mu në këtë copë realitet. Gjithashtu jam i detyruar që të habitem dendur dhe të ngre lart supet e mi të ngordhura. Por ama, në palcën e shpirtit, diku thellazi, ndjeva lëndim që ata të dy u goditën. Që Djaloshi i Pashëm, ashtu për hesap të vet, u zemërua. Atë, përnjëherësh, sa dëgjoji fjalën *disenjator*, të cilën ia ngritën si emërim, sikur u sulën për ta torturuar ca kriza shpirtvogëlsie. Sikur të tërë përçark apo atje tej të jenë të pafat pikërisht se s'e dëgjojnë atë. ATË!

Unë bëj mendimin që, tashti ata vështirë se do t'i shikoja përsëri të dy bashkë.

Eh, njeriu! Qënia më e përkryer dhe më e çuditshme e planetit!

Përjashta qe bërë errësirë. Unë qeshë pak i ngrirë. Si do të ndaheshin ata?! Në djall, o jetë, o copë katrahure! Në djall!

- Mirupafshim! - thashë me njëfarë toni të papërcaktuar.

Po ata më përcollën me përzemërsi. Pas shpinës dëgjova zërin e Peshkut të KUq, që i tha:

- Këtej do të shkojmë?

- Jo, këtej, - thirri zëri i Djaloshit të Pashëm.

Ktheva pakëz kryet: Djaloshi i Pashëm ecte vetëm andej nga donte ai, natyrisht. Kalimtarët qenë rralluar. Pompisti dhe Peshku i Kuq ishin pranë e pranë. S'lëvizën. Në fund të fundit, me ç'forcë që s'e kuptoja, me ç'pushtet u imonohej aq rëndshëm atyre Djaloshi i Pashëm? Ata u hutuan krejt! Peshku i Kuq u ndrydh.

Pompisti lëvizi, më shtrëngoi dorën dhe tha:

- Nxitoj se marr dezurnin. Jam natën. Mirupafshim!

Ai shpejtoi sikur vraponte. Do të merrte dezurnin në ndërmarrje. Në një dhomë të vogël standarte, në një shtrat të përhershëm dhe me tavolinën e karriget. Dhe me telefonin, dhe me ato *harta* në mur që tregonin se ç'duhej të bënte në rast alarmi.

Ktheva kryet. Peshku i Kuq rrinte në vend në trotuar dhe dukej i zi. Ndërsa atje më tej, pa kthyer kokën, vazhdonte të çapitej Djaloshi i Pashëm. Ishte akoma nën sofrën e një drite. Flokët befas sikur qenë bërë më të bukur. Ato po i shndrisnin ndryshe: sikur krejt magjishëm qe shkundur pluhuri i flaktë nga yjet dhe ai e kishte pritur te pëllëmbët, pastaj kishte pudrosur flokët.

Nisi të lëvizte edhe Peshku i Kuq. Shkoi më në fund pas tij, i bindur si një ungjillor.

Atëherë edhe unë lëviza përsëri. Ecja i vetëm nëpër "Bulevardin e Verbër", poshtë, nën trazimin e degëve të kërlëshura të rrapeve, nën *diellin* e butë, të bardhëm e të qetë

që lëshonin neonët. Ndjeva zhaurimën e valëve të detit. Atje në krye më priste apartamenti i familjes sime, më saktë: Kr., Krisanthi dhe Ervini, dhe Erka. Po më trazuan gjakun këta! Mos po... Mos po talleshin me mua? E po, në fund të fundit këta janë tuafë. Apo jo? Ndofta jo. E pse të jenë tuafë?! Pa të mendojë secili për atë pjesë të madhe të jetës vetjake që e di vetëm ai dhe s'lejon ta dinë të tjerët?! (Ata që nuk lejojnë). Që shumë dendur bëjmë aq mundim për t'ia fshehur edhe vetes?! Trembemi, të gJORËt ne, të hapim veten, ta tregojmë atë plotësisht. Mbase do të çliroheshim nga shumë shfaqje që i shesim si të bukura. Se, dihet, kur tregon diçka, flak diçka. Po ne përpiqemi t'i fshihemi vetvetes. Dhe kështu sillemi në jetë ca të shpërbërë. Ndryshe do të ngjanim më të bukur. Patjetër. Sinqeriteti është cilësia e parë e bukurisë. Njeriu fisnik është i bukur. Po ne shtrembërohemi që të humbasim ca të vërteta, që t'i strukim, të mos duken. I gjori njeri! Eh! Dhe kush kështu, pa! Ajo, qënia më e përkryer, më e çuditshme për nga përsosmëria. Qënia më komplekse gjithashtu.

A do të grinden ata?

Domosdo. Diku në gjysmëerrësirën e një rrugice ata po grinden. Me siguri Djaloshi i Pashëm s'do t'ia falë kurrë atë përqijje të papëlqyer që dha Peshku i Kuq. Përgjigjen e pyetjes se ç'punë bënte Djaloshi i Pashëm. Disenjator, nxitoi e tha Peshku i Kuq atë kohë. *Disenjator?!*

Jo, piktor, tha pas ca Djaloshi i Pashëm. Ai kërkonte që mbi profesionin e shkruar *disenjator*, të shkruhej menjëherë *piktor*. Unë punoj piktor.

Pra, Djaloshi i Pashëm bëhej i pakënaqur, acarohesh gjer në tërëim, po t'i thoshe se: Ti punon disenjator. Ose se: Ti do të punosh disenjator. Apo ndofta të guxoje e t'i thoshe: Ti ke punuar disenjator.

Ai kërkonte t'i thoshin: Ti je piktor. Ai thoshte: Unë jam piktor.

E çfarë ishte ai? E ç'mund të ishte ai? Ç'ishte në gjendje të punonte ai? Për ç'profesion shpërblehej ai në listat e pagave të ndërmarrjes së tij 14 vjet para se të binte viti 2000?

Po tërbimi i Djaloshit të Pashëm tregoi gjithashtu se ai kërkonte diçka. Se ai mendonte se i kishin mohuar diçka. Se ai po thërriste ta njihnin.

Unë punoj piktor, eji!

Pikërisht sepse mendonte se i mohonin diçka, ai sonte do të grindej me Peshkun e Kuq. Do të grindej. Ai nuk pranonte shpjegime për këtë çështje. Të pranonte shpjegime për të, do të thoshte të lypte. Ai nuk lypte. Prandaj, ai do të grindej me të gjorin Peshk të Kuq!

Çfarë ishte vallë ai të cilin edhe mendtë e mia e thërritën Djalosh i Pashëm?!

Po grinden. Patjetër. Sepse unë mendoj që ai, Djaloshi i Pashëm s'do t'ia falë *fyerjen* që pësoi nga Peshku i Kuq. Për këtë nuk dyshoj. Për këtë jam i sigurt. Këtë e zbulova.

4

Këpucët e mia nuk shqetësonin trotuarin. Bota nisi të më dukej e zbrazur dhe *mes pieds* sikur e ndienin se s'duhej t'ia bënin çuk-çuk. Se njerëzit e planetit atje brenda nëpër apartament preheshin. Dhe unë s'doja të ndieja pëshpëritjet e pambaruara të rrapeve që i thoshin fjalët duke tundur e përdredhur lehtëazi qindra degët e tyre shtrembaqe. S'doja t'i vija veshin rënkimit të thellë të detit të moçëm atje matanë turizmit. Unë doja të bisedoja me vete. Shumë njerëz fjalosen me vete. Në shumë apartamente skuqeshin specia. Në shumë. Përhapej era e tyre. Gazeta dje kishte një shkrim të gjatë për dobinë e madhe të perimeve në jetëgjatësinë e njeriut.

Po dikush nxitonte prapa meje. Dhe pllakat e trotuarit kërcisnin. Le të nxitonte dikush. Le të kërcisnin pllakat e trotuarit. Por ja këtë e bëre: The: Bulevard i Verbër. Shëëët!

- U ktheva, - tha dikush mu pranë supit tim, dhe ndjeva pëllëmbën e Pompistit. Fytyra e tij ishte e qeshur. Ishte njeri i

mirë dhe unë e doja atë.

- Në stacion, - tha, - në stacion gjeta tjetrin që po shkonte. U ngatërrova dhe kujtova se kisha sot ditën e atij dezurnit!

- Ashtu?

- Nesër, - tha, - nesër mbrëma.

Ecim përskaj njëri-tjetrit.

- E di ç'më bëri një ditë?

Unë e shikova në fytyrë.

- Se ku e mësoi që isha pushim dhe erdhi në shtëpi që në mëngjes. Do vemi në Tiranë, në Galeri, tha. Do të yemi të shohim Rembrandin. Për portretin e Rembrandit.

E kuptova se ai që i kishte shkuar në shtëpi pat qenë Djaloshi i Pashëm.

- Nuk mund ta kundërshtoja, - tha Pompisti. - Ishte e pamundur. Dhe më zvarriti. Kur zbrita shkallët, më tha: I more syzet e diellit? Ktheu, merri! U ktheva dhe i mora. Atij s'mund të mos i bindesh. Pastaj më vërtiti nëpër qytet që të gjenim tjetrin. Ora e nisjes së trenit po afrohej dhe po shkonim drejt stacionit duke shikuar më kot mos e shquanim diku. O, me sa mërzi i ngjiti shkallët e vagonit! Se ishte pa të!

- Pa Peshkun e Kuq? - i thashë.

- E pra. Po s'i shkohej pa të! O, që s'e gjetëm! thoshte. Ti e ke fajin, se s'dole mbrëmë, që ta vendosnim. Pse nuk dole mbrëmë!

Dhe tërë udha u bë e mërzitshme sikur po shkonim për në varrim. Dhe pse? Se s'kishte me vete atë. Që ta shikonin bashkë.

Nejse, aty në të afruar të drekës zbritëm në Tiranë. Tiranës i thotë Qyteti për Poetë. Më jep syzet, tha dhe u rregullua. Syzet e mia i vuri ai! Dhe nxituam drejt Galerisë.

Kur arritëm, po dilnin vizitorët e fundit dhe dyert do t'i mbyllnin. Ec, i thashë, ec. Qeshë i shqetësuar se mund të mos hynim. Ai nuk shqetësohej për këtë! S'e vriste hiç! O, që s'e

gjetëm atë, thoshte për Peshkun e Kuq! O, që s'e gjetëm!

Na ndalën te hyrja. Ky mbeti sikur do të rregullonte lidhësen e këpucës dhe do të hynte sikur askush nuk mund ta pengonte. S'duhej. S'mundej! S'lejohej! Kurrsesi! E pse? Sepse ai qe i vendosur dhe pikë. Qe i vendosur dhe top. Nxitonte i detyruar për te portreti i Rembrandit. Hë, do ta njohësh edhe ti, do ta njohësh, po dale! Dhe tamam, ja këto, them unë, e bëjnë ashtu si të dalë jete, si...tuaf! Po është i mençur. Ai ka patur kurajo që të kuptonte shpejt dhe kështu ka kursyer vuajtjet.

Sa do të më thoshte ai që rrinte te dera e Galerisë se vizitat për atë ditë kishin mbaruar, unë fola i pari: Duhet patjetër ta shikojë! Dhe i tregova me gisht këtë. Ky s'foli, buzëqeshi pakëz, vetëm pakëz, si për mirësjellje dhe tundi kokën. Unë u mënjanova dhe ai kaloi. Ç'të të them. Kaloi ashtu fare natyrshëm. Syzet s'i hoqi. Ai që duhej të mbyllte derën beibëzoi i hutuar: Urdhëroni!

U ndodhëm në sallonin e parë në katin e parë. O, që s'e gjetëm atë! tha prapë për Peshkun e Kuq. S'mund të ta shpjegoj atë njeri! Po bëhej nervoz duke kërkuar të gjente ku ishte portreti i Rembrandit. i reklamuar si zbulim.

Ai që ishte te porta shikoi nga ne. Rembrandi? i pëshpërita. Lart s'qe askush. Vetëm vepra të varura në faqet e murit.

Ndaluam. Shikuam. Një zë pas nesh te fundi i shkallëve thirri me përkujdesje: Në të djathtë!

S'folëm. U kthyem në të djathtë. Ballëpërballë me portretin e zbuluar të Rembrandit. Dhe...

Dhe çfarë, thua ti? Ja! Dhe ballëpërballë me shpatullat dhe mesin e majmë dhe këmbët e shkurtra të Peshkut të Kuq! Vetëm ai frymor ishte atje. Dhe ai qe Peshku i Kuq! Qe kundruall tablosë, kishte kryqëzuar pëllëmbët si topa leckë te kërthiza, kokën si poçe e kishte lëshuar prapa dhe s'ëvizte. Shikonte portretin!

Uf! ia bëra. Ishim të tre pranë njëri-tjetrit dhe s'i flisnim njëri-tjetrit. Si duronin ata thua ti? Si duronin?!

Uf, ia bëra përsëri. Me këtë "uf" doja t'i thoja se, ja, për çudi, ja tek e ke shokun që u merakose! Ai e kuptoi ufën time dhe, duke shikuar te portreti i piktorit të madh, belbëzoi: Domosdo. Këtu, këtu do të ishte. Domosdo.

Pra s'u takuam, s'u përqafluam, s'shtrënguam duart! Këtë orvatje s'e bëri asnjëri nga ne. Mbaj mend se Peshku i Kuq duke shikuar te portreti mërmëriti: Hajde, hajde! Ë! Poo! të jetë Rembrandi! Cuk. Ë?!

Pëllëmbët i kishim lëshuar të tërë atje te rrypi i pantallonave. Shikua gjatë sa u ngopëm. S'të thashë: atje para portretit ai hoqi syzet. Oh, të ishe më ndonjë cep dhe ta shikoje se me ç'seriozitet shikonte ai te portreti. Afrohej, largohej, i dilte anash: morpo s'i la gjë pa shikuar atij portreti. Dhe atë kohë ishte tjetër njeri, krejt tjetër. Mbante i tëri erë art, si i thonë! Vetëm pikturë. Atje qe ai. Qe i tëri i mobilizuar, si rrallëherë. Sikur donte të përpinte diçka, po s'i gjente dot anën.

Vetëm kur po zbrisnim, vuri syzet dhe mërmëriti: Mund të jetë një etyd i Rembrandit! Dyshoj! Nuk besoj! Jo Rembrand. Jo. As etyd.

Vetëm kaq tha. Jo tha, po foli lehtas me vete, nëpër buzë.

Përjashta Galerisë, përtej në trotuar, më në fund ndaloi, hoqi syzet, u kthye nga Peshku i Kuq, qeshi e shikoi drejt, e pështolli me krahët e gjatë dhe e puthi. Dhe qau. E di sa u preka? Edhe tani që e kujtoj prekem. Për kokën e mamasë!

Qante nga gëzimi që atje ishte me të. Që u takuan bashkë atje te Rembrandi. Nuk ta shpjegoj dot, nuk ta shpjegoj dot. Po çmendej nga gëzimi. Si të dashuruar. Si fëmijë pa të ligë në shpirt.

Dhe nisën menjëherë të flisnin sikur çuçurisnin. Mua më harruan fare. Ore, unë mendoj se ata kanë miqësi intelektuale. Dhe këtë miqësi nuk e gatuajnë me fjalë strategjike. Etj. Ë!

Peshku i Kuq pat ikur me urgjencë me trenin e parë për Tiranë, kishte vizituar nënën te një mjek me rekomandim, seç i kishte bërë disa analiza dhe pastaj e kishte shoqëruar te Sheshi "Skëndërbej" dhe e kishte ulur pranë Monumentit. Rri një çikë

këtu, i kishte thënë. Rri, moj nënë, sa të vete diku aty për një punën time dhe vij prapë e të marr unë.

Ajo s'kishte luajtur nga vendi. Dhe e gjetëm ashtu: të mbledhur, të vogël, po me sytë që i lëviznin duke parë andej-kënde. Si tani e kam në kujtesë. Si pikturë.

U gëzua kur na pa dhe u hodh përpjetë dhe s'e kupton se si çmallej ajo me shokun e djalit. Tërë dashuri! Ç'të të them, se ç'bënin ata! Të thoshe ti: kishin ardhur nga ana e anës dhe qenë takuar dhe tani e tërë bota kishte mbi vete vetëm ata të tre. Ata të tre ishin gëzim. Ata të dy do vdesin adoleshentë dhe do të jetojnë në epokën e tyre: në epokën e adoleshencës, sidomos Djaloshi i Pashëm. Se kanë lindur për artistë.

U bë pak heshtje.

- Ndahemi? - tha ai.

I zgjata dorën dhe i thashë:

- Po ata?

- Mund që tani të jenë ndarë, po mbase hanë darkë bashkë dhe shikojnë në televizor, apo bëjnë ndonjë diskutim për artin.

Pompisti nxitoi. Unë gjithashtu duhej të nxiroja. Dhe nxitonin në trutë e mi mendime. Një tjetër ngarkesë e tërë mendimesh për ata të dy. Për ata që u larguan nga lokali i klubit aq të zemëruar! Pa shih se! Te Rembrandi! U takuan duke menduar se do të shikonin një punë të Rembrandit! Një pjekje e tillë për të gëzuar sëbashku tregon se ata fshehin një dashuri marrëzore për njëri-tjetrin dhe artin e madh... atje përjashta Galerisë... e shikoi drejt, e mbështolli me krahët e gjatë dhe e puthi. Dhe qau. Djaloshi i Pashëm kështu!

Legjendat e vjetra tregojnë shembuj prekës mbi miqësinë. Eh, vëllajo! Këta të dy duhet të jenë fare ndryshe nga ç'i kam pandehur! E kam thënë me vete: Nuk qëndroka kot qoftë edhe Pompisti me këta.

Matrapazët nuk mund ta duan mikun kështu me kaq pasion, siç duhen me një tjetrin Djaloshi i Pashëm dhe Peshkui Kuq. Dhe as që mund t'i lidhë ndonjë gjë kaq e rëndësishme se arti me miqtë e tyre.

Në cilën vepër të shkrimtarëve tanë kam lexuar për miqësinë e vërtetë? Hë, më thoni: Në cilën vepër flitet për miqësi? Në jetë patjetër që ka miqësi të tilla.

Apo jam i lodhur? Ndryshe një mungesë e tillë do të ishte boshllëk i ndjeshëm! Si thua ti, shoku shkrimtar? Por unë jam i lodhur. Mundet që e kam nga lodhja harresën. Ë? Harresë?! Edhe është natë. Natë.

5

Pas ca ditësh, tërë pasdrekët s'dola. M'u ndez vullneti i madh dhe punoja si i urituri. Duke punuar mendova se, po të çërrinte zilja e telefonit, apo zilja e derës së jashtme, nuk do të ngrihesha nga tavolina.

Herë pas here pija cigare me kënaqësi dhe, për një çast ndiqja rrotulimet e tymit të kaltër që silleshin përtej fytyrës sime, mbi kokë dhe nëpër dhomë. Doni të jeni të lumtur? Punoni! Po ju këtë e dini. Më falni! E thashë për vete.

Befas në trurin tim të zhytur në mendime, për punën që hidhja në letër, se çërriti një zile. Ajo nuk stakohej. Çërritja ishte e gjatë e vendosur dhe unë dola nga mendimet dhe ngrita mjekrën. Përballë, te skaji i tavolinës më shikonin të dy fëmijët e mi. Ata luanin me topa bore dhe ishin gati të më qëllonin. Po u qeshej, se shikonin fytyrën time të nutuar.

Ata janë ende të vegjël. Qenë në fotografi dhe unë erdha në yete dhe arrita t'u buzëqeshja. Ajo fotografi që bërë në kopësht, në fshat, para disa vjetësh, kur u martua im vëlla. Që dhjetor me borë atëherë.

Dikush trokiste në derën e përjashtme të apartamentit. I binin ziles... dhe trokisnin. Kjo zile s'binte para disa vitesh kur që dhjetor me borë dhe në fshat ne bënim dasmën sepse do të

martonej vëllai. Kjo zile bie tani pas kaq vitesh, në këtë ditë prilli. Kaq kohë që bie.

U përmenda plotësisht. U çapita dhe dola në korridor. E po mirë, thashë, mirë. Pas këtyre orëve të lodhshme në punë, dikush mund të hyjë, mund të ziejmë kafe dhe mund të bëjmë pak muhabet. Një javë që s'kam dalë nëpër lokalet e qytetit.

Përsëri mollëza e një gishti te butoni i ziles. Gishti i cilit njeriu do të jetë ai që ngulmon t'i hapet dera e apartamentit tim? Ndofta... Ndofta ajo fqinja e famshme me shishen bosh që lyp hua vajguri?!

Hapa derën. Qe...

- Urdhëroni!

Qe Djaloshi i Pashëm.

- Më falni - tha.

Foli sikur po dridhej.

Ai po dridhej dhe fytyrën vërtet e kishte të shqetësuar.

Ditë më parë, dikush më qe betuar se ai, Djaloshi i Pashëm që sillej me aq kryelartësi, kishte raste që shtrihej në krevat ashtu i vetëm dhe vinte pëllëmbët te koka dhe, duke shikuar një punë të dashur të Rubensit, për shembull, apo duke shikuar Vrubelin niste dhe qante me ngashërim. Pastaj shkundej, ngrihej, pyeste diçka që e kishte në kokë vetëm ai, diçka që i bubullonte në shpirt, merrte kavaletin dhe dilte të punonte diku në natyrë. Ai është shumë punëtor. Shumë këmbëngulës. Asnjëherë nuk pushon që të vizatojë.

Tani ky njeri ndodhej ballëpërballë meje pa kavaletin, po me tronditjen që dukej haptaz dhe me një mundësi lotësh që ndofta do t'i buronin papritur.

- A mund të hyj?

- Urdhëroni, - i thashë.

- Më falni, - tha përsëri. Fytyrës së tij i mbiu një të kuq i thellë dhe ai u bë simpatik dhe i turpshëm si një femër e sinqertë.

Ç'ti këtë ngjarë?! shkroi vetëtimthi në kompiuter makineria e trurit tim.

Ai hyri, u përkul pak, zgjati dorën te këpucët, por unë e

kuptova se dëshironte t'i thoshe: mos i hiqni këpucët.

- Mos i hiqni këpucët, - i thashë.

- Faleminderit, - tha. - Faleminderit, nuk po i heq.

Shpina i bënte vërtet një hark të bukur.

I tregova dhomën e punës dhe u ulëm në kolltuk përballë njëri-tjetrit. I zgjata cigare, por ai vuri pëllëmbën në gjoks dhe tha faleminderit. Unë e ndeza. Midis nesh një çast qëndroi pezull një shtëllungë tymi. Do të jetë grindur përsëri me Peshkun e Kuq, mendova. Do të jetë grindur dhe do ta ketë qëlluar.

U ngrita, vendosa në tavolinën e ulët dy gota të vogla dhe hodha raki. Ai nuk shikonte hiç përçark. Të dhjetë gishtat i kishte vëllazëruar me njëri-tjetrin dhe s'i ndante. Shikonte në taketuke. Ai s'shikonte në taketuke, po te shqetësimi i tij.

Janë grindur së dyti dhe e ka qëlluar, thashë me vete dhe m'u përhi aq i mjerë dhe aq i brengosur Peshku i Kuq. Të dy të mjeruar. En! edhe dy mjeranë të tjerë në këtë qytet.

- Eh, - psherëtiva së brendshmi.

- Gëzuar! - i thashë.

- Të mira! - tha. Ai pëshpëriti.

Çukitja e gotave bëri tingull të përhumbur. Ai qe i zymtë. Ky njeri me këtë zymtësi bëri atë dialog atë pasdite, në lokalin e qytetit, ku ishim së toku me Pompistin dhe atë... Peshkun e Kuq. Ky...

Hapi duart, ngriti mjekrën dhe u mundua të buzëqeshte. Ai bënte buzëqeshje të bukur. Po atë çast buzëqeshja e tij qe e mjerë.

- Asgjë, - tha. - Po është mërzitur a!

Sytë e Djaloshit të... të Pashëm qenë të thellë dhe tepër shprehës: me dramë. Ky mund të bëhej aktor drame, thashë me vete.

- Ai është mërzitur shumë!

Foli si varfanjak dhe m'u duk sikur iu varën supet. Sikur qe dehur nga mjerimi dhe mbërriti këtu që të vuloste fatkeqësinë.

E shikova drejt. Menjëherë e kuptova se a'qe Peshku i Kuq.

- Pse? - i thashë.

Djaloshi i Pashëm psherëtiu, vëllazëroi përsëri gishtat dhe, nëpër buzët që kishin një fillim përpëlitjeje të pandërprerë, u thanë fjalët:

- Një javë që s'i hiqet mërzia!

E shikova drejt: Pse?

- Seç i kanë dalë ca gjëndra, gjëndra dhjamore dreqin! Shpresojo! Po ai thotë: "Kam kancer".

Bobo! Tmerri i vdekjes është më tmerr sesa vdekja! Peshkun e Kuq me siguri e ka kllaposur ai tmerr: Vdekja! Kanceri! Natyrisht... Vdekja është ligj, po jo ndëshkim i tillë, dashuri! Të mos vijë me të tilla dhembje të gjata llahtarëse, së paku!

- Ai nuk ka kancer, - thirra befaz me zë të lartë dhe i inatosur.

- Nuk ka kancer, - tha edhe Djaloshi i Pashëm dhe u mundua të buzëqeshte sikur unë t'i kisha dhënë përgjigjen e biopsisë. Po s'qeshi, s'u gëzua. Iu mbushën sytë me lot. Pellgu i tyre më preku thellë.

Papritur u kujtua sikur ta kishte kuptuar se po bënte faj të palejueshëm dhe buzëqeshi dhe u mundua të fshinje sytë me rizën e dorës. Pastaj nxori shaminë e pastër e të hekurosur me shumë kujdes, dhe thau pellgoret e lotëve.

- Më fal! - tha.

- Më vjen keq, - i thashë.

- Është njeri shumë i mirë, - tha. - Po se ç'i shpik mendja ca diagnoza të çuditshme. Dhe do të vete të bëj tomografi edhe për mushkëritë, thotë! Ja!

Pas kësaj u bë heshtje. Pastaj ai tundi kokën dhe mermëriti:

- Hë dreqin! T'i hipë tjetrit në kokë se i është shpifur kanceri! Por jo, jo! Unë e kuptoj si qëndron puna. Ai kaloi të tridhjet vjeçët dhe... Është mashkull! Dhe mashkulli duhet të bjerë në femër, domethënë... Se ai ka energji. Domethënë... Duhet të martohet! ai, akoma! Ndaj mendja i shpik sëmundje të liga. Më falni që ju shqetësova! Ju lutem, mundohuni edhe ju ta

qetësoni! Ju nuk e dini, s'e merrni me mend ç'njeri i mirë është!
E kam njohur që në klasë të tretë fillore. Jo, faleminderit, vetëm
këtë gotë do të pi. Pija dhe duhani të bëjnë rrudha në fytyrë.
Nuk mësonte dreqi dhe në fillore kishte mbetur dy vjet në një
klasë. Kështu që, nga turpi i ati e solli në shkollën tonë. Fshat
them! E ç'fshat: dy shina hekuri midis! Dhe kësaj lagjeje i thonë
qytet. Paçka!

Para Luftës ky qytet ishte një dorë shtëpi. Aty-këtu ishin
vilat e ca bejlerëve që ngriheshin më vete dhe sikur i bënë
karshillëk njëra-tjetrës. Ca më tej ishim ne, si mëhallë. Ne qemë
ca më pak. Pak kasolle. Aty s'kishte vilë, se s'kishte bej. Këtu
thuhej qytet, atje te ne: fshat. Ja: dy pëllëmbë më tej. Nejse.

Pas Luftës, këto njëzet vjetët e fundit sidomos qyteti u
zgjerua shumë. U bë qytet. Po bëhej. Po bëhet. U katranos,
thuj, siç e sheh. Po... Nejse. Ne atje u zgjeruam, deomos, dhe
s'mbetëm mëhallë, po u bëmë fshat. O po, s'arritëm të
bëheshim as tamam fshat, se u bashkuam me qytetin. Tani, ose
këtij qyteti do t'i thoshe fshat, ose asaj mëhallës sonë do t'i
thoshe qytet. Po s'i mendoj njeri këto. U bashkuam, po s'u
bëmë një! Në një furrë gatuhej buka, në një dyqan me një lagje
të këtij kryefshati e blinim. Ushqimet e zarzavatet i merrnim ku të
donim. Dhe s'na vente mendja neve për nga këto ngatërresa!
Mendonim për gjëra të tjera. Do të vinte treni dhe, ne ashtu siç e
përftyronim, e vizatonim atë të gëzuar dhe me nxitim. As që na
shkonte në mend se një ditë do të mësonim edhe fjalën tailon.
Ehu!... Neise.

Po, që të vinte treni, duheshin shina. Dhe shinat i
shtruan midis. Dhe del tani tjetri mu në mes të rrugës dhe të
thotë: Fshatar. O fshatar! të thotë. E pse?i Sepse kalojnë midis
dy shina treni! Hë!

Po nejse, ajo punë do të rregullohet. Do të! Lëre me:
Do të!

Po ky, tani ka nisur të thotë shpesh: Jam sëmurë, jam
sëmurë.

Atëherë kur i ati e solli në klasën e dytë në shkollën e
fshatit tonë, ne rrinim në një bankë. U bëmë shokë. E di ç'shirt

të bukur ka! Ohu, s'e merrni me mend! Ai e ka brilant zemrën!
Që atëherë, që i vogël, gdhendte në dru.? Mundohej të
gdhendte. Po, po edhe... ai gdhend. Jo të lutem, s'e pi duhanin
dhe them të mos pi kurrë. Ndofta ngaqë s'e pimë, në fisin torië
jetojnë gjatë. Gjyshi... Nejse! I ati i këtij që i flasin me shaka
Peshk i Kuq që marangoz dhe nuk është trembur kurrë nga
fëmijët. Nëntë fëmijë në shtëpi. Edhe unë vizatoja, edhe ky
Peshku i...vizatonte. Shikonim ato figurat e abetares. I përpinim.
Ky qe i etur pas skulpturës klasike, pas mermerit. E merr me
mend ti ç'njeri i çuditshëm dhe ç'zemër ka ai njeri trupvogël! që
punon në këtë kryefshat, apo si i thonë: në qytet, me triçikël!
Ah, si është njeriu, o shpirt! Ai rrinte atëherë me orë të tëra
pasditeve përpara shtatoreve të mermerta në Muzeun që po
ngrihej me zbulimet e reja dhe me ato që sillnin andej-këndej.
Habitej nga gdhendjet e manteleve, velaturat e punuara nga
mjeshtër të lashtë. Atij i pëlqejnë gjërat e bukura. Na ke parë
ndonjëherë të dielave ti këtu nëpër lokale? Ikim, dalim në natyrë.
Ai çmendet për natyrën, për detin.

Babai i tij, të thashë, punonte marangoz dhe kishte në
shtëpi skarpello dhe dalta të holla, të rrumbullakta dhe lima të
rrumbullakta. I merrte fshehura ky dhe gdhendte në dru arre. Ja,
atëherë që erdhi te ne në klasë të dytë gëdhendte në shkumës
Skëndërbeun. E gëdhendte me një gozhdë pllakë dhe me pajë
pene. Xinë, i thoshnim. Vizatonte me laps. Ohu, tërë orën e
mësimi vizatonte, vizatonte. Punonte shumë bukur hijedritën.
Merrte e bënte top balte dhe e bënte me shpatull prej kallami.
Jo, s'ka lexuar dreqi! Mirëpo në shkollë edhe mbase vente, po
edhe babai e kërkonte mbështetje. Nëntë fëmijë! Babai e
kërkonte krah dhe e futi marangoz që të vogël. Që i vogël në
punë ai! Mbante motra dhe vëllezër me bukë. Se edhe babait iu
këput shëndeti shpejt. Tani iu mëkëmbën ca motrat e vëllezërit,
po ky që ju e thërrisni Peshku i Kuq atje në punë u aksidentua i
shkreti.

Po artin e do, s'i ndahet. Dean e ka në shtëpi. E ka
derdhur vetë në tastelë. Shtëpia e kulturës në Shtuf ka të
gëdhendur në allçi atë "Burrin e vogël". Në një vend tjetër ka

bustin e një "Bujku". Punonte më parë! Tani, kështu... po është njeri i mirë. Mos. Po mundët, ju lutem, thuajani një fjalë të mirë që ta heqë mendjen nga ato drej fiksacione. Më falni!

U ngrit në këmbë. Atë kohë u kujtua të shikonte përçark.

- Duhet të martohet, - belbëzoi.

- Duhet, i thashë. - Patjetër, ndofta! Ai duhet të bashkohet me një femër.

Djaloshi i Pashëm më shikoi drejt; pakëz me frikë dhe tha:

- Edhe unë do të rregullohem së shpejti. Ja, sa të marr edhe studio...Ajo puna e shinave!... Po, s'më mërzit shumë ajo: do të rregullohet, do të...! Lëre me: *Do të!* Qenke fshatar! ; se midis kalojnë dy shina hekurit! Ehu!... Ç'është kjo vajzë këtu?

lu qas fare pranë një fotografie sa pëllëmba e dorës.

- O ç'kafkë e bukur! - psherëtiu. - Ç'bust!

- Është mbesa, - i thashë.

- *La niece*, sigurisht.

- Po.

- Shumë mirë, - tha. - Ju lutem, bisedoni diçka me kujdes me të. Është njeri i mirë.

Ai fliste, dhe mendohej të shikonte akoma te fotografia e mbesës.

- Ai Aktori... - i thashë.

-E mo, ai Aktori! Ai ngjan si bari i dhënëve të patufëzuara.

Gati m'u qesh. Atë kohë ai s'duronte shaka. Se bisedohej për mikun e tij. Shikoi tavanin e bardhë dhe përpëliti qerpikët. Vërente mendueshëm. Iu çkollitën buzët dhe foli pa më shikuar:

- Dola përjashta në oborr natën dhe u ula atje te stoli im që kërcet. Atje në qoshe të oborrit në shtëpinë time kemi një stol që kërcet. Kërcet, po të ulesh dhe të lëvizësh. Rrija dhe mendohesha. Sytë m'i rrëmbeu qielli me yjet. Sikur lexoja atje lart fjalë të ndritura të ndjesëmadhrit Sami që ka shkruar të "Shqipëria ç'ka qenë". Njeri i madh!

Ai nuk foli më, po më tundte kryet si i lojtur. Unë e dija se në ç'raft e kisha atë libër të Rilindësit tonë, dhe, pas një çike, si erdha në vete, se ai ishte Djaloshi i Pashëm dhe jo *I Lojturi*. E zbrita nga rafti.

Djaloshi i Pashëm ma rrëmbeu librin dhe shikonte fotografinë dhe foli me vete:

- Ç'kafkë madhore! Shih! Ç'ballë!

- Ashtu vërtet, - mërmërita.

- Dua ta pikturoj, - tha.

S'fola.

- Ai mund të pikturohet, vetëm pasi të thithet i tërë mendimi i tij. Dy net rresht jam përpëlitur në shtrat dhe kam menduar e kam menduar, duke mos gjetur rehat atje te stoli i oborrit, kur lexova te ky libër që shkruan se shqiptarët, vendasit e tij *"As në qeverit as në besët nuk donin një vetë, që bën ç'do, po u kish ënda këshillën e kuvendin' e shumëve"*. U bëra krenar, u llahtarisa nga gëzimi. Këto fjalë sikur i kanë shkruar gjenitë e demokracisë.

Dhe tani dal natën përjashta dhe mendohem: Të pikturoj Samiun tonë. Në ballin e bukur, tek ajo pjesa e kafkës, ku janë tërhequr flokët, te sytë, të lexohet mesazhi i tij madhor: *"As në qeverit as në besët nuk donin një vetë, që bën ç'do, po u kish ënda këshillën e kuvendin' e shumëve"*. Shemsetin Samiu me intuitë prej demokraci, hamendësoi rëndësinë e demokracisë. Ai hamendësoi rëndësinë e aktivitetit të masave popullore në jetën politike. Sigurisht Partia jonë e lavdishme! e kanë gjak vijën e masave, këshillën, kuvendin e shumëve. Siç e dini! Ë! Mirë, e lëmë me: *Do të!* Ama, i lumtë trurit të kësaj kaike, i lumtë Samiut tonë, se që i pari që, në Shqipërinë gati mesjetare, hodhi këtë mendim kaq të përparuar. Natyrisht, për atë kohë. Sot, ohu!... *Do të!*

- Nuk ndodhem në studio në apartamentin tuaj? - pyeti.

- Aty ndodhemi, - i thashë.

- Të shqetësova. Ngrite tavllën dhe shikove nën të!

Edhe këtu dyshon se mund të të venë *ashtu*. Më fal, më fal!

Fra, miku im, ky Samiu që hamendësoi rëndësinë e

demokracisë, që të pikturohet, duhet të njihet mirë vepra e tij. Dhe këto bëmat e kohës sonë. Këto!: Do të! Më fall Jo të dërdëllisësh kështu keq si unë! Domethënë: i papërgatitur.

Djaloshi i Pashëm heshti, shikonte fotografinë e rilindësit dhe tundte kokën lehtë.

Iu mbaruan fjalët.

- Të pimë nga një kafe, - thashë.

- Faleminderit! Ju lutem, më falni! A thoni do të dilni pasdite?

- Po.

Ai nxitoi dhe belbëzoi:

- Ju bëra pis qilimin.

Në qilim s'kishte mbetur asnjë gjurmë pislleku. Sikur të mos kishte shkelur askush.

Mbylla derën e jashtme dhe dola në dritare. Ai nxitonte tërë elegantë. Qe i pashëm. Pikë. Dhe është njeri i mirë. Pikë. Është miku i tij kështu duhet të jetë. Pikë. Ky pra është thelbi i tyre që unë kërkoja të zbuioja. Tani më duhet të thellohem. Po Peshkut të Kuq, gjithsesi duhet t'i hiqet nga mendja ajo lloj vuajtjeje. Tani çështja e jetës dhe e vdekjes ka të ngjarë të shtrohej si shpesh tek ai. Eh! Ajo edhe kur është imagjinare të tret, të bluan.

5

Domosdo që dola atë pasdite. Tek i njëjti lokal. Kishte fare pak njerëz. Më vonë, sigurisht, aty do të grumbulloheshin të tjerë.

Në pozicionin e zakonshëm, në një tavolinë të vetme, i vetëm rrinte Peshku i Kuq. Ai qe si një kufomë pa kocka dhe barku i tij ngjante pjellor. U gëzua kur hyra unë dhe e shprehu: U ngrit dhe doli nga karrigia dhe u ul pasi u ula unë.

- Ç'do të pish? - më tha.

- Kafe.

- Edhe unë kafe, - tha ai.

Na sollën dy filxhanë me kafe ekspres.

Kur i zbrazëm filxhanët, ai shtriu dorën e majtë të rumbullt dhe me gishtin tregues të dorës së djathtë shtypi diçka si kokërr ulliri nën lëkurë, sipër kyçit të dorës së majtë.

- E sheh? - më tha.

Unë lëviza lehtë gishtin tregues mbi të. Ajo qe një lulgë që mund të mos e vije re. Kisha parë të atilla.

- Gjendër-dhjamore.

- A thua?

- Ik hiqe. Si të duash, - i thashë. S'kisha pse të shtiresha.

Fola me bindje se s'më ngjalli asnjë dyshim dhe diçka dija për gjendrat dhjamore.

Atij i hipi një të kuq i bukur. Eh, një fjalë e bukur! thashë me vete. Një fjalë e vetme e bukur për të shkretin njeri!

- Do të martohem. - tha.

- Duhet, - mëmërita.

- Qëllova në një vajzë të mirë, po qe e gjatë, - tha.

Ai po fliste aq singërisht, sa s'mund ta harroj.

- Të pillni fëmijë të gjatë, - i thashë.

- Bah!

- Mos e shty këtë punë, bre, mos!

- Do të rregullohem, do të rregullohem, - tha. - Vetëm

këto koqera të mos jenë gjë.

Ai tregoi gjendrën dhjamore.

- Ato janë hiç, - i thashë.

- E mo, s'janë gjë! - tha dhe ndjeva se bëri përpjekje të largonte ato që kishte në kokë. - S'janë gjë këto! - tha prapë.

U bë heshtje. Unë shikova përjashta përmes xhamllëkut. Më dhimbte qafa.

- Më dhemb qafa, - i thashë dhe shtriva kokën prapa.

Qafa kërciti.

Ai zgjati dorën dhe nisi të më fërkonte damarët.

- Vij unë në darkë të t'i vras me një çikë raki, - tha. - Dhe të lirohet, për besë.

S'fola. Shikova përmbi xhamllëk, te një peizazh i vendosur rishtaz.

- Babai im qe marangoz, po bënte vetë vjersha dhe i këndonte - tha.

Mundohesha akoma të lexoja peizazhin dhe se si, po diku nëpër atë peizazh, m'u përhi figura e një njeriu që e kisha parë tërë kohën të përkulur, tërë jetën duke hequr zdrukthin dhe duke goditur me sqepar. Dhe mendja e tij bënte këngët dhe goja i mbushej me këngë. Peizazhi i tërë ishte i mbushur me këngë. Qielli i atij peizazhi premtonte begati. Nëpër këto ngjyra kishte vegime lumturie. Shikoje atje dhe ndjeje erë bukuri e bollëk. Ne, për një çikë, do të bëhemi fare të lumtur.

- Atëherë kur qe marangoz. Edhe tani, me këngë shkon në radhë të qumështit. Apo diku. Këndon ulët. Sikur qan me këngë.

- Peizazhet e bukura janë si këngët e bukura, - i thashë.

- Babam! - ia bëri. Ia bëri ashtu dhe uli sytë si i trembur.

Lëviza në tryezë dhe e shikova drejt. E shikoja disi me çudi.

- E di sa mirë është motra ime në piano?

- Ku? - thashë. Unë s'e dija se cila qe motra e tij dhe për ç'motër fliste.

- Lart në konservator, - tha. - Po tani jemi më në rregull ekonomikisht. Se punon edhe një vëlla nën mua. Po... edhe unë jam si prind, or babam! Punoj për vëllezër e motra më të vegjël.

E shikoja drejt pa folur.

- Si prind, or, të them! Ka familje që ngrihen e ecin me dy prindër. Ne jemi tre. Jam fëmijë i punës! Po im atë ka qenë trim: nëntë fëmijë ka bërë. Motrën e pianos atje në konservator e kam në ngarkim vetë. Nuk e lashë të humbiste, se ka talent. Ndryshe... edhe mund të humbiste. Nëse ajo bëhet pianiste, Bahun nuk do ta dëgjojë vetëm ajo, unë, apo në familjen tonë. Apo jo, fol! Ë?

- Ashtu, - i thashë. - Ashtu.

Flisja përhumbur.

- Domosdo që ashtu, - tha dhe me mollëzën e gishtit tregues të dorës së djathtë lëvizi nëpër lëkurën sipër kyçit të

dorës së majtë. Sikur atje të priste një porosi.

Unë shikoja akoma peizazhin.

- Peizazh i bukur, - mërmërita.

Ai ngriti kokën pa interes të veçantë dhe e rrotulloi prapa. Prapa, sipër mbi krye, ishte një pikturë tjetër. Ajo kishte qenë prej kohësh. Peshku i Kuq e shikoi më gjatë dhe fytyra ca nga ca iu murrëtye akoma.

- Ama, sa e mirë është kjo kamarierja! - tha. Kështu!... foli papritur dhe shikonte kamarieren. Ajo ishte shumë e pastër, mesatarisht e gjatë dhe shpatullane. Flokët i ngrinte topuz dhe qafa e bardhë, e përsququr atje ku fërkoheshin vetëm rrobat e lehta të saj.

Unë i hoqa sytë nga peizazhi, shikova për një çast kamarieren që lëvizte midis tavolinave për të vendosur më mirë karriget, pastaj shikova drejt Peshkun e Kuq: Ç'domethënë?

Ajo sakaq iku dhe unë dhe Peshku i Kuq shikonim se si tundeshin ijet e saj me atë bukuri të thjeshtë e të ndershme në të njëjtën kohë.

- Dash! - bëlbëriti Peshku i Kuq.

Unë përsëri e shikova drejt i menduar: Ç'domethënë!

- Dash! - mërmëriti përsëri ai. Dhe shtoi: Bukuria s'i ka lezet kujtdo. Kjo është e shëndetshme si një dash! Dhe e pastër. Shih!

- Po, - i thashë.

- Vëre re, - tha ai dhe uli mjekrën në sheshin e tavolinës.

- Vëre re sa e paqme duket këtu me këtë veshje të lehtë të bardhë të hekurosur. Vazhdimisht të hekurosuri! Është edhe ambienti i tëri i pastër dhe me dritë. Në shtëpi, pres kokën, s'ngjan e tillë. Këtu të dredh. Betohem. Eh, sa ka të bëjë ambienti!

S'foli. E shikova drejt. Dhe me gjithë këto s'm'u duk epsharak. Kurse kamarierja qe epshndjellëse.

Ai vazhdoi ta shikonte edhe pak kamarieren, pastaj uli kokën. Po trette në vetvete, si dukej, një dëshirë të tij të ëmbël, të cilën e bluante me mendje ashtu siç dëshironte, siç qe vetëmësuar.

Prapa kamarierja po nxitonte drejt nesh. Kryet tona ishin ngritur. Në buzët e bukura të saj lodronin fare lehtas nënqeshje të qeta e bujare. Oh, si pikonin ato pafajësi nënqeshjesh në zemrën e etur të Pëshkut të Kuq!

- Është e ndershme, - tha së fundi, duke prishur heshtjen e tavolinës dhe tundi kokën dhe psherëtiu dhe sytë e enjtur me qeska përherë të përgjumura, pothuaj u pulitën. Ai vazhdonte të ëndërronte.

Mua më dhëmbi një çikë shpirti. T'ju them të drejtën më dhemb palca e shpirtit. Ai tani s'është i qetë. Unë e di. Është një pëllëmbë fizikisht pranë meje. Nuk ka qetësi. Mundohet me bërftyrim të afrojë sa më pranë atë që dëshiron. ai dëshiron një femër të mirë që ta ketë grua të tij. Atë s'e ka akoma.

Eh! Sa ka të bëjë ambienti! psherëtiu ai pak më lart.

Ambienti po, mund të të zvogëlojë. Ose të fal drejtësisht dimensionet që të takojnë. Ose të bën hatanë: Ngre mediokrin dhe të ndershmin e shpall tuhaf!

Kështu edhe me femrën. Prandaj, ka lindur ajo. Që të bëjë një nga të dyja. Prandaj tani ai, mbase ashtu në heshtje, i qahet mamasë së tij që s'e bëri... më të bukur. Po ç'është bukuria?

Kam lexuar dikur diku poezinë e një poeti që i qahet mamasë së tij se, pasi rendi prapa gjurmëve të një vajze që e quanin MMMM, u kthye më në fund në dhomën e tij të ftohtë dhe i shkroi, pra i shkroi mamasë, pse s'mundi ajo ta lindte më të bukur! *Që MMMM me shpirtin si deti, të ngopej nga shpirti i një poeti!*

Po ç'është bukuria?

Ai poet e gjeti se si e donte, se ç'bukuri kërkonte M. ato dy ditë, ato dy muaj, apo dy vjet. Po pastaj? Pas dy javësh, pas dy vjetësh, si të ishte përsëri i bukur për M? Po pas nëntë vjetësh?

Ç'është bukuria?

Nder i dheut! Peshku i Kuq, megjithatë, ka shpirt të thjeshtë: më dhimbet. Sa i çiltër, sa i mirë është! A s'është i bukur, moj M, diçka e mirë, e sinqertë?

A ka vërtet një faj të madh M?

Ai shtriu mjekrën dhe kapakët e syve u hapën. Psherëtiu. Fytyra e tij po zbonte mërzinë, por ajo që zverdhur. Genë zverdhur veçanërisht qeskat *me gjumë* nën sytë. Trishtimi s'mund të ketë tjetër pamje. Shpirti im s'ka orë tjetër për dhimbje.

Ishte qetësi. Askush s'kishte hyrë për kafe, prandaj edhe aparati i ekspresit s'bënte zhurmë. Diku në një tavolinë atje në krye që ulur kamarierja. Ajo kishte mbështetur pa të keq mjekrën e vogël te pëllëmba e hijshme. Sa simpatike që ajo, e tëra, kamarierja!

- Pusho, - thirri befaz Peshku i Kuq. Unë s'kuptova pse thirri. Gjithashtu askush s'bënte zhurmë. Ai ngriti gushën nga syprina e tavolinës dhe shtrembëroi kokën në mënyrë që veshi i majtë të shikonte nga xhamllëku. Veshi nuk shikon! Ai dëgjon. Që veshi i tij të dëgjonte diçka. Një zhurmë. Një zhurmë që i interesonte atij!

U bë i tëri vesh. Ndërroi përnjëherësh. Kërceu banalisht dhe nxitoi midis tavolinave dhe mënjanoi një rën fletë të perdes së lokalit dhe u mundua të shikonte përjashta. Shikoi fare pak.

U kthye tek unë, më tha: "Erdhi makina, mund të ketë qefull, paguaj kafet".

Dhe iku.

Te dera u përplas me Djaloshin e Pashëm. Diçka i tha në vesh dhe nxitoi përjashta. Fytyra e Djaloshit të Pashëm u bë e ngrirë. Ai mbeti si pikëçuditëse, pastaj vërejti në sallë dhe më shikoi. Kamarierja dërgoi pak gaz në buzë, krejt përhumbur dhe pafajësisht si ngaherë.

7

- Ulu këtu, - i thashë.

- Ju lutem, ju lutem, aty - tha.

Unë lëviza karriken dhe ai zuri vënd te pozicioni i përhershëm. I ktheu shpinën faqes së patinuar të lokalit.

- E? - tha.
- Gjendër dhjamore, - i thashë.
- Gjendër dhjamore, - tha edhe ai.
- S'qe i shqetësuar, - i thashë.
- U lodh , u lodh me shqetësimin - tha.
- Jo, po e ndien qënia e njeriut kur ka diçka të ligë.

Pastaj ai e kupton se duhet të martohet dhe..

- E, e, - tha . ai s'donte të flisnim për martesën. Shikoi pjerrtas dhe lëvizi kokën.

- Iku si i xhindisur, - tha.
- Për qefull, - i thashë.
- Po, për qefull. Dhe s'e do për vete!
- S'e do për vete?

- Bah! Kushedi se kujt do t'ia japë. kam halle, thotë. S'i mbarohen hallet!

Djaloshi i Pashëm shikoi një hop të gjatë në një tavolinë. Atje qe një burrë i vetëm dhe lexonte me vëmëndje gazetën.

- Lexo grafikë-shifrash, o fukara! - belbëzoi ai. I belbëzoi ulët vetvetes. Por unë isha fare pranë!

- Më fall! - mëmëriti pa më shikuar në sy.

Kamarierja solli ponçin. Djaloshi i Pashëm qëndroi akoma më mirë në karrike dhe piu gllënjën e parë, pastaj shikoi përballë te perdet që mundoheshin të fshijnin xhamllëkun. Shikoi përmbi to. Atje te peizazhi që unë tani e vëreja shpesh. Sa here që ndodhesha në atë vend. Disenjatori, mendova, dhe m'u kujtua Peshku i Kuq. Mjafton t'i thoshte Djaloshit të Pashëm se "ti punon disenjator" dhe çdo gjë në sekondë pëhej përshesh.

E shikova në fytyrë. Gjithmonë mbante me vete një shprehje fisnike të intelektualëve të vërtetë. E shikova me vëmëndje. Fytyra e tij qe përqëndruar te peizazhi. Po sikur befas ta pyesja: Domethënë, disenjator punoni? Bëni reklama në ndërmarjen tregtare?

- Unë kam thënë: ta merrni në Galeri, - foli ai. Përnjëherësh sikur m'u duk i lodhur. Më ngjante shpesh kështu: i sflitur, sikur dikush s'e linte të qetë. Pa dyshim që

shpirti i tij luftonte me dikë, ndaj i ziente gjaku.

- Cilin?

- Shikoje: peizazhin! E kanë pasur në sallonin tjetër, po tani e kanë sjellë këtu! Këtu ka më shumë pluhur dhe tym! Ka avull.

- I bukur, - belbëzova.

- Vepër arti! - tha me vendosmëri. Fjalët e tij ranë si masë plumbi: bumb. Syprina e tavolinës s'lëvizi. Po unë e humba: s'mund të flisja. Djaloshi i Pashëm nxori prapë një skedë të bardhë drejtkëndëshe dhe shkroi me gërma të bukura: Arti duhet "të përgatitë ditë më të mira", "të bëjë që e ardhmja të flakërojë".

Ngriti kokën dhe më shikoi dhe më afroi atë që kishte shkruar; atë që... "arti.... të bëjë që e ardhmja të flakërojë".

Ngriti edhe pakëz mjekrën dhe shikonte me vëmëndje peizazhin. Dhe nisi të belbëzonte sikur fliste me vete që të dëgjonte po ai:

- Sa mirë janë zgjidhur raportet e ngjyrave. Ja, kjo po, këtij i thonë art. Por, ah e lënë këtu në tym cigari, në avull e pluhur! Duket që nga kafka ç'drejtor ka ky lokal! Drejtor socialist. Më fal! Ja, nuk shikohet fare qartazi aty shpirti i piktorit, i artistit? Shih sa mirë të shpie në kohë ajo ngjyra brilant e artë e vjeshtës? E gjetur! Me ndjenjë. Vëre re sentimentin. Një sentiment real: ndjenjë. Se njeriu s'është me ca pjesë metalike të ngjitura, po është me mish e me gjak e me zemër. Ë? sa bukur, atje nga e majta, qëndrojnë në raport ajo ngjyrë hurmë në violetë dhe atje mbi to, shih! me ç'kathësi ka përdorur tonet e ngjyrave grunte në të kaftë?! Dhe, të lutem, të lutem, shih si të rrëmben: ngjitu nga e majta lart. Shih se si mbi okrën e artë ka vendosur me aq potencë të bardhën dhe kështu, pa ulërimë, derdhet dielli mbi atë peizazh!

Ai shpjegonte me një bindje që të ngjallte besim. Të bukurën e mbronte me pasion dhe nuk dyshonte te vetvetja. Dhe identitetin e vet e kishte gjetur prej kohësh.

- Ah, ky piktor! - belbëzoi pastaj. - Ky piktor vendos me druajtje figurat! Artistil! Po... s'e marrin në Galeri! Po merre, o

djall, merre; nuk sheh se dëmtohet! Komiteti duhet t'i shikojë edhe kafkën atij që emron në vende të rëndësishme. Mundësisht edhe kafkën. Një i paditur, një i pandershëm, po u emërua në një post me rëndësi, s'është më *një*. Ai është pastaj një *Hata*. Ta themi drejt. Se ai ushqen, shpërndan, shtrin mediokritetin si metastazat. Shkurt: nga NJËSHI vjen HATAJA.

E shikova drejt dhe ngriva. Ç'mund t'u shtojë dhe t'u hiqje këtyre fjalëve?

Po e shikoja ngulshëm. Ai diçka po zgjidhte apo e kishte zgjedhur me mendjen e vet. Shija të zgjon nevojën. Ai është qenie me shije. E njihni? Ja... Aty pranë... ai "tuhaf" i palëkundur duket se nuk sheh asgjë përveç dashurisë së pakufi për artin. Përveç ndershmërisë në jetë. Nuk e sheh? Atëherë vazhdo të mbartësh Mjerim.

U shkunda.

- Ka edhe një peizazh këtu, - i fola pastaj me ngathësi dhe i tregova rapetë mbi shpinën e tij.

Ai nuk lëvizi. Tha:

- Unë prandaj rri në këtë pozicion.

- ?!

- Sepse s'e shoh dot këtë shëmtirë. E kush merret me art, pa! Shyqyr që s'hyn për të pirë kafe në këtë lokal, se s'mundem të marr frymë në të njëjtën sallë me të. Është një mikroborgjez i vocërr dhe merret me një kopësht dhe shet domate fshehurazi! Është *anëtar i...* Më fal, o!

U ktheva pak dhe shikova edhe një herë pikërisht atë peizazh. Dukej se Djaloshi i Pashëm që njeri fare i vendosur për të mos i lëshuar udhë injorancës. Dhe, kur fliste për këtë ai nuk e përmbante veten. Droja për ta mbrojtur me pasion të vërtetën pakëson aftësitë për të gjykuar. Ai s'vuante nga ajo sëmundje: nga droja.

- A ka pranverë brenda asaj kornizë? A mund të jetë kështu pranvera?

Dhe, pas një çike, e vëzhgoi atë peizazh me një vështrim të keq e të rrezikshëm. Në atë vështrim të keq e të rrezikshëm kishte gjithashtu edhe një padjallëzi të këndshme

në vetvete. Edhe mërzi. Se ai vuante edhe pak nga mërzitja. Deomos. Tha vetëm disa fjalë:

- Përdhosje. Dhe guxojnë të varin këtu ku ndërrohen kaq e kaq njerëz për t'u shlodhur. Ja blejnë se autori është anëtar...! Ç'na gjeti, thuaj!

Një burrë i veshur pa kujdes u ul më tej dhe porositi kamarieren me të thirrur:

- Një kafe turke!

- Ty! - ja bëri Djaloshi i Pashëm. - Ty! - bëri përsëri ai i inatosur. - Pse t'i themi kafe turke?! Së paku: spanjolle.

Unë e shikova i çuditur nga të papriturat. Ai nuk shikoi më te burri i kafes turke, por te peizazhi.

- Po shih bre, ç'qiell i ngushtë! Sikur i zë frymën peizazhit. Diçka si njollë e zezë. Katrahurël Plani i dytë e mposht të parin. I treti mermërit i zbehur. Ç'ta zgjatësh: peizazhi nuk ka logjikë. Janë pa vend grija dhe jeshilja, krejt pa vend! E bardha është hedhur brutalisht në ato tone të errëta! Dhe... Përdhosje. Fund e majë...

Ai qeshi, pa iu qeshur. Belbëzoi me ton të lodhur:

- Dhe bën lodrë! Ka mësuar: kërkon të parfumojë me etje gjoja. Dhe kë? Natyrën në atë që e shet për peizazh. Dhe kush? Një mediokër që s'ka pikë zjarri poetik që ta nxisë, ta djegë.

Qe rrëmbyer nga pasione të veçanta për pikturën.

- Plani i parë duhet të tingëllojë me forcë, ndërsa në atë paçavure është i vakët dhe i varfër. Në peizazh ka *drurë*, *pemë*. Po ai biçim piktori s'e sheh drurin e gjallë! Druri i gjallë është mrekulli e natyrës. Natyra dhuron gjenitë. Të silllesh kështu me natyrën do të thotë të insistosh për ta dëbuar atë. Po a dëbohet natyra, o liliput? Natyra që i ka aq të gjallë organet e të folurit! Mor vëlla! Peneli i piktorit duhet të japë gjuhën dhe zemrën e saj. Listi, duke ndenjur me ciganë atje në fshatin e tij, duke ndenjur tamam si artist, bëri atë vepër të madhe. Veprën më të madhe të tij. Se ishte artist dhe kishte zjarr, se e donte natyrën, njeriun, folklorin dhe nuk ndenji e t'i kopjonte ato, po krijoi. Ai, ja këtu, për shembull, aty tek ajo kornizë, a... Po: arti i keq është antiart.

Është detyrë e shoqërisë që të ruajë pastërtinë e artit të vet. Ndryshe... Ndryshe, vëllajo?! Më fal, po s'ka: Më fal!

Ai heshti. Heshti sikur breronte. Ndiante pikëllim të sinqertë ato çaste. Dhe hante përbrenda vetveten. Vetëm pikëllimi i thellë mund të jetë i heshtur, mendova. Ai... po. Është e vërtetë se ky njeri ka diçka nga Don Kishoti. Në një aforizëm të cilën, po të mundesha, do ta gdhendja në gur, shkruhet se ËSHTË FATKEQ AI TEK I CILI NUK DO TË KISHTE NJË GRIMË NGA DON KISHOTI. Pikërisht Djaloshi i Pashëm... Me sa afsh ëndërron ky Djalosh!

- Përfytyrohet planeti pa drurë?! Pa ujin, gjethet, ajrin, çuçurimat e mprehta dhe të gëzueshme të zogjve? Pa diellin, hijen, kuajt, traktoristin që dergjet nën ta, pa fshatarin? Pa qiellin, trungjet, kërpudhat? Po kafka e tij, ai truri nën kafkën e tij s'e ndien lëvizjen, s'ndien limfën, s'i tingëllon mbujtja e sythave, shpërthimi i tyre, tisin e bardhëm që avullon toka nga të plasurat e punuara të gjinjve. Tamam te gjinjtë. Natyra është Poet, babagyshi i poetëve. Poetët e mirë bëjnë e bëjnë t'i afrohen në mijra e mijra vjet Babagyshit të tyre dhe, kush qaset më pranë, ai është artisti më i madh. Ndërsa këta ma vendosin pa pikë përgjegjësie këtë shëmtirë dhe shkruajnë: *Pranverë*. Ja!

Ai flistei sigurt për artin e kavaletit.

- Hë, - ia bëri duke shikuar atë që kishin varur për peizazh. Hë, *Qua pisse!* Në lokal tani hyri një rrugaç. Një rrugaç në kohën tonë: *Qua pisse! Qua pisse*, që vjedh popullin dyfish: shijen dhe lekët. VEÇANËRISHT: shijen.

Ndërgjegjia ime sikur po bindet se atij, çdo gjë që s'ishte e bukur dhe e drejtë, i ngjallte urrejtje dhe mëri. Për ata që pikturonin keq ai lëshonte britma tallëse. Dhe këtë e bënte fare haptazi. Kurdo, në çdo çast të jetës së tij, në tërë rrethanat, po të përballej me një vepër arti të pahijshme, ai nuk e falte.

Mendoja dhe ndieja dhembje se nganjëherë ai më dukej sikur kishte bindjen se ishte një luftëtar i vetmuar. E megjithatë, edhe kështu, ai kishte vendosur përfundimisht: të luftonte i vetëm. Apo kjo ishte e pavërtetë? Se më ngjante sikur i shikoja krahët e tij, sikur i përfytyroja të gjithë rreth tij. Dhe

atëherë e kuptoja përse ishte aq i pafuqishëm e aq i pasigurtë. A i kishte pra përqark të gjithë? Ata, të vërtetit?

Pasioni i madh i tij për artin qe aq i theksuar, sa të dukej sikur pikërisht ku e gjente gëzimin, gjente edhe dënimin e tij më të madh.

Ai pastaj sikur u përmend dhe hapi ngadalë buzët e mbushura tërë gjak! Në faqet iu bënë dy gropëza, mollëzat e ngritura iu përskuqën dhe iu shfaqën dhëmbët. Ata ishin të mrekullueshëm dhe tregonin haptaz se atij s'i mungonte kurrë oreksi.

Gropat te faqet i lëvizën, iu bënë më të theksuara dhe fytyra e tërë iu qesh. Goja thirri furishëm:

- *L'ultima verbal*

Dhe te lëkura e grykës, aty ku mund të ishte nyja, regëtiu diçka. ai u nxi në fytyrë. U bë i frikshëm.

- Mjaft më! - thirri. - Mediokrit duhet të nënshkruajnë daljen e tyre në pension. Më saktë: kjo është detyrë, ndryshe nuk bëhet mik: NUKU! Fillimisht...Por...ah! Shumë larg, shumë! Dhe koha mezi lëviz.

Ngriu sikur të kishte rënë thika pas fjalës së fundit të tij. U bë heshtje. Dhe pas heshtjes së gjatë, ngriti kryet dhe u mundua të buzëqeshte më me mirësjellje sikur të qe njeri fare pa fjalë.

Në lokal hyri tërë frushullimë Peshku i Kuq. Ai mbante në duar diçka të mbështjellë me letër të madhe kafe. Vende vende letra ishte squllur.

- Erdhi *peizazhi*, - tha me mospërfillje Djaloshi i Pashëmi. Peshku i Kuq qeshi i kënaqur.

- Mora, - tha.

- Të marrtë drejti! - tha Djaloshi i Pashëm. - Dhe flet! Ti mbilaçitësh kur do të lidhësh fjalët.

- Or babam, s'bëhet arti pa ngrënë mirë, pa ngrënë peshk.

Djaloshi i Pashëm ngriti kokën e shikoi drejt dhe

heshte, sikur po mëndonte se me ç'nofkë të re të shante. Ata ishin shumë të shpenguar me njëri-tjetrin.

- Po ti s'e do për vete. or drejt! - i tha.

Peshku i Kuq u kuq si i pjekur në tullë.

- Për vete mora dje.

- Po ç'bredh si plënc i palarë, pastaj?

Peshku i Kuq deshi të qeshte, por u mendua dhe uli kokën dhe i foli pranë gushës në vesh:

- Ma gllabërojnë triçiklin, eji! Dhe unë e ti s'hyjmë dot të shesim mend pasditeve këtu! E!

Ai po fliste me një shejtanllëk fshatarak. Dhe më shkeli syrin.

- Po vimë, o vimë.

Djaloshi i Pashëm i foli gati i këputur ato fjalë: *Po vimë, o vimë.*

- Cuk, - ia bëri Peshku i Kuq dhe m'u kthye mua: - Të vjen çudi, ë? Secili e rregullon jetën si mundet.

Djaloshi i Pashëm e shikonte me vëmëndje dhe kur e ndjeu Peshku i Kuq këtë, qeshi me zë të lartë miqësisht. Edhe Djaloshi i Pashëm u bë i gëzuar në fytyrë dhe mërmëriti:

- Ashtu është. Në kohën e lirë, ai, si të ketë prashitur në fermë apo të ketë dursur me shokët në torno, le të argëtohet po të dojë, me pikturën e tij, le të punojë. Por aha, të mos e shesë atë për art, të mos tregojë shëmtira, të mos i sjellë në lokale të tilla publike dhe njerëzit e punuar, pasi të kenë ikur nga puna e lodhshme, pasi t'u ketë shitur domate e qepë nga kopshti i tij, të vijjnë edhe këtu edhe të shohin shëmtinë. Oh! Artisti që dëshiron të merret me art, nuk duhet të eci nën hijen e këshillit të lagjes.

- Vëllaçko, - tha Peshku i Kuq, - shpirti i këtij i bije fyellit në një vrimë, ai këndon për artin. Edhe në ëndërr.

- Po shpirti yt, përse këndon?

- Për bataqçinjtë, - ma preu fjalën ai dhe qeshi si i leshtë.

Ai s'druhej. Dhe mua s'më hutuan ato fjalë. Ndihej qartë se ç'donte të thoshte. Po, megjithatë, unë u hutova pak nga ajo shaka.

- Qefull ishte? - e pyeta për peshkun.
- Me siguri qefull, - tha Djaloshi i Pashëm.
- Katër kile qefull. Ai kasapi u zhdëp në lekë: pret të fillojë shitjen kur grumbullohen shumë njerëz. Pastaj shpejt dhe bam peshores!

- Jepja këtij qefullin, - i tha Djaloshi i Pashëm për mua.

- Ah, qefulli! - ia bëra pa e fshehur lakminë.

Peshku i Kuq qeshi triumfator. Pastaj tha:

- Do t'ja çoj një miku që s'e dua.

- Një përgjegjësi, - tha Djaloshi i Pashëm

Peshku i Kuq s'foli.

- Përgjegjës të tillë duan kopaçe kokës, - tha Djaloshi i Pashëm. Po kush sel

- Hë për hë, unë këto *kopaçe* kam gjetur, - tha Peshku i Kuq. Ai tha kështu dhe ngriti supet si i vobegtë. Sytë i kishte të rrethuar me rrudha dhe i picërronte. Ata i merrnin kështu shprehjen e dinakërisë. Ai qe edhe i egër dhe i përzemërt.

- E vrave atëherë! Prit se e vrave! Oiii!

U bë heshtje. Djaloshi i Pashëm deshi të shikonte shtrembër tek ishte varur peizazhi i shëmtuar. Ai pastaj e shikoi drejt, më në fund, dhe gati breroi. I pulsonte gjaku në tëmtha nga nervozizmi. Tha:

- Ç'është kjo shaka! Të vendosësh në një ambient të tillë këtë tablo? Dhe të thuash: Ja, natyrë! Po a e duron këtë *shaka* natyra? A e duron? He dreq! Pfiil! Një realitet dogmë! Më fal! E: *ç'më fall* se u bëmë banalë!

- S'ka gjë, - mërmërita.

Fytyra e Djaloshtit të Pashëm sikur tha: Ashtu! Epo mirë. Dhe vazhdoi me zë të ulët, po sikur vetë nuk e ndjente se e uli zërin:

- Këta janë kundër kishave dhe xhamive? Po lozhat, podiumet! Opo: u pa, duan të bëhen Krisht e Muhamet!

Mërmëriti Peshku i Kuq:

- Po ne me mendje i qeshim m'u në fytyrë këta.

- Ne e fshehim realitetin- gati pëshpëriste Djaloshi i Pashëm duke sjellë nëpër duar tavilën. - Përkundrazi: ai duhet

parë në teleskop dhe mikroskop. Që ta riparojmë, de! Pooo! Ne kemi mendim të ngushtë dhe e panjohura është e gjërë. Dhe ka kështu shumë tempuj. Më fal se ngrita zërin.

Unë nuk mëmërita: "S'ka gjë", se kjo sillte zarar. Por e kuptova se Djaloshi i Pashëm e kishte vendosur të qe i lirë në mendim dhe së brendshmi qe i revoltuar.

Ngriti kryet e bukur dhe shikoi te tabloja e shëmtuar. M'u dhimbs.

- Ç'e shikon! - tha Peshku i Kuq.

Djaloshi i Pashëm shikonte thellë në vetvete. Tha:

- Në vitin 1966 Pikaso ishte 85 vjeç. Eh, lirika e tij! Ç'likë e trishtuar në pikturat e tij në blu dhe rozë! Po erdhi një ditë dhe vetë u lodh prej tyre. Tamam atëherë në Londër në Galerinë Tate u çel ekspozita: "Pikaso. SKULPTOR/PIKTOR" Kam parë diçka më vonë te RAI, po ne jemi me Stalinin dhe...! Duhet të qe një mrekulli ajo ekspozita! Një mrekulli duhet të ketë qenë! Pikaso...Pikaso fuste në art çdo gjë që kalonte në horizontin e tij pamor. S'pyeste kryetarin e frontit të fshatit apo të lagjes ai! Më 1921 papritur u këthe habitshëm tek figuracioni. Ai organ qe djall: luante me të gjitha mënyrat tashmë të kapërcyerat, zhdervjellësia e tij! "Kokë-Gruaje" të kesh ta shikosh! Më i fuqishmi portret, thonë. Patjetër. Një fund kuimor, por tek ne telat brezi i...Mina!

- Po ai: Antelami nga Parma?

- E ku ta shikosh!... Dhe nuk ndalej Pikaso në rrugën e shtremberimit të fizionomisë njerëzore!

Djaloshi i Pashëm psherëtiu së thelli. Peshku i Kuq foli prapë.

- Po Arçibaldi?

- Piktur i çuditshëm! Krijonte portrete nga grumbujt e frutave dhe perimeve! Qe i ditëve të hershme të barokut.

- Po si Pikaso! Pikaso! - Fliste kështu Peshku i Kuq dhe ndjehej, lutej që të vazhdonte Djaloshi i Pashëm.

- Evolucionin ishte fjalë kyçe për më se 1000 vjet të artit perëndimor. - tha Djaloshi i Pashëm. - Papritur Pikaso i hapi rrugë eksperimentimit, një eksperimentimi të papërmbajtur. Të kesh

fat e të shohësh skulpturën:FERMANDE dhe, pas krisjes:
BURRË NË KËMBË! Diti ta vëzhgonte artin afrikan!

- Qerata Pikaso! - mëmëriti Peshku i Kuq sikur të fliste
për bariun e ca patave në fshat.

Djaloshi i Pashëm vështroi ndryshe. M'u duk sikur
shikonte si një grigjë Peshkun e Kuq. Apo!

Peshku i Kuq u mbloodh: u ndrojt prej tij. Tani dukej
haptazi se qe ora kur Djaloshi i Pashëm ushtronte autoritet mbi
të.

- Kur hajduti bëhet bos, i ndershmi bëhet blöz.

Djaloshi i Pashëm seç dëgjonte në vetvete. Dhe foli me
pikëllim:

- Nuk na dhanë shkollë! Dhe...siç e sheh kavurdisemi
me nga një rreshtë që vjedhim aty këtu. Dhe me këto rreshta
duam të dukemi! Singerisht: më mundon horrlëku. Pse, s'është
horllëk të hiqesh kështu si kampion në art? Jemi më pak se
gjysmakë.

Peshku i Kuq e ndiqte me një vështrim rrobërues.

Djaloshi i Pashëm nuk qe i rremë. Megjithatë unë e
dëgjova sikur ai të vinte nga bollëku i pikturës, i dijeve. Në fillim,
njëherë, m'u duk disi i largët. E shikova drejt: sikur ndjente
dhembje të vërtetë fizike. Se kishte folur për artin. O zot, më
mirë të mos kisha kujtesë!

Se Djaloshi i Pashëm vuante shumë, sigurisht. Se
dashuronte shumë.

Po ky s'është fatkeq, jo. Jo, s'është fatkeq, mendova.
Sepse ky beson në diçka të lartë. Beson tek arti i vërtetë. Dhe
arti i vërtetë është shumë, shumë më tepër se diçka.
"Marsejeza" e tij është e bukura. Arti i bukur. Vetëm për të i
këndon zemra.

Në tavoiinë erdhi kamarierja dhe-pastroi mbulesën. Në
ikje, unë bëra mundim të mos e shikoja kur çapitej. As Djaloshii
Pashëm s'po shikonte. Ai vërente peizazhin përballë dhe
mendohej. Peshku i Kuq *vidhte* diçka nga ato vise të hijshme të
kurmit të saj, të kamarieres.

Ai psherëtiu, më duket. Pastaj u mblaçit:

- Dua të vdes.
- Vdis, - tha i vendosur dhe krejt indiferent Djaloshi i Pashëm.

Peshku i Kuq shfryu ajër dhe mërmëriti:

- Po s'më jep leje kryetari i këshillit të fshatit. Ja që ma kanë nevojën dhe mua!

Djaloshi i Pashëm u kthye pakëz nga ai, buzëqeshi, e shikoi gjatë dhe tha:

- El Greko pikturonte vetëm njerëz të gjatë, elegantë. Imagjino sikur të hynte në studio të tij ky djall!

Ai tregoi Peshkun e Kuq dhe vazhdoi:

- Do ta zinte me hu. Për nder. Shih ç'brumbull!

Brumbulli sikur s'e dëgjonte. Ai ngriti mjekrën dhe diçka po kërkonte nëpër rruginat midis tavolinave ku lëvizte natyrshëm ajo: kamarierja. Psherëtiu. Më duket!

U bë heshtje. Pastaj Peshku i Kuq *psherëtiu* dhe shikonte përhumur.

- Ç'të gjeti! - tha Djaloshi i Pashëm.

- Në mëngjez sa hapa sytë u kujtova se pashë një ëndërr të bukur.

- E ç'ëndërr ishte kjo?

- Sikur e drodhi Diktatori i Dertit.

- Dhe kjo të gëzoi?

- Deomos: shpëtoi një popull! 40 e ca vjet dertitët nën atë diktaturë mizore të tmerrshme!

- Dhe u gëzove?

- Shumë.

- Dhe nuk pe ëndërr tjetër?

- Çë?!

- Je i sigurt që populli i Dertit nuk e pëson përsëri, ose më keq?

- ...?!

- Se populli i Dertit, me sa ndiej, i kërkon vetë Diktatorët. Apo...!

Peshku i Kuq ngriti supet.

- Mbase shoh ëndërr tjetër! - tha i urtuar.

- Mundohu! Mundohu për një ëndërr tjetër. Se sa më të kqinj të jenë kokat në krye, aq më shumë përpiqen e bëjnë rezistencë që të mos lëvizin.

Peshku i Kuq perëndoi sytë.

8

Dolëm përjashta te platforma e lokalit. Platforma që punuar me kujdes. Nuk flisnim. Vallë ç'mendonte Djaloshi i Pashëm? Apo edhe sikur ashtu do të kërkonte në vete forca të tjera që vazhdimisht i vendosur të mendonte të luftonte për artin? E pse të më shkojë nëpër mend se ai ndiente se ishte i vetëm? Se... në të vërtetë, ai s'ishte i vetëm. Atëherë unë pse ta mendoja ashtu të vetmuar dhe disfatist?

- Nga vije qëparë? - i tha papritur Peshku i Kuq.

Djaloshi i Pashëm e shikoi i përhumbur.

- Hë, nga vije?

Peshku i Kuq gërmonte me dinakëri në diçka që unë s'e merrja vesh. Djaloshi i Pashëm picërroi qerpikët e gjatë të kthyer.

- Atë kohë paradite, atje pranë Ndërmarrjes së Saj?

- Ë, po.E.

- E sheh: përgjon dashnoren!

Për çudi Djaloshi i Pashëm s'u prek dhe s'u turbullua.

- E përgjon: - më tha Peshku i Kuq.

Unë shikova Djaloshin e Pashëm. Ai u bë pakëz i menduar, i menduar e i hutuar.

- Sillu, sillu ashtu si I Lënë, pa...! - mëmëriti Peshku i Kuq dhe tundi kokën i pakënaqur. Dhe tha përsëri:

- A përgjohet dashnorja e jetës?

- Jo, - tha Djaloshi i Pashëm duke shikuar gjetkë, te një tufë pëllumbash që nxitonin duke rrahur krahët pëllumbore.

Po atëherë?

- Unë di ç'bëj! - deshi të shqiptonte fjalë me rreptësi Djaloshi i Pashëm. - Dashuroj. Dhe me dashurinë nuk bëhet humor. Me të bëhet Arti.

- Po mos u sill ashtu, mos përgjo kur dashuron, - bloi nëpër dhëmbë me vete këto fjalë Peshku i Kuq.

- Dëgjo: unë veproj në emër të asaj që është më e lartë se dashuria.

- E cila është ajo?

- Ajo që quhet: Për shkaqe morale.

Peshku i Kuq picërroi qerpikët: Sikur u godit. Ngriu. Unë shikoja i menduar. Djaloshi i Pashëm u bë më i vrenjtur dhe se me kë bisedonte në mendjen e tij. Po jo me mua. As me Peshkun e Kuq. Qesh i sigurtë.

M'u dhimbs. Ç'mund të flisnim më? Pastaj m'u duk sikur ai dialog u ndërkaill fare kot. Badiava.

Heshtje. Por pas një çike, befas, Djaloshi i Pashëm bëri një lëvizje energjike, u këthye, më buzëqeshi duke ndërruar papritur dhe më zgjati dorën. Gjithashtu i zgjata dorën Peshkut të Kuq. Na tha mirupafshim. Dhe iku.

E shikonim si ikte: i vendosur; me trupin drejt si gjimnast.

- Më duket se është plagosur, - tha Peshku i Kuq. - E plagosi dashuria. Njeri që nuk ka shpëtuar nga dashuria e vjetër.

- Plagën e dashurisë mund ta shërojë vetëm kush e shkaktoi - i thashë.

S'foli Peshku i Kuq. Zbritëm shkallët dhe dolëm në shëtitore. Në të djathtë të një kinkalerie qenë grumbulluar njerëz. Se ç'shitej. Krejt veçan, pak më tej, qenë ulur katër djem. Ata pothuaj qenë ulur përdhe në parapetin e trotuarit dhe të gjithë ishin me cigare te buzët dhe të gjithë dëshironin t'i merrnin për garipa. Ata qenë si një ujdhesë e vogël, e zhveshur. (Kohët e fundit veçanërisht, gjithnjë e më shumë po shfaqeshin të tillë).

Pranë tyre kaluan dy shkollare të rritura dhe njëri seq foli. Ato s'bëzajtën as me njëra tjetrën dhe vazhduan të iknin duke shikuar poshtë në trotuar. Nxitonin. Njëri nga garipat foli përsëri dhe ata vetë të katërt qeshën me të madhe pa pikë droje. Ishte e qeshur e shpëlarë. Mbase e ligë. Se ku... se ku i njihjal I vëreva (Edhe herë tjetër para do kohe kisha ndeshur të tillë).

ishin ca djem të mbledhur aty-këtu që, për fat të keq, zakonisht, ashtu si një tog me hedhurina, ashtu pakëz groteskë, sikur donin të thoshnin se ushqenin dëshirën e fshehtë që të ngrinin trazira banale. Rrinin të ulur si trima, po ndihej se druheshin që ta pësonin vetë. Qëndrojnë atje grumbull sikur të jenë ca shkronja shtrembaqe të buhavitura që bëjnë ç'bëjnë dhe u hedhin fjalë njerëzve dhe që me ato gërma duan të shkruajnë diçka të pështirë, turbulluese. Dhe duan që këtë ta besojnë edhe Ata, njerëzit të cilën bëjnë Jetën. Por unë kam edhe një mendim tjetër: sikur ata nuk janë ata. Janë vetëm një dukje.

Po sytë e mi i rrëlbeu pastaj figura e Djaloshit të Pashëm që ishte kthyer për atje te grumbulli i njerëzve, që u afrua dhe zgjati kokën. Siç dukej, pyeti pse ishin afruar te kinklaeria ata njerëz të mirë të rradhëve të gjata, natyrisht. Të mirë e të urtuar. Dhe prisnin.

Pas një çike u kthye dhe eci drejt. Kur po kalonte pranë atyre të katërtve që dukej sikur i kishin lyer pantallonat te gjunjtë me pluhur guri të bardhë, i folën. I foli njëri prej tyre. I hodhi fjalë banale, tepër taliëse. Dhe i thirri haptaz me zë të lartë. Garipi që foli, zgjati edhe dorën drejt tij. Dhe ai... Ai... Djaloshi i Pashëm vazhdoi të ikte; Veçse çapat iu bënë më të shkurter dhe më të ngathët dhe veshët vruiltaz sikur iu kthyen prapa.

Garipat nuk reshtën. Ata u ngritën në këmbë njëherësh dhe, si me komandë, ndenjën gatitu me grushtat e mbledhur të lëshuar poshtë te të qepurit vertikale të pantallonave. Të katërt pastaj ngritën secili kraun e majtë dhe pëllëmbët e hapura shikonin asfaltin. Dhe njëri prej tyre thirri:

- Hamlet, i dashur! Na fal! Hamlet! Të mendojnë!

Dhe të katërt qeshnin sikur të hingëllinin.

Unë u drodha. Djaloshi i Pashëm, nënë! mbeti në një pozitë tepër të vështirë. Deomos. Ndjeva se ata huk e kishin për gjë t'i bënë Djaloshit të Pashëm një poshtërim publik. Për garipat ky do të qe thjesht një argëtim. Mbase edhe për të tjerë përçark.

I thirrën sërish.

Djaloshi i Pashëm u mendua pak dhe paskëtaj u duk

haptazi se po goditej nga plumbi mizor i talljes. Si do të bënte ai?

- Hamlet!... Nxirre, pra thikën me gjak!

- Hyyya, brrr!

Njëri u shkëput dy hapa nga garipat e tjerë dhe afrohej duke bërbelitur gjëra të ngatërruara, përçmuese. Ai garip vazhdonte të çapitej ngadalë, *i thellë* në mendime të larta. Ecte edhe me një lloj keqardhjeje, gjoja. Po i avitej Djaloshit të Pashëm. Ose bënte një lojë, po i thoshte: Ja erdha! Djaloshi i Pashëm, sikur të kishte sy te shpatullat, e pa. Dhe ndaloi. Tak.

Peshku i Kuq u zverdh si meit dhe hodhi një çap. Pastaj shikoi nga unë. Unë u meka. S'ngopesha me frymë. Turma e njerëzve e rreshti njëherësh çdo lloj bisede. Djaloshi i Pashëm kishte ndaluar dhe shikonte përdhe. Se ç'kërkonte t'i thoshte toka! Se ç'gjente të lexonte atje?!

- Hy, hy! Hyyya!

Atëherë i gjori Djalosh i Pashëm lëvizit! U kthye nga e majta. Askush nga garipat nuk lëvizte. Askush nga ai popull atje nuk lëvizte. Shikova me rradhë shpejtaz garipat: ata ishin të bëshëm. Në fytyrë u qe vizatuar ngërdheshja e fundit. Mua përsëri më ngjajtën edhe të mjerë. Po: Të mjerë.

Djaloshi i Pashëm u koi lehtë, ngacmoi flegren e djathtë me putrën e gishtit tregues dhe nisi të ecte i shushatur. Ecte drejt garipit që kishte vajtur më pranë dhe koça e tij e rrëzuar qe prishur në çast nga që s'dinte ç'të bënte, ndofta. Ç'të bënte?!

Ndaloi katër pëllëmbë larg. Qe heshtur gjithçka. Bile atë kohë edhe garipat dinin të *heshtnin*. Po bënin një heshtje me ca sy të ulur poshtë, të ulur poshtë si të penduar në mënyrë tepër tallëse.

Atëherë Djaloshi i Pashëm me fytyrën e përvuajtur hapi buzët dhe foli qartazi:

- Unë punoj dhe kam shokët e mi! Unë punoj! Pse...?!

- Hyyya! Ej, ti nuk je tamam i Lojtur. - Dhe të katërt nisën të fishkëllenin me melodi të hidhura.

Djaloshi i Pashëm u kthye ngadalë që të ikte për atje tek kishte punë. Po pikërisht atë kohë që sytë e garipit shikonin shpinën e pikëlluar të Djaloshit të Pashëm, Djaloshi i Pashëm

hapi krahun vulltazi dhe me një shpejtësi që s'mund ta merrja me mend, që s'e mendoja dot se i shkonte atij, goditi me grusht të rëndë. Fytyra e garipit duhej të kishte pësuar ndryshime të konsiderueshme. Unë e pashë se si ai menjëherë mbuloi hundën dhe gojën me pëllëmbët.

Peshku i Kuq klithi dhe vrapoi për atje. Djaloshi i Pashëm u kujtua të ngrinte kokën krenare, kaloi pëllëmbën për të shtruar sadopak flokët e trazuar dhe, sikur të mos kishte ndodhur fare ajo që ndodhi pak sekonda më parë, u çapit për në punën e tij. Për atje ku duhej të shkonte. Ngriti krahun e djathtë dhe më foli mua dhe mikut të tij:

- Mirupafshim!

Dhe ikte si mishërim i nderit dhe i punës së vet. Nuk iu nënshtrua megjithatë atij poshtërimi publik. Tregoi se diti ta respektonte veten dhe nuk lejoi ta poshtëronin.

Por... ai qe bërë helm, megjithatë.

- Jo, po bëjmë shaka! - foli njëri nga turma e njerëzve nga prisnin të vinte shitësja.

- Të lumtë, o djalë!

- I lumtë atij, po unë që jam gërmuq? - tha një plak.

Mërmërima. Fjalë të shumta që dëgjoreshin më shumë. Të gjithë të njëjtën gjë thoshin, po me mënyrën e tyre secili.

Garipi i goditur sikur s'dinte ç'të bënte me atë rrëke gjaku që s'i ndalej dhe i ndroi ngjyrën e lëkurës, të këmishës, të pikave të gjakut që i binin te gjunjët dhe përtokë. Ai ngriti një herë sytë dhe mori pamjen e një njeriu fatkeq e të ligur. Ai ngriti supet me çudi, po gjaku nuk çuditej, si duket: binte. Të tre garipat e tjerë i shkuan dhe lëshuan duart te koka e tij dhe mundoheshin t'i vinin kokën në vend e t'i fshinin gjakun dhe çuditërisht harruan të shanin Djaloshin e Pashëm dhe vërtet çuditërisht nuk e ndoqën nga prapa.

- Ptu! - pështyu një burrë i moshuar. Ai pështyu në trotuar. Ndiante dhembje, ndiente mëshirë. Kështu m'u duk: Pse diini qosheve e anës rrugës që të zhgaravisni jetën! Ç'djali!

- Ptu!

Peshku i Kuq nxitoi pas mikut.

- Ç'është kjo?! Të mos dalësh dot jashtë në darkë! Të mos vesh dot vajzën përbri, se...

Ajo grua që fliste kështu, vajti deri pranë garipëve dhe të gjithë menduan se do t'i pështynte, por ajo u kthye prapë te shoqet dhe mëmërinte e pakënaqur. Sikur hahej me vete se s'dinte ç'të bënte.

Prapa meje doli figura blu e një punëtori të policisë.

- Pa ejani këtu! - u tha ai garipëve.

Garipat ngritën kokat, e shikuan pak me çudi, pastaj sikur të interpretonin keq një rol gjoja të mësuar prej kohësh, i buzëqeshën sikur t'u ishte afruar miku i tyre. Ata i treguan pëllëmbët me gjak, dëftuan fytyrën e të goditurit dhe njëri foli si fukara:

- E qëlloi!

- Letër-njëftimet! - thirri punëtori i policisë.

- Po...

Garipat u kujtuan: u kthyen me rrëmbim dhe nisën vrapin. Përballë ishte gjysmërrethi i popullit që prisnin shitësin e kinkalerisë. U kthyen. Përballë kishin dy punëtorë policie. Atëherë ata shikuan të përunjur: fajtorë. U përpëlit garipi i gjakosur; ankohej.

- Do të flasësh sa të të duhet, - i tha punëtori i policisë, - po ecni para, ju lutem.

Garipat prapa s'lëvizën. Atëherë njëri nga punëtorët e policisë thirri me zë metalik.

- Ecni!

- Po atë, atë që iku! - u bërbelitën dy prej tyre.

- Atë do ta gjeni atje. E njohim, nuk fshihet.

Garipat ecën përpara si delet. Njëri nga punëtorët e policisë ndenji midis njerëzve dhe diç kërkonte. Një veteran me kapele republike tha:

- Sikur i kemi të buta ligjet për këta!

- Ah, t'i kishim lidhur grykën atij Pusi me naftë që u tall me ne!

Këtë e tha një burrë tjetër.

- Armiku! Duhet punë! Duhet vigjilencë!

- Duhet punë për këta të gjerët. Dhe... U harruam fare:
Ku vajti drejtësia. Opo një çikë demokraci, de!

- Ah, ai Pusi, ai Pusi që na iku nga duart, thuaj!

- Sos do të *pinim* nei - mërmëriti dikush.

Dikush vraponte të fliste fjalë të mira për atë Djaloshin e Pashëm që shkonte në punë të vet dhe *palodjemtë* e papunë i ranë në qafë.

Atje përtej, garipat ecnin duke hequr çapat osh. Tani pamja e tyre ishte krejt e mjerë dhe shpirti im s'po shkoqiste një gjë shumë të rëndësishme. Urgjente. E dalëkohe madje.

- Unë të vij *atje*? - i thërriste policit një i revoltuar nga turma e njerëzve para kinkalerisë. - Të vij *atje*, të dëshmoj për ata, ju t'i dënoni tri ditë?! Pastaj ata dalin, të ulen në trotuar dhe unë të kaloj me gruan dhe me gocën dhe ata të më shajnë, të më tallin, të thonë fjalë të ndyra për gruan time, të thonë fjalë të ndyra për vajzën time dhe unë i shkreti, që e kam të shkruar në letërnjoftim: mashkull, të ui kokën dhe të iki! Dhe të vemi në shtëpi, dhe të rrimë të pikëlluar, dhe të më vijë turp të fle me gruan bashkë, dhe të më vijë turp të shikoj vajzën në sy! Të kërrej revolën e t'i qëlloj? Po ku ta gjej koburen? Po ja, i qëllova dhe i shtriva aty si bagëti të therrura, po pastaj, ku t'i lë fëmijët?! Jo, unë s'vij dëshmitar. E kë të qëlloj?!

Punëtori i policisë i vuri dorën miqësisht te shpatulla e majtë dhe mundohej ta qetësonte. Ishte tjetër lloj polici ky!

- Pse, në vende revizioniste jemi këtu? - tha një plakë pa dhëmbë në gojë. - Pse, revizionizmin do të na bëjnë këta harabelë? Policia, po qe, t'i vërë në grykë të dyfeku.

- Duam qetësi në hallet tona. S'na mbajnë më gjunjët!

- Ne duam qetësi dhe *ata* duhet të venë në punë. - tha një tjetër.

- Nuk kanë faj *djemtë*, jooo!

Secili fliste sikur t'i fliste vetvetes.

- Jo mor jo. *po!*

- Ajo *po* de, ajo e shkretë *po!* Eh!

Punëtori i policisë mundohej të qetësonte gurgulenë.
Apo mundohej të mos dëgjonte?

Unë lëviza dhe ika në drejtim tjetër. Mundohesha të largoja nga kujtesa atë pamje të shëmtuar me garipat m'u pranë atyre njerëzve të mirë, që, ashtu grumbull, prisnin në këmbë të hapej dyqani e të blinin diçka për familjen. Ata sikur prej vitesh qëndronin aty pranë asaj kioske. Kështu janë kioskat?

"Ah nafta! Ah, t'i kishim lidhur grykën atij Pusi që u tall me ne".

Edhe këto fjalë vazhdonin të flitëshin në trurin tim.

"Ne duam qetësi dhe ~~ata~~ të shkojnë në punë", tha prapë një tjetër nga grumbulli i njerëzve; "Nuk lihet djemuria kështu! Hë, pa!"

Edhe këto fjalë vazhdonin të flitëshin në trurin tim. Dhe sa shije të hidhur ndjeva!

Kam dhembje koke. Se koka brenda ka shumë punë.

V I J O N

NGA REVISTA "NËNTORI" Nr.4 Viti 1986

(Ky numër i Revistës qarkulloi)

Shënim i Autorit:

Pasi qarkulloi vetëm disa ditë pjesa e parë e novelës "ATA TË DY ETË TJERË" e botuar në revistën "NËNTORI" Nr.4 (IV). 1986 censura nga lart, edhe këtë vepër tjetër timen, e gjeti thellësisht dhe tërësisht të gabuar, reaksionare.

Prandaj ATA e ndaluan urgjentisht qarkullimin e Pjesës së Dytë të kësaj NOVELE. Pasi e botuan, e gërrinë në makineri. Shpëtuan vetëm disa kopje që u rrëmbyen.

Dhe ja pjesa e dytë:

Ai Aktori i estradës erdhi drejt meje dhe po më shikonte me sy të shqyer. Unë s'u trova nga sytë e shqyer të tij. Shpesh, disa minuta rresht, ai të shikonte me sytë e hapur tej mase, pastaj papritur fytyra i bëhej tjetër, më reale dhe qeshte.

U ul përballë, shtriu duart dhe pëllëmbët i mblidhte bashkë si top lecke. Ai i mbante akoma sytë të shqyer dhe kishte fryrë gojën, sepse lëkura e faqeve i qe ngritur si kaçup. Pastaj ai bënte kaçup vetëm një rën anë të gojës dhe, si ulte atë, fillonte me anën tjetër.

- Ç'do të marrësh? - i thashë.

Ai më bëri shenjë se kishte porositur dhe vërtet atë kohë kamarierja i solli çaj.

Tundte kokën: Ç'do të të tregoj, ç'do të të tregoj!

Erdhi heshtazi një burrë tjetër, i gjatë dhe i shëndetshëm.

- Mirë jeni? - tha ai dhe u ul.

- Po, një kafe e dua, - tha ai. - Një kafe dhe një shishe me ujë gline.

Kamarieri solli dy kafe, se erdhi edhe një i katërt i cili punonte hidraulik dhe dukej si njeri që kujdesej veçanërisht për flokët. Ai kishte flokë të hollë, të pathinjur dhe të parënë. I shkurtonte gjithmonë pak si tepër, po në një masë të caktuar dhe s'ishte e mundur të kuptoje rritjen e flokëve të tij e ca më shumë të dalloje se dy orë më parë ai kishte shkurtuar flokët. Ishte i paqtë, kur ecte drejt dhe kur ulej dukej sikur thoshte: "Unë s'kam ndër mend me fyejt njeri, burra, po nëse ban vaki me më nga mue kush, njena bahet".

Nuk e di që ta ketë ngacmuar njeri deri më sot. Kështu që gjer më tani s'ka qenë e nevojshme që ai të bënte njanën.

Ne njiheshim të katërt me njëri-tjetrin. Aktori i estradës sikur e zgjati: akoma s'po fliste.

- E morët vesh? - tha.

Unë ngrita supet. Hidrauliku lëvizi kryet ngadalë, shikoi fare pak nga unë, pastaj ia mbërtheu sytë burrit të gjatë e të shëndetshëm. Ai qe aq i shëndetshëm, sa dukej sikur rënkonte. Punonte shofer dhe, para se të pinte kafën, pas pune, ndofta pasi zhëpej së ngrëni, dëshironte shumë që të rrëkëllente një shishe me ujë gline.

- Si s'dini gjë? - tha Aktori dhe sferat e syve të tij shikonin habitshëm.

- Për çfarë? - i thashë unë.

- Ç'ka bërë vaki! - tha Shoferi, i cili mbante në trupin e tij një masë të madhe mishi.

- Hë burrë! - foli ulët Hidrauliku.

- Fati! - tha ai.

Ne e shikuam drejt heshtazi se na dukej sikur do ta trembnim atë: Fatin. Ai...Ai është gjithmonë në anën e të arsyeshmëve.

S'ia kushtoi askush vëmëndjen Peshkut të Kuq që sapo erdhi. Ai gati zvarriti një karrike nga një tavolinë më tej dhe ne u mënjanuam pakëz. U mbështet midis, në cepin e tavolinës. Diçka kuptoi, se nuk na mundi me pyetjet e zakonshme. As Aktori i estradës nuk i thirri: Peshk i Kuq, pse ke dalë nga akuariumi?

- Plasi fati, shokë! - tha përfundimisht Aktori i estradës.

- Naftë!

- Mor po, naftë e mbi naftë!

Shikonim të habitur e të lumtur Aktorin e estradës. Pas njëçike do të bëheshim të lumtur.

- Flori! - tha ai dhe shfryu bulçitë.

- U gjend flori? - tha Shoferi, i gjatë e i ngarkuar rëndshëm me blanja dhjam!

Ai pyeti qetë dhe kërkoi të dinte gjërat shkoqur. Të

paktën kështu na u duk. Atë kohë unë pashë Peshkun e Kuq që u afrua edhe më te qoshja e tryezës dhe uli atje doçkat , dhe uli gushën me tul të kuqërremtë mbi doçkat tridhjet e ca vjeçare.

Hidrauliku s'fliste. E shikonte drejt me një farë mosbesimi. Sa mirë i mbante flokët Hidrauliku! Sa mirë!... Me pamjen e tij dukej tepër i rregullt e metodik.

- U gjend flori! Flori! - tha Aktori. - Ehu, sa flori kanë fshehur në baltën tonë! Po ta gjejmë, thuaj.

- Po ku, si?

- Gjer tani në tre vende.

E shikua drejt: Hë!

- Në një shtëpi private me kopsht e me avli ku jetonte një plak me plakën dhe djalin. Djalin e njoh. Ata mbajnë edhe kone në shtëpi. Para nja dhjetë vjetësh plaku na sëmuret e na thirka plakën e i thotë: Afro llapën e veshit e dëgjo plakë! Ashtu bëri piaka. Kur të vdes unë, në filan vend, i tha gërxihoja, në mur, në të djathtë të oxhakut, pas pesëmbëdhjetë vjetësh, jo më parë, foli djalit dhe tregoi se atje kam fshehur një... një qyp. Po pas pesëmbëdhjetë vjetësh, kupton ç'të llafos? Ndryshe të malikova së toku me barkun që lamë gjallë. Fute në mend!

Në tryezën tonë u shtuan dhe dy vetë të tjerë. Tavolina tani u popullua. Nuk bënëin zhurmë dhe s'kërkonin as pije as kafe. E tërë tavolina ishte bërë vesh. Aktori qe bërë vesh. Më falni: qe bërë flori. Domethënë ai tregonte për floririn tonë. Dhe vazhdoi:

- Hop, u këput: vdiq. Plaka s'tregonte gjë. Po... pas nja gjashtë vjetësh, sëmuret rëndë, ashtu si rëndë dhe u tremb mos vdiste. Ndaj thërret të birin dhe çoç i thotë. Kazmën i biri! Hiqet osh dhe ajo dhe bam murit. Dhe... doli qypi me verdhushka.

Ky i biri s'qe gërxiho me lakra në ndërgjegje. po mbërtheu qypin e, drejt për në Bankën e Shtetit, në Bankën e Partisë, atje në qytet. Ç'ke aty, e pyet një shok në Bulevard. Ja, i tregoi ai.

Ai shoku i tij u lahtarisi: Bobo!

Kërkuan një polic dhe i shoqëroi dhe dang në Bankën e

Shtetit në qytet. Ja një *qyp*.

Tjetri që këtej nga rrethi ynë, nga një fshat, nga Shtufi. Plak gërmuq, gërxo edhe ky. Seç i flet mendja dhe...në Bankë këtu. Shoqe, i thotë asaj të Bankës këtu, na shih ç'është kyja? Ajo hapi sytë. Qe flori me kokosh. Sa lekë me tonat thyhet? Ajo hyri e doli në ca zyra dhe zgjati kokën te kamarja me xhama dhe pas saj zgjatën kokën gjithë punonjësit e Bankës mbase. Kaq lekë, i tha ajo pastaj. Gërchoja, bërr, zbrazi qesen me kokoshët e tjerë me flori. Ata të Bankës ngrinë. Llogarinë, se s'kam nge! u tha gërchoja. Aty, or vëlla, një bënnte llogari e ca i binin telefonit.

Hapi librezë të madhe plaku dhe doli përjashta e pinte duhan. Kur, nisi t'i shkante *dikush* nga prapa! Dhe, si pa të keq, e pyet se nga ish e ç'ish e na i kërkoka letërnjoftimin. Ashtu,, ë? tha plaku me vete. Ashtu, ë? Hajt, pa ma sheh surranël

- Bobo, bobo! - ia bënë ata të dy që ishin ulur të fundit në tavolinën tonë.

- Prit more, "ç'bobo" - tha Aktori i estradës. - Ky qerrata plak qëlloi gjë e mençur dhe inatçi. Na ngrihet të nesërmen dhe na vete në Bankën tjetër, jo në rrethin tonë po në Q dhe zbrazi një trastë me flori. Nga inati që i kërkuan letërnjoftimin... E fitoi rrethi Q. florin.

- Jo, moreee!

Peshku i Kuç çuditërisht, s'fliste hiç; Shoferit i lëviznin veças e veças muskujt në fytyrën e madhe. Hidrauliku bëri, më të madh njërin sy; shtrembëroi pak kryet dhe shikonte ca si me dyshim për ato që dëgjo. Po s'fliste.

- Gje e bukur, - thashë.

U bë heshtje. Aktori na shikonte me sytë e shqyer dhe façet e fryra me ajër: Hë, ç'doni më?

Por befas ai shfryu ajrin: i bëri sytë të natyrshëm, qeshi pakëz kërr, kërr dhe tha:

- Doni më? Doni më të madhen?

- Po për vete s'mbajti hiç ai plaku? - tha njëri nga ata të dy që kishin ardhur të fundit. Atë vazhdimisht e shihja nëpër qytet me një motorçikietë të vjetër e të pistë. Xham motorçikleta me më shumë copa të ngjitura aq shëmtueshëm gjer më sot s'kam

parë. Ai njeri qe i hollë, me flokë si mi, si bishta miu, qe i tëri diçka si i përhimtë dhe dukej sikur hynte dhe dilte vetëm nga plasat, nga boshllëqet.

- Hiç s'mbajti për vete??? - pyeti përsëri me çudi.

- Opo!... ia bëri Aktori.

- Edhe ai i Q.? - tha tjetri: shoku i atij që unë e shihja vazhdimisht me motorrçikletë dhe me xhamin e thyer dhe dukej sikur kudo hynte e dilte nga të çarat, nga plasat. I Përhimti.

U përgjigj menjëherë i Përhimti:

- Pesë para mend i kanë. Ehu, çofç kanë menduar! I' di una ata! Njeriu është i ngatërruar, s'jepet lehtë.

Edhe diçka tjetër për Njeriun e Përhimtë: Ai s'thoshte "unë" por "una". Sikur të mos kishte dalë akoma nga fëmijëria.

Aktori i shikoi të dy me zemërim. Shoferit i këmbeshin ngjyrat e fytyrës dhe i tha kamarierit t'i sillte edhe një kafe tjetër me pak. Hidrauliku e shikoi pjerrtas, sikur ta peshonte Shoferin. Hidrauliku dukej sikur nuk e gëlltiste dot atë bisedë. Sikur s'i besohej. A shkonte në shfaqjet e estradës Hidrauliku?

Kamarieri solli kafet dhe Shoferit i dridhej filxhani ngaqë i dridhej dora. Ai gëlltitej dhe m'u duk sikur tek ajo masë e tërë njeriu nisi shpërbërja: Sikur trupi ulërinte pa zhurmë.

Aktori krroi grykën.

- U plakët dhe s'besuat njëherë te ndershmëria! - u tha ztyre të dyve që besonin se dorëzuesit diçka do të kishin mbajtur të fshehur nga monedhat e floririt.

- Ptu! - ia bëri Aktori.

I Përhimti shikoi në syprinën e tavolinës dhe mermëriti ulët:

- Po e kanë bërë llogarinë e tyre ata! Diçka në mos më shumë, diçka...ohu! E di una!

- Ose kanë qenë budallenj, - tha shoku i tij.

- Djali i plakës: budalla! Plaku i rrethi tonë: i rrëgjuar?!

Bah!

U koll pak lehtë Peshku i Kuq. Dhe foli ulët:

- Pasuri e madhe, po qe! - dhe tundte kokën lehtë.

I nxori kthetrat Peshku i Kuq, mendova. Megjithatë, ai e

ndiqte bisedën pa lakmi: i heshtur, me një mendim të njerëzishëm në pamje, me një dramë të fshehur përbrenda deomos. Apo më ngjante mua ashtu? Mos ndofta i shkrepni në mendje se ajo gjendër dhjamore parathoshte diçka tjetër? Apo... Ai vërtet duhet të ish martuar. Gjynah! Të hapin barkun, ta bëjnë shpirtin plagë pamje të tilla: Meshkuj që s'arrijnë dot të martohen!

- Opo kjo s'është gjë, - tha Aktori.

- Tjetër?!

- Dyzet e dy tonë.

- Çfarë dyzet e dy tonë?!

- Dyzet e dy tonë flori! - thirri triumfalisht Aktori i estradës.

- U gjendën?!

- Fiuut! U bënë të shtetit. Tani di shteti ynë socialist se ç'bën me to! Aho! Fiuut!

- Domethënë e vërtetë është ajo fjalë që më zuri veshi për atë thesarin te Shkëmbi i Kavajës? Për atë thesarin që e zbuloi rastësisht një fshatar i cili kulloste lopën?

Këto fjalë i tha Shoferi. Ai fliste krejt i ftohur.

- Plotësisht e vërtetë, - tha Aktori. - Vetëm se fshatari nuk kulloste lopën, se lopën e ka në tufë, të tufëzuar, po kërrente gurë për të shtuar shtëpinë.

- Dhe?

- Dhe jep e merr në një biçim mendem guri, jep e merr kur bup, iu verbuan sytë. Burim i sigurt: dyzet e dy tonë flori. Plot dyzet e dy tonë. Polli edhe balta jonë. Piuuu!

- Pse s'thual

- Fat i madh! - tha Aktori. - Ç'molloisni ju! Ai, drejt e në...

- Në Bankë.

- Në Shtet. Te Shteti i Partisë së Punës. Te shteti

Komunist

- Bravol

Njeriu i Përhimtë psherëtiu. Shoferi mërmëriti.

- Domethënë e vërtetë është Ajo fjalë! - Ai mërmëriste dhe tundte kokën. Një kokë tjetër brenda kokës që dukej.

- Dyzet e dy tonë, kokëëë! - thirri si me fërshëllimë pastaj Njeriu i Përhimtë. Sikur atë çast të qe kujtuar se ç'hata kishte dëgjuar me veshët e tij.

- Po, po, dyzet e dy tonë plot. Qe pasuria e Ali Pashait, e Ali Pashë Tepelenës. Gjysma e thesarit, - tha Aktori.

- E Ali Pashë Tepelenës!

- Po pashallëku i tij s'arrinte gjer te Shkëmbi i Kavajës! Kësaj i thonë që ne të dy të jemi komshij, të jemi armiq dhe unë të vij e të fsheh floririn në shtëpinë tënde. Çudi!

- Nga ajo anë s'di gjë unë, - më tha Aktori. - Di sigurt që u zbuluan dyzet e dy tonë flori. Se ç'i tha mendja Aliut dhe e strehoi gjysmën e pasurisë te Shkëmbi i Kavajës punë e tij ajo! Dava më vete! Dihet, ai ka qenë insna i çudirave.

- Ah, të bija unë në ta, - tha Njeriu i Përhimtë. Ai qe i shpëlarë. Apo: Ai qe si ai.

- Do ta mbuloje prapë?

- Jo, do ta dorëzoja. Por edhe për vete çoç do mendoja:

Të jem i singertë!

Filluan të gjithë të flisnin se ç'do tëbënin, si do të sillëshin, po të përballeshin me tërë atë pasuri. Secili filloi të fiiste gjat. Në fund e mbyllte bisedn shkurt. Unë fjalët e fundit besoja.

- Vallahi, do të mbushja nja dy xhepa.

- Në dyzet e dy tonë? Një trastë. Vetëm njëtrastë. Do t'i bëja gropën asaj, pastaj do të lajmëroja.

- Unë do të merrja sa të bëja një shtëpi të re me tërë pajisjet dhe të tjerat shtetit.

- Unë direkt e në Shtet.

- Asnjë copë s'do të mbaje për vete? - e pyeti shoku i Njeriut të Përhimtë.

- Asnjë për be. Shteti mendon vetë.

Njeriu i Përhimtë bëri një fytyrë jashtëzakonisht të pakënaqur, sikur të ishte ndeshur me një pandershmëri që s'ja mernte mendja kurrë.

- Unë dë t'i lyeja pak buzët, - tha Njeriu i Përhimtë. - Do t'i lyeja, ç'i do fjalët! Ohu, dëngla!

- Po ti? - i thashë Hidraulikut. - Ti ç'do të bëje, si do të veproje?

- Unë s'i gjeja.

- Sikur?

- S'ka sikur!: Tek unë s'bie flori. Prej meje hikën.

Ai s'donte të zgjatej. Është nga ata njerëz që i bën gati fjalët para se të hapë gojën.

Mbi tryezë nisi të zvargojë zëri i Shoferit. Fytyra e tij qe murrëtyer disi. Ai fliste dhe m'u duk sikur filloi të kalbej njëherësh.

- Ne si familje, - përdridhte fjalët ai, - kemi patur mundësi të hidhnim monedha flori në dorë, po nuk jemi ngatërruar. Jo për gjë, po kemi qenë të lidhur me Partinë dhe atëherë, në fillim, në qytet babai shkonte për sekuestrim floriri te tregtarët. Mund të merrte sa të donte. Unë veja pas tij. Po ne, jooo, kurrë s'kemi patur dorë. Vjedhja s'ka prokopi. Unë edhe sot, ja të pyesësh, një pesëmbëdhjetëqindarkëshe të gjej në rrugë, s'e marr. Unë...

2

I mbaj mend stërlinat: sa një dylekëshe, sa këto njëzetqindarkëshet, ohu, flori me kaposh, me ca shkronja, me fytyrë, me qerre në shpinë. Ju s'keni parë stërlina! S'keni parë pesëbashkë turke, lirë turke, franceze!

Mbaj mend se si i provonte një bakall i qytetit monedhat e floririt. Kishte një gur sa një vezë rose. E merrte monedhën që e shpinte hallexhiu për ta thyer dhe e lëshonte mbi atë gur. Monedha bënte tingull. Nga tingulli i njihte ai. Dhe thoshte 96 lekë e marr. Mund të veje edhe te një bakall tjetër, po të doje dhe ai ta thyente më pak ose një çikë më tepër. Po, ne si familje s'kemi patur dorë, kurrë. Po të qemë racë e ligë, rrëmbenim. Sa të donim. Te ne i linte Partia në kohën e Pushtetit, në shtëpinë tonë, i grumbullonte ato që u merrte tregtarëve. M'u te rrënja e ftoit ia gjetën njërit. Ua gjetën atëherë, se u hidhnin tatime, por

ata s'i kërrenin dhe ua gjetin dhe i burgosnin. Po ne, cuk, s'vumë dorë. Sot e tërë jetën s'prekim ne, s'ka dorë xhinsi ynë. Cuk. Pastaj monedha e floririt nuk qerdheset, s'trashëgohet. E thonë pleqtë e parë këtë.

Ishim pushtuar nga kurioziteti për ato... monedhat e floririt, nga verdhushkat e fshehura nëpër vrima të errëta. Ato jetonin atje me atë dritë të përjetshme verbuese dhe vallë .. si mund të arrihej gjer atje? Si vinte rasti? Mbreti i jetës, de!

Truri ynë po ngrohej si ca me nxitim. Po trubullohej. E turbullonte ai: Rasti, një nga tiranët më të mëdhenj! Çështja e parasë, siç e dimë, është tepër e lashtë. Për të flitet mbarë e mbrapsht, pa ndërprerë. Veçanërisht në nyje kyçe të historisë. A thua: Ky prolog për gjetjen e thesarit po zgjon Kombin të... flaki, shëëël, mjerimin? Atëherë thërret me aq pasion e përvëlím edhe në ëndërr. Ja një ëndërr me të cilën tregojnë se...

Njëherë një prift, që pat ardhur në fshatin... kur vdiq, belbëzoi ca fjalë të rralla të shuara, copa-copa herë në shqip e herë në një gjuhë tjetër për atë... Kutinë e Madhe të mbushur, të fshehur njëzet çape tej Gorricës së Vetme. Njëzetegjashtë pëllëmbë nga lindja. Atje në Kutinë e Madhe me verdhushkat do të gjeni gjithashtu... Kur u kthyen ata të katër Piratët që erdhën nga deti, po që s'dihet nga ç'nisua zbritën në det, ka thënë Mëmëlalja, se ata u mbyllën në një shtëpi si kështjellë atje lart në krye të fshatit, dhe natën me hënë dilnin përjashta dhe thonë se disa herë natën i kanë parë kur hipnin atje lart te Shkëmbi i Zi, te Vëra e Plakës. Ju s'keni hyrë gjer në fund te VËRA E PLAKËS, po të parët thonë se kanë hyrë, thellë fare, nëpër të errët, në xëxët... ku ndihet një zhurmë si curril i largët... Atje ka ca shkallë që janë gdhendur në shkëmb: zbret në ato shkallina dhe pastaj ka një pellg të frikshëm me ujë të zi. Rretheqark ka shkallina. Diku ka një vërë tjetër dhe atje hyn dhe në xëxët, kthehesh në tjetër vërë dhe ikën... Ehu, Vëra e

Plakës! Atje thonë se një natë me hënë, më në fund mundën të hynin hajdutët. Hynë të ngarkuar rëndë dhe pastaj, akoma pa gdhirë, ata, aman o zot! dolën dhe ndenjën dhe dy ditë të tjera në shtëpinë e krehut të fshatit. Tani ajo shtëpi si kështjellë është fare e braktisur, e rënuar... vetëm ca copëra muresh kanë mbetur... Atje ka pezhishka, zhapinjë, gjarpërinj, kukumjaçka, lakuriqe nate...Ehu...

... nuk u kthyen më Piratët, kështu që thesari mbeti diku te thellësitë e Vërë së Plakës. Atje janë munduar disa herë disa burra që të hynin e... Po dy prej tyre shkanë në ujin e zi dhe thonë se janë gjendur pastaj më vonë te Pellgu i Çalit... atje poshtë në fund midis maleve. Pellgu i Çalit është gjithashti i zi, i thellë sa s'dihet. Që andej ujët s'ikën kurrkund se s'ka shteg. Ose ikën, po askush s'di si ikën e ku del, ku humbet! Ai Pellg nuk shtohet dhe nuk pakohet... atje dolën kufomat e atyre të dy burrave që të gjithë e dinin se kuturisën të gjenin medeomos humbëtitrat e VËRËS SË PLAKËS. Ehu! VËRA E PLAKËS! Ehu, Pellgu i Çalit!

Po një burrë, Burë i Njëhershëm, e kanë sjellë gojë më gojë pleqtë tanë të bardhur. arriti ai Burrë gjer atje ku qenë futur Piratët.

Dhe arriti të dilte. Po kur doli, ulërinte.

Ai qe verbuar.

Atje thellë, i shkreti, nëpër errësirë... ec e ec nëpër shkretëtirën me kthina e me shkumb të errësirës dhe u mësua me atë botën e ftohtë të xëllëkut dhe ec e ec...Dhe befaz e goditit në dritën e syve një grumbull me shkëlqim të llahtarshëm verbues.

U ndodh ballëpërballë tërë atij pingu me flori të sjellë nga Piratët. Verdhushkat dritësonin verdhëllimshëm me një përflakje sikur atje të qe barku i diellit dhe ai i gjori papritur, i dalë nga kthina e të errtit, kishte përbulluar me lëmshin e madh të papërballueshëm të diellit. Qe floriri. Floriri!

Sytë e tij u lëbyrën, fytyra e tij u llahtareps, ngriu goja e hapët dhe gërneat e grykës ulëriu thekshëm. Dhe guvat e thella ulërinin njëra pas tjetrës. Dhe duart u ngritën shpejtas për

të fshirë sytë. U kthye praptas... e mori Qoftëlargu përdore dhe... Ai ulërinta... Dhe Qoftëlargu e nxori përjashta në diellin e qiellit. Po pëllëmbët s'i hoqi më ngasytë: s'i ulte. Buzët s'i mbylleshin më. Gërnetat e grykës nuk e reshti më ulërimën! S'piu. Ulëriu. Vetëm ulërinte.

U lodh dhe i kapitur ra të flinte. Po bënte gjumin më të çuditshëm në botë: flinte duke ulëritur.

Ai u bë Ulërima e Botës.

Uh; VËRA E PLAKËSI! Eh, floriri i Piratëve! Ju, o punëkeqës deti, paskëtaj, ku e lëshuat atë ulërimën tuaj të fundit! Mbi floririn, mbi mbretvrasësin e ëmbël "që ndan djaln nga gjiri i t'et!"

Unë dëgjoja tani Timonin nga Athina dhe më dukej sikur s'do t'i komandoja dot kryet, sikur do të vazhdonin të tundeshin. Të dridheshin. Flori i ndritur dhe i çmuar, thërriste ai. *Ar, o metal i çmueshëm, i verdhë dhe i shndritshëm!... Ky skllav i verdhë... bën të bekohen të mallkuarit, të adhurohet lebra e mallkuar ai i hipën kusarët në bankat e senatorëve e u jep tituj, nderime e temenara..Hiqmu pra, o baltë e mallkuar, o kurvë e njerëzisë.*

Fijet e flokut të mi duhej të ishin armiqësuar me njëra-tjetrën, duhej të ishin ngritur fare përpjetë dhe majat e tyre përpëlliteshin me nervozizëm, dhe viti 1503 që regëtinte përpara bebes së syrit, dhe zëri i Kristofor Kolombit që vëgonte larg nga shekujt duke vazhduar të thërriste: *Ai është gjë e mrekullueshme. Ai që e ka, është zot i çdo gjëje që dëshiron. Ari edhe shpirtrave mund t'u hapë rrugën e parajsës.*

Po kokën time pastaj e pushtoi ai xhaxhi Lenini! Baba Lenini që pat thënë: "Kur të fitojmë në gjithë botën ne, mendoj unë, do të ndërtojmë me ar nevojtoje publike..."

Ngrihu tani, o Babush, ngrihu dhe shikoje këtë Nevojtoje Publike! Vetëm në iu haptë gryka, ç'do të përhapim mbi glob ky pushtet, thuaj! Pfuuu! Ar, o ar! Më detyrove të shfaq edhe një herë akoma dobësinë për citatomanit! Përshesh!

U lodha! Më ndjeni

Pfuuu! Qemë gremisur nën pushtetin e fantazisë. Kishim harruar se dëgjonim apo flisnim duke ndenjur në të njëjtin pozicion. Më dhimbte qafa dhe trembesha të lëvizja kokën që ta drejtoja, se më dukej sikur do të provoja një dhimbje që s'do ta përballoja dot.

Me shumë kujdes shpura atje pastaj gishtat e dorës dhe u mundova të merrja me të mirë delliin e ngrirë të njëres anë. Të njëjtin veprim pak a shumë bënë të gjithë.

Shoferi shikonte sikur diku aty përpara të ishte togu me monedhat me gjelin e floringtë në shpinë. Hidrauliku vazhdonte ta vërente pjerrtas dhe njëra flegër e hundës sikur i përpëlitej fshehtas nga milefi. Hunda i jepte karakterin fytyrës së tij. Dhe ai nuk fliste.

Aktori që bërë si i dalldisur dhe sytë i ngjanin si të bretkosës. Sy të mbetur hapur. Sy të hapur, që në fund fare s'u bindën të mbylleshin se atëherë kishin mundur të vështronin seç të vështronin!: Flori?!

Kurse Peshku i Kuq çuditërisht vazhdonte të rrinte në të njëjtin pozicion: i heshtur, me buzët paksa të mbiedhura, sikur të ndrydhte një dëshirë të fshehur errët në vërën e ndërjegjes së tij.

Duhej të ngrihej dikush, që të iknim një nga një. Do të shkonim të mundoheshim në shtrat në gjumë. Lakmia i kishte lëshuar kthetrat dhe ne tashmë s'i shpëtonim dot. Apo nuk na kishte pushtuar të gjithëve kjo lakmi?

Njeriu i Përhimtë, me kafkën e imtë të mbuluar me bishta ho!lakë miu, shtrembëroi nja dy herë mjekrën me buzët e mbiedhura tërë rrudha

- Va!!ahi, una çoç do fusja në xhep, - tha ai dhe ndofta mendohej me vete në mund t'i kujtohej se ku mund të gjente flori. Ku?! thërriste në heshtje përgjimi i syve të tij. Ai që i tëri nuhatje.

- Edhe unë, gjynah të mburrem, çoç! - tha shoku i tij.

- Unë o vëllazën, i kam hup dhe s'i kujtoj dhe rroj një kët

jetë. Po ik, hajt, përmenduni, burra!

Hidrauliku më rrahu mua te shpatullat, seç pagoi te kamarieri dhe doli përjashta.

- Unë do t'i dorëzoja, - belbëzoi Aktori tamam si i goditur.

Po Peshku i Kuq? , mendova.

Po vija në vete dhe mund të bëja buzën në gaz. Shikova Peshkun e Kuq. Gusha e shtrënguar te qoshja e tavolinës, mjekra e ulur atje. S'i lëvizte duart e shkurtëra. S'lëvizte asgjë. Po qeskat nën sy? E dallova: ato qenë të zbrazura nga gjumi. "O kurvë e njerëzimit që... " U zbrazën qeskat e gjumit. Eja ta shohësh Peshkun e Kuq, o Djalosh i Pashëm! Si do t'i thërrasësh tani?

Sidoqoftë, Peshku i Kuq vuante dhe dyshova se ai që s'do të shpëtonte ose do të shmangej i fundit nga dëshira e madhe për floririn do të qe pikërisht Peshku i Kuq. Ose ai që do të vdiste i pari.

Peshku i Kuq di të psherëtijë në dy mënyra: unë e kam dëgjuar kur psherëtin si i pakënaqur. Tani s'e dëgjoj. Tani psherëtima sigurisht është e dimensioneve të mëdha, shumë e dhembshme dhe është një psherëtimë që e dëgjon vetëm ai. Vetëm për të. Ai u shpërbë në psherëtimë.

- Hajt, njatjetani! - tha Aktori dhe kërceu dhe iku me nxitim.

Qe bërë heshtje e plotë.

Ai: I Përhiqti tundi kokën i vendosur dhe buzët e holla iu përpëllitën: Mos më bjen në dorë mua, pa llafoseshim! Mos...!

- E ç'do të bëje? - i thashë.

- Ç'do të bëja? Hatanë.

- Do të haja veten.

- Do të haja një jetë me qejf. S'jeton mirë ai që jeton gjatë, por ai që jeton bukur.

I Përhiqti u murrëtye në fytyrë dhe përplasi pëllëmbën e vogël të hollë në tavolinë.

- Do të blija dy vila, - tha. - Do të blija dy mëhalla. Do të blija.. Ehu!

Nuk bisedoj më me të. Ai mund të kërkonte që të blinte

botën. Të tërë botën. Ajo çka mund të blejë paraja jam unë vetë, zotëruesi i parasë.

- Ohul - ia bëri pastaj dhe u ngrit. Sytë e tij të vegjël dinakë shikuan përçark: ku ka ndonjë plasë midis që të rrëshqasë?

4

- Po sikur t'i gjeje ti? - i thashë Peshkut të Kuq më në fund.

- Ah, sikur! - rënkoi ai. Psherëtiu thellë. Nuk lëvizi. - Ah sikur! - Mënyra se si bënte ai Ah sikur çuditërisht, mënyra se si shkonte ai diku në vete, mua s'më bënte të qeshja. Po... por... as ta neveritja. Ja që s'jam në rregull!

- Marrim nga një ponç? - i thashë.

Dhembja do diçka: pak pije që të zbutet, ndofta.

- Cuk, - tha ai, Peshku i Kuq.

Është i të njëjtit fis, mendova. Është shqiptar. Edhe në çast m'u kujtuan fjalët e të nderuarit Eqrem Çabej i cili shkruante se "Thelbi shpirtëror i shqiptarit është rezervimi".

- Cuk, - belbëzoi përsëri ai.

Ai s'lëvizte. A e kisha parë këtë njeri në ndonjë pozicion tjetër? Duke ecur, për shembull. Duke qeshur. Duke drejtuar timonin e triçiklit. A e kisha parë...?!

- A të pëlqen ajo tablo? - më tha. Unë atë kohë s'e prisja që të fliste.

- Të pëlqen?

- E mrekullueshme! - i thashë.

- E mrekullueshme është vetëm jeta, - tha. - Arti me jetë.

E shikoja drejt me vëmëndje: Njeriu... I thjeshtë! Ç'mekanizëm! Njeriu! Thelbi shpirtëror... rezervimi.

- Ja atje në atë peizazh të isha tani!

Ai lëvizi vetëm pakëz globin e syve të kaltëreme dhe tregoi peizazhin e vendosur rishtaz. Unë nuk flisja se më dukej sikur do t'i trembja fjalët, sikur do ta bëja që prapë, me atë

kujdesin karakteristik të mbyllej lëvozhga që po çahej.

- S'e shikon me ç'vrull lëshohet drita në peizazh?

Shikonte peizazhin i përpirë i tëri atje. Unë s'lëviza. Shikoja atë: ai sikur e shikonte për herë të parë atë peizazh!

Lëvizi kokën fare lehtaz. Ngjyra e kuqe e fytyrës filloi t'i zbardhej. Së pari të ballët, pastaj u zbardhën e u përthanë buzët. Nisën t'i plasaritëshin. Nisën t'i lëviznin qimet e holla të verdha të shpina e duarve dhe unë po friksohesha. Shpirti im s'po më pyeste: ai u mobilizua që atje thellë të pikonte lot. Pikë. Pikë.

Kishte filluar një diskutim i rrezikshëm: Për floririn!

Unë po bëhesha dëshmitar se si po niste ky diskutim.

Se si...!

Sytë e tij u bënë pellg!

Ai po qante! Nënë! Po QANTE! Dhe nuk lëvizte! Dhe nuk i fshinte sytë! S'kishte fuqi! Ose kishte dëshirë të qante!

- Ah... t'i gjeja! - tha ai. Shkërmoqi fjalët: *Ah t'i gjeja!*

Mjekra e tij u shkri akoma përpara dhe nisi të flasë me kërcënim:

- Do ta dorëzoja të tërë floririn.

- ...?!!!

Lotët e tij duhej të thoshin diçka. Unë duhej të deshifroja gërmat e palexueshme: të lotëve. Por ato arritën të gjitha të mollëzat, atje ngrinë dhe mollëzat u enjtën.

Supet e tij të brumta lëvizën dhe ai filloi të fliste me ethe:

- Unë, unë!...Unë, or babam... Unë ngordh për artin. Për kokën e mëmës sime, për krye të babait! Besomë: një orë çdo natë i vetëm atje në shtrat, nën jorgan apo kuvertë, mbyll sytë dhe nuk fle: Nis e gdhend, nis e vizatoj.

Sa herë kam shkuar në galeri në Tiranë! Pse, kam lënë unë afresk pa shikuar në Shqipëri? Pse, kam lënë unë kishë të mbetur të gdhendur pa e parë? Kam lënë pa prekur me gishta atë derrin e egër të gdhendur në relief në gur në faqet e murit atje në Mosapotam? Epiri i Poshtën gdhendte në gur, vëlla! Sa

bukur, nënë! të puthçka këmbën! Po ka njerëz që nuk bërtasin. Pse të bërtas? Po ka njerëz që shtiren. Unë nuk shtirem. S'fshihem. Do ta dorëzoja të tërë floririn. Dhë e di që Partia, që... kjo Parti e jona del!, i shpërblen njerëzit e ndershëm. Ë! E di mirë këtë gjë! Dhe... sikur të më pyesnin, or miku im i dashur: ç'dëshiron si shpërblim? unë do të thosha: Tek ËNDRRA ime: nëpër botë. Atje te Korifejtë. Në Luvër apo gjetskë. Ata s'janë të Francës, babam! As të Apenineve! Janë të popullit. Unë jam popull. Të vete te veprat e mia, te punët e popullit, të Popujve. Atje është zemra e popullit: në art... te "Fitorja e Samothrakës", te "Afërdita e Milosit", te "Robi", te veprat e Gudonit, të Rodenit. Te pikturat e Mikelanxhelos, te Velaskesi... dritat e fuqishme, te portretet, te peizazhet, te Klod Maneja dhe Sezani. O nënë, e kuqja e okra e Velakesit, ajo plastikë e Gojës... Rafaeli, Fidiasii, Rubensii. E kuqja e pashoqe e Onufrit të Botës. Buza... Besom: dëshira për të parë Luvrin po më djeg si një zjarr ferri. Të ha një herë në javë dhe të rri një muaj në gjunjë, me kokën lart pranë El Grekos. Përballë, barkas te pikturat me fshatarë të Mileit. Vetëm edhe diçka, vëlla, shpirt, dëgjomë! Partia jonë i shpërblen njerëzit e ndershëm. Ë? I shpërblen?! Unë do ta fal arin dhe ata duhet të më pyesin: Po tjetër ç'dëshiron? Do t'u them: Po të shkoj bashkë me Atë! E sheh Ai, ndaj më buruan prapë lot! Sa doli emri i Tij në shpirtin tim. Se e dua, o vëlla! Ai është i bukur. Është flori, Djaloshi i Pashëm, i thoni ju. Shumë mirë, për besë. Emri i vërtetë iu ngjitka insanit kur bën jetë njeriu, jo kur lind. Ja, pra, me atë së bashku do të bëja tutje. Por a do të më lejojnë... Por a mund të arrij me këto këmbë të shkurtëra para daltës së Mikelanxhelos? Si mund të shikohem sy më sy me atë, me Atë... Mona Lizën! Ç'do të më flasë për Leonardon!

Mona Lizëëë! Si u solle ti me planetin e pikturës? Sa herë të shikoj unë derëziul! Në sa riprodhime! Në ato që më bien në dorë: Se ç'ke në atë buzëqeshje njëfarë pasigurie, moj femër që të thonë Mona Lizë! (Sikur përtyp Burrat e Botës. Jo mo, bën shaka Djaloshii Pashëm) E ke vënë re ti? Se ajo ajo ndofta, mbase! Mbase e ka gjykuar si bojaxhi! Atë. Apo si

shofer triçikii! Hë! S'di ç'të them! Atë e di vetëm "Xhokonda", e dinte vetëm ajo napoletanja e bukur, ajo Luiza di Antonio. Sheh, dëgjon, or babam, sa mirë i shqiptoj? S'i arrestoj gërmat. Ku ta gjej unë Luvrin, unë shofer i makinës më të vogël e më të thjeshtë në botë, unë që jetoj duke ngarë atë lodër. Ku, si të arrij gjer te portreti i largët dhe... të gjykoj vetëm, me këto mend që kam nën këtë kafkë, se ç'e ka në portret atë pasiguri në buzëqeshje shoqja e të pasuri të Firences? Unë të mos mbyll sytë e të bëhem dhe, baltë, pa parë Atë. Dua, dëshiroj!

"Dhe prandaj, do t'i dorëzoja tërë florinj të. Që të shoh Endrrën. Të tjerat atje: për popullin. Po qe se... Që ëndrra t'i bëhet e bukur. Jeta, domethënë, babam. Jeta e popullit, vëlla! T'i bëhet dritë, bukur.

Huuu! Po unë s'i gjeta florinj të! Unë s'rrembeva. s'mora monedha! Sa të mençëm qenë të parët. Shih ku i ngrinin qytetet: në Butrinti, në Apoloni. Qytete me diell. Aty ka flori, atje po. Ngri kokën: vërejej prapë atë peizazh! Të gëzon e të qetëson shpirtin.

Heshtil! Pastaj ngriti gushën nga syprina e tavolinës. Te sytë i kishin ngrirë dy lotë të bardhë si dy zhapinjë të braktisur.

Ngriti dorën dhe me gishtat ebrumtë nisi të fshinte sytë. Nxori shaminë e bërë shuk nga xhepi i thellë i xhakaventos dhe akoma përpiquej të përthante qerpikët dhe kapakët. Gropat e syve qenë enjtur.

Ngriti kokën. Sytë iu freskuan, po i lageshin me lëng lotësh. Unë dëgjoja me mend akoma atë gjak fjalësh që lëshoi pak më parë dhe ato që s'i nxori. Por ai befas depërtoi në thellësinë e ëndrrës së tij, në thellësinë e Endrrës dhe të Jetës. Ndjeva shumë, më bëri të lumtur: S'e mësova që ai njeri i thjeshtë kupton dhe ëndërron. Ai, Njeri i thjeshtë!

Tani ai shprehu dëshirën. Ai përhap muzikë. Dhe unë i paku, ndershmërisht / paku me gravatë, s'ka si të mos e shikoj me dashuri këtë Njeri, se po e pe tjetrin me dashuri, do të të duket më i bukur. Edhe Peshku i... I bukur! Po ç'mund të bëj

unë për këtë, për ATA? Të lutem. Vetëm t'u lutem zotave!
Vetëm kaq.

Të tilla gjëra mendoja, dhe atë kohë Viktor Hygoi i Botës
hapi fletën e librit të tij atje në kujtesën time dhe tha:

BOTA KRIJON HYMN

Këto çaste jam pranë një copëze himni të trupëzuar te
Ky Njeri me të Mirat dhe të metat e tij. Duke folur për Luvrin ai
gjithashtu dëftonte se qe i aftë të thoshte: "Jo". Dhe sepse qe i
guximshëm që të thoshte "Jo" ai e bënte jetën disi më të lehtë.

Dhe duke vazhduar të fliste për Luvrin, për dëshirën e
tij, ai u bë tjetër. Apo, u bë ai: u zgjat dhe fluturoi larg. Ndërsa
unë ndjeva një rrëmet trishtimi dhe gëzimi bashkë. Sepse fare
befas u ndodha aq pranë atij thesari emocionesh! Sa i
shkujdesur sillej ai dhe... dhe me ç'lrshmëri! çau gjoksin dhe e
hodhi zemrën mbi tavolinë. Dhe paraqiti një kërkesë! Kërkesën
e jetës. Ajo s'qe kërkesë skandaloze. Përkundrazi: Të lexonte
Luvrin, Ja!

Më kishte çarmatosur, pra dhe po dridhesha, më duket.
Kisha shumë dëshirë ta rrokja, ta përqafoja Peshkun... Më faini,
Mikun tim.

Po për të shprehur kësi bujarish shpesh stepemi me
turp.

- Jetojmë, hiqemi ore, - foli ai përsëri i kthyer po në
veten e tij. - Kemi edhe një shtëpi me një copë kopësht dhe
bëjmë ndonjë zarzavat. Eh! Po prapë çoku këndojmë në shtëpi.
Dëgjo këtu, babam, unë vërtet ndonjëherë me atë triçikliin... po
ç'i kujton ti njerëzit? Unë e dua Të Renë, unë... Oh, e ka marrë
piropia jetën tonë! Më fal! *Duhet* të jemi të Partisë. Unë
psherëtiva, ë? Më fal! Bukuri kur udhëton njeriu me automobil!
Bukur me kalë e bukur me gomar. *Fo!* Bukur kur vesh këmishë e
kostum të bukur, kravatë e çorape të reja: fare bukur! Ç'janë ata
që jetojnë? I jërëz nga balta jonë. Pra; jo me thikë dhe të tërë
nëpër kallëpe: ky i bardhë, ky i zi, ky blu, ky i kuq, ky jeshill! Bah,
jo kështu, babam! (Këtë "babam" e përdorte gjyshti im dhe unë
dua të dukem në i ertë kur në fjalët që i vë muhabetit lëshoj
edhe këtë: babam!) Dëgjoi edhe unë di citate përmendësh.

S'të mbushet mendja? "Socializmi mund ta kufizojë shumë lindjen e fenomeneve negative, që nuk janë të natyrës së tij, por nuk mund t'i mënjanojë krejt". I shkruan Enver Hoxha këto pikë për pikë. E sheh: Jam me *partishmëri*, unë! Dhe me *kulturë*.

Pse mburren disa se kanë qenë partizanë dhe s'lëvdohen se kanë qenë ballistë? Se e kuptuan që ashtu përfitojnë. Se shumë nga ata që luftuan po e mjejin keq popullin. Kaq vite!

Apo jo? Këtë bëj libër zotëria jote, jo shkruan e më nxin vetëm mua se më mbërtheve që mora pesë lekë me triçiklin. Ngjitu edhe njëçikë më tej, zotrote, dhe hapi fletët! Dhe pastaj, pastaj do të shohësh njerëzit tanë se si do t'i lexojnë librat. Do t'i përpijnë. Me tallona do të shiten, jo me urdhër e agjitacion. Të DËNOHET HAJDUTI!. Por jo me FJALË. Po HAJDUTI, ama!

Dhe mua atëherë do të më vijë turp të bëj *kontrabandën* time: dhe atëherë do të pengohet vjedhja, do të bëhet vërtet me turp vjedhësi, kudcçoftë: në fshat, apo zyrë me kolltuk. Se, po dënove ti si Qeveri, si Ligj, po e tregove ti në libër e në gazetë troç, njerëzia do të të tregojë me gisht. Dhe të gjykon. Domethënë: vërtet të heq nga posti, ose të ngre në post. Ose: në birrucë.

Më duket, u ngatërrova. Çoç doja të shkoqitja, po sikur s'e thashë dot mirë, ë? Komisar i keq! S'bëj për komisar!

Që ta kisha fjalën, artist s'u bëra, po nga nënçatia jonë motra studion në konservator. Arritëm e rregulluam. Beson ti që kur luan motra ndonjë pjesë, unë dridhem nga emocionet? Qëllon që qaji Pse? Gjeje! Beson ti se kur u ngrita një mëngjes në pranverë, dhe papritur pashë se kishte çelur bajamja e kopshtit, unë u ngashëreva? Megjithëse mbi shpatulla kisha këtë derr peliçe! Por, ama nuk qava dje që rrëmbeva lekë me atë triçikël. U gëzova sot që bëra dy udhë kontrabandë me triçiklin dhe s'mora asnjë lekë. Ndihmova një burrë që punon në fermë, një grua që punon në fermë dhe një burrë tjetër që është lulishtar... Ata të këputnin shpirtin, ç't'u merrje?! Ngrihemi?

Ai befas qeshi, sikur gjer tani të kishte luajtur me një

djalkë naiv: me mua.

Më shikonte drejt dhe sytë i qeshnin dhe gryka i gurgullonte.

Fytyra e tij më ngjante më e thjeshtë, më e mirë.

5

Dolëm te holli pranë kolltukëve me shpinore të iarta dhe këmbë të shkurtra. Peshku i Kuq m'u lut ta prisja pak minuta dhe vetë dredhoi në të majtë te një korridor që humbte diku në të errët.

Përbri kolltukëve, te faqja e patinuar e murit ishte një fotoграфи që paraqiste pamje nga bregdeti i qytetit. Vërtet, ky qytet i ngritur në një ultësi të groptë që fare pranë detit. Në një pjesë, midis detit dhe tij, zgjatej fragmenti i një vargu shkëmbor i prerë rreptas që herët aty nga muzgu i kohëve. Ai shkëmb kurrizdalë dukej i huaj për ato rrethina të buta. Shkëmbi *kurrizdalë* diku i bardhë e diku i kuq, diku i veshur e diku i zhveshur ngjante sikur kishte mbërritur gjer aty me kopenë e gjatë të shkëmbinjtë të tjerë që dikur ishin nisur nga diku nga larg dhe do të ecnin që të mbërrinin gjatë, larg. Po ata qenë çlodhur një natë aty dhe në mëngjez herët (nuk dihej në cilën orë të mëngjesit!) kishin vazhduar rrugëtimin, kurse vetëm njëri, vetëm ky që ende me njërin faqe shihte nga deti, dhe me tjetrën shihej ballas me një pjesë të qytetit, që harruar në gjumë! Kur ishte zgjuar, ai do të ketë parë i çuditur se ishte krejt i vetëm në atë masë fushëtire dhe s'orientohej dot se ku mund të ishte pikërisht atë kohë vargu i shkëmbinjtë. Nga ç'anë e horizontit udhëhiqeshin?! Përçark s'dallonte asgjë.

Pllakosi dimri dhe e rrahën dallgët e detit. Ai vazhdonte të shikonte në tërë pikat e horizontit, po kurrkund s'shqoi ndonjë shpinë të kolegëve. Në njërin anë det dhe det. Në të tri anët e tjera fushë dhe fushë. M'u pranë ngrihej qyteti. Mbase ky

qytet, do të qe ngritur aty ca më vonë se ç'kishte hedhur frënjë më në fund ai fragment i prerë shkëmbor. Sigurisht. Një pjesë e banesave të qytetit nuk e shikonin gjer në fund perëndimin e diellit. Ata e shikonin atë kur rrëzohej prapa shkëmbit, te krifa e tij. Detin e kishin shumë afër. Midis detit dhe shkëmbit kishte rërë të imtë shumë të mirë për plazhistët. Aty ku mbaronte rëra, harboheshin gjineshtrat.

Dikush më përshëndeti dhe unë e përshëndeta pa e sjellë dot në mend se cili ishte. Peshku i Kuq s'po vinte. Unë nisa të mendoja për Peshkun e Kuq dhe Djaloshin e Pashëm:

Dikur Karnoit i patën thirrur: O djalë i Lazar Karnoit! Djalin e kishin pagëzuar Leonardo. Kjo ka ndodhur midis viteve 1796 dhe 1832 kur lindi dhe jetoi ai: Leonardoja. Leonardo Karnoi i Institutit Politeknik, i Institutit të famshëm. Pikërisht ai Leonardo u bë matematikan, fizikan dhe inxhinier i madh. Ka bërë disa zbulime në fushën e teorisë mbi nxehtësinë. Vepra e tij kryesore "Mendime mbi fuqinë lëvizëse të zjarrit" është i kalibrit të madh. Po aty në Institutin e famshëm, për fat të keq, djali i jakobinasit të madh Lazar Karno, në shumicën e lëndëve ishte ngelës. Po në pikturë shkëlqente. Lexues: më ndje! Shkëlqente vetëm në matematikë dhe fizikë. Në këto lëndë habiste profesorët. Po vetëm në dy lëndë! Mesatarja, sigurisht i dilte e ulët. Kështu ai s'mund të ecte më tej. Po instituti kishte Rektor dhe ai Rektor u bë kureshtar për ta njohur studentin e çuditshëm. Dhe vendosi ta njihje vetë atë student që nuk do të lejohej të hynte në provime. Dhe si e njohu, zbuloi tek ai një talent të rrallë, i cili shkëlqente vetëm në dy lëndë! Pikërisht se shkëlqente vetëm në ato dy lëndë simotra. Rektori nxori një urdhëresë të veçantë e cila ruhet akoma si dokument i rrallë shembullor në Institutin Politeknik. Me atë urdhëresë porosiste që Karnoi të atestohej vetëm në ato dy lëndë: fizikë e matematikë. Të lejohej.

Nderim atij Rektorit!

Nderim atij që i dha Njerëzimit një Shkencëtar, që e

ndihu Njerëzimin të jetë më i begatë.

Unë do të nxjerr një Urdhëresë për këta të Dy!

Në disa rrethana, kur njeriu me shpirt artistik nuk gjen truail të zhvillohet normalisht, të marrë arsimin, kulturën, teknikën, mjeshtrinë e domosdoshme për t'u bërë artist, atëherë qëllon që njerëz të tillë të bëhen ose paraqiten si të çuditshëm dhe enigmatikë në jetë. Atë i ka nxitur së brendshmi, i ka shtyrë me forcë ndjenja artistike spontane, por e zhvilluar embrionare. Ndaj qëllon edhe ashtu. Ata janë qenie e paplotë. Janë qenie me potencial, po që janë harruar diku nga çereku i udhës. Ai që lind me predispozita të mira për t'u bërë artist, ushqen artin. Arti për të është çështja më e rëndësishme, pasioni më i madh. Kjo në të vërtetë është detyra që i ka ngarkuar jeta. Ndaj, kurrsesi s'duhet ndërtuar një ambient i ftohtë, ndaj këtyre qenieve aq të nevojshme dhe aq delikate. Se është ambienti, në fund të fundit, ai që krijon artistë. Artisti ka nevojë për komunikimin artistik. Dhe komunikimi është shkalla më e lartë e gjallërimit për ta.

Pra: a ndodh kjo tek ne? Përkujdesja dhe nderimi i njerëzve të tillë është detyra e parë e një kombi të përparuar. E një populli që kërkon të përparojë.

U shkunda dhe erdha në vete nga këto mendime. Unë s'jam mendimtar. Në rastin më të mirë, unë jam letrar.

Përpara meje po kalonin tërë shamatë ca vajza të gjata. Ato ecnin të shpenguara. Secila kishte çantë në shpinë apo në bërrylin e thyer. Duhet të ishin basketbolliste. Po vërshonin brenda të gëzueshme dhe të qeshura. Apo iu pëlqente të dukeshin ashtu.

Ato hynë në të djathtë në restorant. Peshku i Kuq s'po vinte.

Befas u kujtova se mund të shkruaja NOVELËN e atyre të dyve.

*Novelë Për Peshklun e Kuq dhe Djaloshin e Pashëm!
Ata ishin si kështjella e mendimit të lirë intelektualë dhe*

padiskutimërisht si kështjellë e miqësisë. Dhe sikur nuk kishin pranuar që të ishin anonimë. Në disa pasdite të javës ata delnin rregullisht dhe uleshin tek ai lokal. Sikur delnin për të treguar ca të fshehta pikërisht atje. (Por prapë ata një frymë konspirative e kishin). Dhe, për çudi, tani tavolina ku uleshin ata mbipopullohej. Dhe unë për vete ndjehesha më mirë. Sikur përfitoja një ndjenjë më të fortë sigurie.

Mund të punoja pra disa ditë apo dy muaj rresht. Apo gjashtë muaj. Dhe mbrëmjeve apo natën vorë, pasi të lodhesha së shkruari Novelën për ta, do të zbrisja shkallët e apartamentit dhe do të shëtisja i vetëm nëpër BULEVARDIN E VERBËR me shumë rrape për anash. Në të dy anët ka shumë drurë rrapesh të mbjellë njëherësh. Dhe ashtu midis rrapeve me neonët e buta nën sjetullat e degëve të kërlëshura, shëtitorja më ngjan si e shtruar me parket. Po... BULEVARDI VERBËR!

Në Novelën time unë do të shkruaj për ata të dy. Kurrkush me dy pare mend në kokë s'do të më akuzojë se në Novelë merrem me një temë ekstrasfagante. Unë ndiej se këtu lëviz një problem i madh shoqëror. Problemi aktual: Të diktohen dhe të ndihmohen me forcë tërë aftësitë krijuese artistike që ndodhen te njerëzit tanë. Tek ata njerëz të thjeshtë që s'janë bij të Zylos shqiptar apo farefis i tij. Që s'janë asnjë shoku Zylo ATJE! Që kanë vetëm aftësitë natyrore. "Zyloja" i tyre është Natyra, që i ka pajisur. T'i mbrojmë këta nga burokratët, nga mediokrit, nga Zylot që duan të përkrahnin vetëm Djaloshin e tyre në art. T'i mbrojmë nga ata që s'e duan artin. Se arti për Zylon është vetëm fushë ku investohen kapitale për të ardhmen e fëmijëve të tij. Të fëmijëve dhe miqve të vet, të xhëpave të vet.

Pesëmbëdhjetë vjet më parë, të dy miqtë e mi ishin ende fëmijë dhe duhëj të nisnin të merrnin kulturë artistike. As në familjen e tyre, as në qytetin e vogël ku banonin, për fat të keq, nuk patën njerëz që t'i kuptonin se ata të dy kishin predispozita të forta dhe vullnet për të bërë art. Faji nuk ishte i atyre dy fëmijëve. Faji nuk ishte i familjeve të tyre. As i qytetit të

vogël, në të cilin vërtiteshin me ëndrrën e bukur. Aq ishte kërçiku i tyre atëherë. jeta shoqërore deomos çoç përparoi disi. Dhe ata të dy, po ashtu, pa shkollën përkatëse, e gjetën udhën e artit. Pastaj Peshku i Kuq u interesua për të motrën. Sepse e deshë artin. Dhe motra e tij po merr arsimin përkatës artistik. Aq sa ç'jep Instituti ynë. Dhe nëse motra do të jetë me predispozita të mjafta, ndofta do të çajë drejt artit. Ndofta!

Djaloshi i Pashëm dhe Peshku i Kuq, sado që duken ca tuhafë e ndopak qesharakë, janë qenie të vërteta të artit. Janë qenie të vërteta të artit dhe kanë gjithashtu cilësinë morale të admirueshme e të rrallë: të çmojnë te njëri-tjetri artistin, veprën artistike. Dhe këtë e bëjnë pa zili, pa smirë. Ata ta thonë me zë të lartë admirimin e tyre. Ta thonë me zë të lartë përçmimin e tyre për antiartin, për mediokritetin.

Në vitin 1972, kur u botua romani "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo" ata ishin në po atë moshë si Djaloshi tiranas, i biri i Zylos. Dhe Zyloja e kishte vendosur që herët se i biri i tij i vogël Diogjeni ishte një Moxart i vogël, të cilin i duheshin hapur tërë dyert e jetës dhe ia kishtë mbushur mendjen edhe Diogjenit qurravec se ishte gjeni, se ishte stolia e kombit. Deomos që Zyloja, i cili duhet të diktonte, që duhej të bëhej copë të diktonte talentet reale, të diktonte talentin e Djaloshit të Pashëm dhe të Peshkut të Kuq, merrej me Diogjenin e vet. Ai, Zyloja, verbohej sinqerisht dhe bënte punë antishoqërore. Zylo e të tjerë përkëdhelnin Diogjenët e vet, apo diogjenët e farefisit e të miqve dhe nuk shikojnë Djaloshët e Pashëm.

Ja pse do të shkruaj NOVELËN time unë Kçoja. Ja pse më thërret nën armë popullit! Ja pse unë duhet të paguhem për punë të ndershme. Mos më pengoni e, jul Madje: Jo Kçoja, po Kço.

Të dy heronjtë e mi kanë zgjedhur udhë të drejtë: të ndjekin insiktet e veta të natyrshme. Ata kanë lindur për të bërë art. Të mos kuptosh këta që janë kaq simpatikë, kaq afër së mirës, që luftojnë për përparimin. t'u ulesh anash, të mos i përfillësh, do të thotë gjithashtu t'i godasësh. Ata s'janë njerëz me komplekse, me frenime. Ata bëjnë jetë plot kuptim dhe

vazhdojnë të luftojnë e të ëndërrojnë që t'i shpëtojnë monotonisë së provincës. Nuk pranojnë të ndrydhen. Jam i ndershëm, duket sikur flet pamja e Djaloshit të Pashëm. Jam i hapur. Dhe sa shumë interesohet për hijeshinë! Të dy janë të ndryshëm dhe unikë sakaqë. Unë bëj mendim se ata janë magjepsës në miqësinë e tyre. Ata, kur bëjnë diçka, veçanërisht në art, ndihet se janë serumi i së vërtetës. Qyteti që ata i thonë Kryefshat ka moralin e vet. Ata të vetin. Ata nuk vuajnë nga maturia. Deomos që në atë qytezë turreshin që t'i sulmonin dhe pikërisht kjo i bënte edhe më të forta lidhjet me njëri-tjetrin: të mos e harronin miqësinë. Peshku i Kuq kërkon të vejë nëpër Botë, në Luvër. Të shkojë së toku me mikun e tij: Djaloshin e Pashëm. Dhe ja, sukcesi i madh i tij: shpirti. E quajnë veten intelektualë. Ose: Artistë. Kështu kanë shmangur së brendëshmi frikën, tmerrin. Ata e ndiejnë mashtrimin e ngritur në krim.

Angazhohem të shkruaj edhe për BULEVARDIN E VERBËR. (Shëëët!) Të shkruaj për rrapet, për klubin, për atë copë të vargut shkëmbor. Dhe për detin. Unë do të shkruaj për ata të dy, pra edhe për qytetin. Po. Ndal! Këta do të jenë tipa artistikë. Ky duhet të jetë një ambient artistik. Aq sa ç'është. Qytetit nuk do t'i shkruhet më emri i vërtetë. Se kjo është novelë. Veç që kjo mënyrë të hap telashe. Duhet mënjeluar me çdo kusht çdo lloj ngatërrese. Shkrimtari i madh i "Mantelit" diku nga fillimi i këtij tregimi shkruante se "Në ditët tona çdo person thotë, se. po e preke atë në majë të gishtit, paskëshe fyer në personin e tij tërë shoqërinë... Pra, në një...punonte një... Ish i pakët nga trupi si i vrarë lije, pak si kuqal, pak si... pra për të mënjeluar çdo lloj ngatërrese", qytetin ku zhvillohen ngjarjet do ta quaj vetëm Qytet. Që të mos më bine në qafë pastaj e të më paditin se kam dashur të marr nëpër gojë, të tall këtë apo atë njeri, në këtë apo atë qytet, ndofta edhe njerëz që unë kurrë deri më sot s'i kam njohur e për të cilët di fort pak gjëra. Megjithatë, dihen tipat dhe personat e një veprë të vërtetë artistike, asnjëherë s'kanë të bëjnë me persona realë. Ata janë të gjithëgjendur.

- Më fal, - tha Peshku i Kuq.

Fytyra e tij, sikur kishte qarë e tëra me sytë dhe poret. Ndofta e kishte shpëlarë. Se përsëri nxori shaminë e mbledhur pa kujdes dhe u fshi te qafa e shkurtër. Isha kaq i lodhur nga ato meditime, sa m'u duk sikur erdhi nga një botë tjetër. Po ai ecte në truallin tonë dhe tha:

-Dalim?

Të çlodhem pakëz, mërmëriti qënia ime. Aman të çlodhem pakëz!

6

Përjashta qe ngrohtë. Pat firasur edhe pasditja. *Pastrueset e Komunales* së qiellit e kishin fshirë atë. Dhe tani qe diçka e mugët pa asnjë ndriçim. Diçka tjetër pritej të shfaqej.

Ja, u zgjatën sisat e neonëve. Dhe atje tej, prup, buisi hëna. Ajo u bë me nxitim e plotë, pò dukej pak e ligur.

Unë doja të përcillja mikun, se doja që të çapitesha drejt apartamentit i vetëm. Që të punoja, të mendohesha, të mendohesha. Sa shumë duhet të mendojmë? Ja, prapë s'shkrova asgjë të re!

- Po ikni?

Qe Hidrauliku ai që foli. Ndenjëm pak nën gjinjtë e bardhë të neonit. Hidrauliku më shikonte drejt. Fytyra e tij qeshi dhe sytë jeshilë m'u dukën të bukur dhe dinakë njëkohësisht.

- A po kthehesh? - tha.

U përshëndeta me Peshkun e Kuq. (Hera e fundit që i flas kështu. Beto hem). E përqafova me dëshirë me ngulm. Kryet e tij i mbajta ca gjatë në gjoks dhe zi qeshi dhe tha:

- Hej, djalli!

Qeshi prapë shumë çiltër dhe vërtetë... Ai qe i pashëm. Qe i bukur. Patjetër, përderisa brenda meje ka zgjuar një trazim, një det të trazuar. Një dashuri. Një Miqësi.

- Nesër, - më thirri Peshku i

- Nesër ditën, - i thashë.

U kthjem.

- Ej, mik! - thërriste dikush atje tej. - Dale!

Ndaloi ai Peshku i Ai shikonte nga ne. Dikush po i fliste.

- Kush? - thashë me supet e ngritur. Edhe ai ngriti supet për të thënë sikur e dëgjoi një zë që e kërkonte. Nga vinte ai zë?

- Ja, - tha Hidrauliku.

Ja, vërtet, u shfaq dikush që nxitonte. Ai sapo doli nga kthina e një pallati dhe nxitonte. M'u duk sikur shkante drejt atij Peshku...

Drejt tij po shkante! Peshku i... kishte ndalur si i ngrirë. Qe hutuar. Ç'kishin me të?!

Unë shpejtova drejt atij që u çfaq me nxitim nga qoshja e pallatit në të majtë. Prapa, si i ngrirë, po ashtu qëndronte Hidrauliku. Ai hetonte.

- Si u ngryse? - tha ai që doli nga kthina. Ai që i gjatë, cazë i hollë dhe akoma me baltra diku te koka.

- Lene, burrë, - dëgjova të fliste Hidrauliku. Po Peshku i ... heshtëte akoma i ngrirë dhe pas asaj *si u ngryse?* u çapit drejt tij me ngathtësi.

- Mo po, s'të njoh! Kush je ti?! - i tha. - S'të njoh!

Atëherë tjetri i shkallmoi akoma më shumë çapat e gjatë dhe i thirri përsëri:

- Si u ngryse? Kthehu!

- Ooc! - ia bëri Peshku i Kuq.

Ata u puthën. Në fakt vetëm i Gjati, ai me baltra e puti.

- Hajdeni, hajdeni, - thërriste Peshku i Kuq.

Tjetri ktheu kokën dhe na thirri edhe ai. Unë nuk lëviza. Hidrauliku shikonte ende atje dhe u çapit tek unë. Aty ndaloi. I Gjati i vuri të dy pëllëmbët te faqet buçko të Peshkut të ... dhe i tha:

- Kthehu prapa, do të hamë nga një ëmbëlsirë.

- Nuk kam kohë, nuk kam kohë, - i thoshte ai. - Sa dolëm, herë tjetër. Të lutem!

- Po hajdeni, - thirri burri i Gjati. Ai erdhi vetë tek unë

dhe na rrëmbeu midis. Peshku i Kuq qeshte me gezim e bujar. I tha:

- E mirë divanletoja?

- Për besë, e mirë, - tha tjetri. - Filluan të hidheshin fëmijët mbi të. Le të prehen. Mbase, kushedi bëjmë ndonjë lekë dhe blejmë edhe televizor! Mbase!

Peshku i Kuq u drejtua nga unë:

- Ky është ai lulishtari që i çova divanleton në shtëpi. Bleu divanleto të mirë.

- Asgjëkundi s'm'u ciflos, - tha lulishtari dhe përqafoi me vrull Peshkun e Kuq. - Dhe asnjë qindarkë s'më mori ky qerrata. Pse s'më more asnjë qindarkë, more buçko? - i tha lulishtari.

- Ke paguar ti.

- Jam punëtor, e! Ahu! - Pa hajdeni tani të hamë nga një të ëmbël! Mos ma prishni: mora divanleton!

Peshku i Kuq i lëshoi pëllëmbën te gjoksi i lulishtarit dhe i lutej me fjaë njerëzore që ai të na linte se qemë vonuar.

Lulishtari s'kishte pirë. Ai na lejoj më në fund, po psherëtiu dhe mërmëriti:

- Po pse... Ti asnjë lek s'më more për të më transportuar divanleton!

Peshku i Kuq, si u sigurua se u shikëputëm prej tij, qeshi dhe i tha:

- Ik, o brekëgrisor, ik. Pse, nga ti do marr lekë unë? Sos punoi mushka e babait tim. Punoi makina jote, o i uruar!

Tjetri s'e keqkuptoi. Peshku i Kuq bënte një krekosje pakëz qesharake, po i shkonte.

- Do të takohemi, - i tha pastaj lulishtari dhe nxitoi.

- Patjetër, - thirri Peshku i Kuq dhe erdhi përsëri me ne. Ikëm të tre në drejtim tjetër, në drejtimin tonë. Midis tani ishte Peshku i Kuq. Ai kishte kapur bërryllin tim dhe njërin bërryl të Hidraulikut.

- Do të martohem, mo; do të martohem, - tha pastaj papritur i gëzuar.

Ktheva kokën me rrëmbim dhe e shikova. Ai shikonte në trotuar. Fytyra e tij qe e sinqertë dhe e dashur. Ai kishte

nevojë për sinqeritet.

Sytë i kishte të lagështitur. Unë e besova. Bukuria lind besimin në vetvete. Ai, sigurisht s'vuan nga vetëbesimi i tepruar. Se kush vuan prej vetëbesimit të tepruar, s'është as fisnik, as besnik. Kurse ky është fisnik.

Si të mos rrih me njerëz fisnikë! *Fisnikëria është ngjithëse*. E ka thënë Balzaku këtë, babam!

- Me atë të gjatën, do të lidhesh? - i thashë.

- Cuk, kam rënë në një tjetër. Më do, më do. Më duket!

Po!

- Po hidhu, burrë. - tha Hidrauliku.

Ky njeri bëhet i rrezikshëm po hyri në luftë, mendova rrëmbimthi për Hidraulikun. Me siguri.

Ndaloi Peshku i Kuq.

- Patjetër, -mërmëriti pastaj dhe qëndronte në vend.

- Shiko... Në të vërtetë unë ndjehem mirë ashtu në dashuri primitive. Dashuri nëpër kallamishte.

- Po shumë mirë, - i thashë.

Ai më shikoi në sy dhe pas njëçike më përqafoi. Më puthi. Puthi Hidraulikun, po Hidrauliku sikur s'i donte ato gjeste. S'i përfillte.

Iku Peshku i Kuq. Ktheva kryet. Atje tej e dallova prapë. Silueta e tij dukej e tëra si brejtje e ndërgjegjes.

Unë dhe Hidrauliku po iknim vetëm. Qeshë pak i trullësor e i magjepsur njëherësh. Pranë kaloi një polic.

- E di sa i poshtër është ai Shoferi? - foli Hidrauliku. - Ai që betohej për ndershmërinë! Ai e ka harruar këtë botë, burrë! Ja, ky polic duhet të urdhërohet një ditë të bukur, duhet të urdhërohet prej nderit, dhe atij do t'i hedhin byzylykët. Po... Nëse! Kishte ngarku një herë makinën e shtetit me patate dhe, kur erdhi me i shkarku në magazinë. brenda kishte nëntë arka me mollë. Ato mos i prekni, u tha punëtorëve të magazinës. S'ju duhet gjë me to. Punëtorët e kuptuan: ky bataçqi asht bashkuar me një tjetër shofer bataçqi dhe ai, për shembull, udhëton me mollë e ky me patate dhe len fjalë që ma parë që të takohen

diku, ndalin atje diku në udhë dhe hedhin te makina e njani-tjetrit ngarkesë tjetërloj. E fshehin. Pastaj takohen përsëri diku në të errët dhe i ndajnë. Kështu edhe me margarinë, edhe me të tjera. Dhe nëse një ditë ai polic s'do të urdhërohet të mbrojë pronën e Njeriut, atëherë punët janë ligshtuar, kanë shkuar tej! Ahul!

- Sa natë e bukur! - thashë.

- Eh! - ia bëri ai. - Nata më e ligë asht ma e bukur se ai çen Shoferi që i ka dhënë makinë shoqëria. Po ç'Shofer oi! Duhet me ken të sinqertë: Mallkim të madh durojmë!

- Ai...- mëmërita.

- Po, do ta paguajnë një ditë, - tha. - Më ndje, burrë! - pëshpëriti.

Ngrita kokën lart të lexoja atë: *Po do ta paguajnë një ditë.* Fytyrën time e rrëmbeu hapësira lart. Atje sipër, qielli përshkënditej. Se gati njëherësh kishte bërë vendim pashaportizimi për një popull të tërë yjesh. Dhe hiç, pa shina hekuri përmes apo diku në skaj. Pa ndarje. Yjet e bekuar, me tërë nxitimin, qenë vendosur në kupën e qiellit dhe qeshnin me xixëllima, përdridhnin qerpikët dhe cepat e bukur të buzëve. Yjet kështu! Po bënin festën e pasaportizimit atje, atje në trojet e tyre.

Eh, sa të fshehta ka këtu në botën tonë, në këtë botë. Dhe sa e bukur është *kjo botë!* Të këqinjët janë si një mësim, të mirët shërbejnë si model. Ai, Peshku i Kuq, ai të cilët paskëtaj do t'i flas me emrin e vet! Kujtoj atë dhe sikur më ngjitet fisnikëri. Akoma më shumë fisnikëri me këta njerëz të thjeshtë, me të cilët duhet bërë ALEANCË për të shkuar në një botë më të mirë! Patjetër. Po bëj kaq kohë me këta! Koha e gjatë forcon miqësinë. Miku im! Miku i mirë është rini.

Ngjitur me këto mendime, m'u kujtua në të njëjtën kohë Djaloshi i Pashëm. Fuqia e tij është gjithashtu ndershmeria dhe dinjiteti krenar. Po.

- Ç'follë?

Nuk u përgjigja. Unë dhe Hidrauliku edhe pak do të çapiteshim së bashku, përskaaj njëri-tjetrit dhe do të ndaheshim.

- Natën e mirë, miku im!

U ndamë.

Diku nga e djathta në një apartament në katin e parë ndjeva një dialog nervoz.

Nxitova duke menduar se, ç'i shtynë që njerëzit hyjnë në grindje, në shpërthime dialogesh nervoze: ç'i shtynë?!

Oh, ne jemi mizorët e vetvetes, mermërita thellë në humbëtitrat e qënies. Ç'është tërë ky makth?! Apo gjyshrit, stërgjyshrit, katragjyshrit të... pabesë... Dhe ne tani të jemi të mallkuarit e përjetshëm?!

Një mjerim i gjatë, i gjaaatë, nuk është më turp për Diktatorin e atij kombi të Dertit, por edhe për atë popull që hesht, që duron. *Nxito!*

Ndjeva se prapë ngriti kryet tek unë ajo egërsirë që më ulërin ta shpie veten në rreezik.

Nxito!

Sahati te dora e majtë s'ka dashur t'ia dijë për asgjë. Ai ka fabrikuar sekonda, minuta, orë. Dhe shkruan kështu dymbëdhjetë e dy minuta. Më saktë: njëzet e katër e dy minuta.

Natën e bukur për sonte, njerëz të mirë nën yje! Natën e bukur! Në paçil

III

1

Unë hyra ashtu kot në Magazinën industriale të qendrës. Në të vërtetë, unë s'hyra fare kot. Prej vitesh vërtitesha që të goditja në një stof për pardesy, në mënyrë që ta siguroja sa më parë. Por akoma s'po bija në të: një stof që të më thërriste përnjëherësh.

Brenda hyra me plogështi, si me mëdyshje. Nuk kishte njerëz. Shitësja më dukej sikur qëndronte vazhdimisht atje në të njëjtin vend, pa lëvizur, prapa banakut. Raftet ishin me stofra dhe unë ngrita sytë si për të parë me kujdes. Përballë te pasqyra njcha një palë shpatulla të brumta.

Qe Peshku i Kuq. Ai ishte pranë meje dhe unë mezi u orientova se më hutonte pasqyra. Ndjeva dikë që më çiku te bërri. Qe ai: Peshku i Kuq! Ai më bëri shenjë që të flisja me zë të ulët:

- Hajde, hajde, - pëshpëriti me një zë sikur bënte shushu.

Para nesh ishin katër vetë. Ne ndaluam prapa atyre të katërtve, diçka më në skaj nga e djathta.

Ata shikonin akoma te një telajo e mbërthyer në mur. Në telajc qe piktuar një deng me stofin e hapur të lëshuar si pa kujdes atje në krye. Piktura qe bërë me ngjyra me dritë dhe grafike. Tregonte një stof kostumi. Vërtet, prej atij stofi mund të blija! Mund t'i thosha sime shoqeje dhe të bliim dy metra e gjysmë. Mua më duhet një kostum i ri dhe ai prej kohësh ka hyrë në llogaritë e bisedave tona.

Qe stof i bukur. Sesi qenë kombinuar ngjyrat e guasht. ajo kafe e bukur dhe ajo vishnja! Pikërisht kombinimi i kafes,

ndofta, kombinimi i kafes me vishnjen krijonte një ngjyrë të ngrohtë me dritë dhe ai qerrata piktor kishte kaluar sipër atyre ngjyrave, me shumë finesë, një filetë të lehtë okre me dritë. Dhe me atë filetë të lehtë, me të cilën kishte formuar edhe ato kuadratet gjatoshë, i jepte stofit nuanca të këndshme.

Ja, prej këtij stofi të blija. Unë jam lëkurë... dhe flokët i kam të zinj.

Ata të katërt që ishin fare pranë nisën të flisnin akoma duke parë te stofi në reklamë. Ty të shkon, thoshin. Edhe ty. Ëhë, të shkon. Ky stof, po, ky s'ngellet stok. I bukur!

- Unë do të marr për një kostum, - tha njëri dhe u kthye rrëmbimthi për te banaku.

Unë gjithashtu u ktheva, po mendja bëri një llogari të saktë: s'kisha aq para sa të blija dy metra e gjysmë stof. A thua ta rrëmbenin tërë stofin ata? Po sikur... Vërtet... Po sikur, më në fund, ata të Lidhjes së Shkrimtarëve të kujtohen edhe për mua për të më dërguar diku jashtë me ndonjë delegacion? U bëra 40 e ca vjeç burrë dhe asnjëherë!... Në asnjë delegacion! Asnjëherë jashtë shtetit! Dhe shkojnë Të Njëtit, pothuaj! Ç'sëmundje e ligë! e pështirë! Bizantinizën! Pangepësi prej antiartisti! Turp!

- Shoqe, keni nga ai stof?

Ai që foli tregoi stofin te reklami. Shitësja lëvizi me përtesë, tundi kokën për të thënë po, dhe u kthye të sillte stofin. Pas njëçike syprina e banakut ia bëri bllof nga dëngu që u lëshua mbi të.

- Sa metra? - tha shitësja dhe nisi ta haple.

- Prej atij, -mërmëriti klienti pak i habitur dhe tregoi stofin te reklama.

- E pra! - ia bëri shitësja.

Të katër ata shikuan reklamën. Unë gjithashtu. Peshku i Kuq më giciloi te bërryli sikur të qe gëzuar.

- Ç'ne? - tha ai që kërkoi të blinte stofin. Ai mërmëriti i habitur dhe preku me dorë stofin që ishte mbi banak. U mënjanua që ta nxirte më në dritë. Pastaj përsëri ia bëri:

- Bah!

- Jo, ore! Jo, s'është si ai i reklamit! - thanë shokët e tij .
Tjetri psherëtiu. Shitësja nuk psherëtiu. Ajo ishte e qetë, e fjetur.

- Po e a keni shitur stof prej këtij? - pyeti një prej tyre dhe tregoi stofin te reklami.

- Si jo? - tha shitësja. - Ja!

- Ky?!

Ajo qëlloi me pëllëmbë topin me stof mbi banak.

- Ja, ky i tëri.

- Pooo!...

Shitësja u kthye, iku katër çape të zvarrura më tej dhe nisi të fshinte pluhurat me një leckë.

- Pfuuu! - ia bëri njëri prej tyre: - E kam thënë, e kam thënë.

la lexoi markën e atij stofi që ishte mbi banak dhe prapë foli:

- E kam thënë: është shpenzuar, po stofin s'e gjejmë dot! Duhet piktor i aftë, me shije, jo vetëm me diplomë, po me shije, pa le të mos ketë edhe kushëri diku në Komitet apo në Ministri. Urdhëro tani! Është fakt: do piktor ai Kombinat! Ja, shihni raftet; të lodh stofi gri, kaf, blu pa kombinim ngjyrash, pa nuanca ta hajë dreqi! Të shpëlara! Shih ç'dekor të dobët te basmat! Ah! Ne e kemi fajin! Ne... fajin!...

Ai u inatos sikur të ishte në mbledhje.

- Po disa herë është ngritur në mbledhje!

Fare natyrshëm megjithatë, midis të katërtve hyri befas Peshku i Kuq. Bëri lëvizje me një shkathtësi të habitshme. I ndritnin sytë dhe fytyra përnjëherësh iu bë llafazane.

- Po ai stofi ju pëlqen? - thirri Peshku i Kuq dhe tregonte në reklamë te tabloja e madhe drejtkëndëshe.

- Shumë i bukur!

- Ehu, babam! Ehu, po ajo s'është bërë diku jashtë shtetit. E ka ndërtuar një piktor, një i yni. Ai e ka bërë. Ai bën hatara me ngjyrat! Është talent, apo mitër që gatuan e vë ngjyra që të magjepsin! Merret me reklamë industriale e ushqimore, po ia hëngrën shpirtin të ziu! Nuk i bëjnë një studio për të qenë!

Më falni, ç'jeni ju?

- Klientë, - tha njëri ftohtë, po njerëzisht.

- Të kuptova, po... po kështu si kat.. Në ç'kat ngjiteni për të folur në telefon nga zyra juaj? na falni, ë? Punëtor jam, po ja dua edhe unë ta di se ç'keni në dorë në këtë realitet, ç'drejtoni?

Tjetri s'u fye. Ai që kërkonte të blinte stofin tha:

- Ne shok, punojmë në Tiranë, në një digaster ku duhej ta kishim zgjidhur problemin e ngjyrave të stoirave. Decmos duhej ta kishim zgjidhur. Njerëzit tanë meritojnë të vishen bukur.

- Po! - thirri Peshku i Kuq.

Dikush prej tyre e shikonte me bisht të syrit Peshkun e Kuq. Peshku i Kuq s'shqetësohej.

- Babam, - tha ai. - Unë kam lekë dhe ti je Qeveri! Të bëhet zotrote që unë t'i fsheh paratë? Po leku s'lëviz vetë. Me siguri. Se ka njerëz që ja, s'i shpien në arkë. Atëherë...rëmbemi ti! Ti duhet ta dish! Se ka që e dinë këtë gjë rëndësore të parasë që duhet të lëvizë patjetër. Dhe, si duhet bërë më konkretisht? Nxirre nga Kombinati një stof si ky që ka pikturuar në reklamë ai Piktori dhe do të shohësh si do ta rrëmbejnë njerëzit, dhe do të shohësh po s'e pështofli lekun Qeveria. Ndryshe! E sheh atë reklamë në telajol E ka bërë një mik i imi. I hatashëm si piktor! Po iu qep, ai të nxjerr çdo ngjyrë në stofra e basmara. Sigurisht: po i dhe atë që i duhet! Aty del shpenzimi, aty. pse, stoqe do të prodhojë! ngjyra të ngordhura që të mërztin shpirtin kur i sheh si lëvizin në trupin e njeriut! Ndaj, oburrani hidhjuni vendit dhe rrëmbejeni atë farë piktori të zot atje. Mitra e tij pjell bukuri. Vetëm bukuri. Po se ç'ka një që i prish gjakun atje në ndërmarrje! Një! Kudo ka të tillë! Ai i shkreti është piktor kavaleti, por ama e bën çdo gjë që merr përsipër. E bën bukur. Dëgjoni, pra, se u bëra llafazan: unë jam shofer në "Riparim-Sherbime" me një triçikël. Klasë punëtore! Fjalët i mbarova. Do t'ju gostis me kafe. S'kërkoj gjë prej jush, për kokën e mamasë! Biografinë... e kam të mirë. Një pengesë e kam: S'gjej nuse, po ju s'më ndihni dot, s'e dërgoni dot që andej! hajdeni, vëllezër: Përpara!

Ai nisi marshimin i pari. Ata nuk lëvizën.

- Në turizëm: më prisni, - tha Peshku i Kuq. - Diçka do të pimë. Vetëm lëngje frutash të gazuara mos kërkon. Pikë e zezë! Bluhen njerëzit duke mbjellur që të rritin pemë, u mbytt vendi me plantacione frutash po një punishte, një linjë për bë për të gatitur lëngje të gazuara nuk kemi. S'kushton. po... Ja organizimi! Djegia e etapave! Që atje te ju fillon organizimi. Që aty duhet i afti. Të ketë, o derëbardhë, lëngje tërë vitin! Kështu rritet edhe rezistenca e njeriut të dheut, dhe gripi s'na zë, dhe leku qarkullon. Bëhet dëm me këtë stil, babam! Mirë, mirë, hajdeni në turizëm, po s'ju lodh me nga këto muhabete. Për besë, s'ju lodh. Sa të fsheh motorrin dhe erdha, ndaj s'ju përqafoj. Eja edhe ti - më tha mua.

Dhe iku.

Ata të katër sikur e humbën frymëmarrjen. Njëri pastaj picërroi qerpikët i pari dhe psherëtiu.

2

Erdhën në lokal dhe të gjashtë ndenjëm plot dy orë. Peshku i Kuq gjithsesi vazhdoi të ulërinte: "Ndihmë për mikun tim artist! Ndihmë për talentin!"

3

Arrita pastaj në shtëpi, në apartament, dhe zvarrë-zvarrë e shtyva derën e kabinetit. U ula në tavcinën e punës. Ca letra të nxira përgjysmë, një rapidograf dhe një stilolaps. Nuk i preka me dorë. Pëllëmbët i ngjita lart dhe bërrylat i vendosa fort m'u mbi letrat në tavolinë. Koka u lëshua ngadalë midis shupiakave. Brenda në kokë kam trurë. Trutë duhet të mendojnë. Unë po mendoja. Po mendoja për Peshkun e Kuq. Peshku i Kuq e fal arin. Për Artin.

Ngrita sytë. E gjeta: ndofta mund të organizohet një plenium i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve me temë:

"MIQËSIA E VËRTET NË ART, forcë lëvizëse, pasuruese":

Ej, ti shok, më lëvdo mua që po them këtë. Dy fjalë të mira! E kam pa shaka. Po e more me shaka, ti s'je serioz. Pra:

* Në Tiranë vazhdon të zhvillojë punimet PLENIUMI!
MIQËSISË PARIMORE!"

Sa PLENIUM popullor!



M'u kujtua: e kisha takuar dy herë me Djaloshin e Pashëm. Punonte shofer automobili në ndërmarrjen, ku punonte edhe Djaloshi i Pashëm. Kur më prezantoi Djaloshi i Pashëm, tha:

- Shoferi i Drejtorit.

Në çast, Shoferi i Drejtorit m'u duk si njeri që kishte vendosur të bënte çmos për të ruajtur qetësinë e tij.

Ai pastaj, nganjëherë, kur shiheshim, më përshëndeste qetazi dhe ikte në punën e vet.

Atë kohë Peshku i Kuq po vinte pikërisht me të drejt meje.

- Njihë, njihë edhe këtë, - më tha Peshku i Kuq.

Ne poqëm duart dhe të dy buzëqeshëm. Atë çast Shoferi i Drejtorit m'u duk ndryshe. Sepse...sikur! Kishte dalë nga vetja. Kishte shkëlmuar atë përpjekje për të ruajtur qetësinë e tij.

- Haj të pijmë diçka, - tha Peshku i Kuq.

Ai bënte urdhër. Dhe ashtu dukej sikur këndonte. Qe i gëzuar: Ohoho, ç'do të të tregoj unë!

- Haj, - tha.

Shikova Shoferin e Drejtorit: atë s'e kisha parë kurrë lokaleve dhe druhesha mos e detyronim. Për ai vetëm më hodhi krahun të beli dhe kështu shprehu haptaz dëshirën që të uleshim të tre.

Dhe hymë brenda në lokal të tre.

- Jo more?! Ë! - ia bëri ashtu sikur unë të mos isha aty. Shoferi i Drejtorit tundi kokën. Pastaj tha:

- Shiko! E pimë kafen te shtëpia ime! Ja, këtu prapa, afër e kam.

Para emrit tim të përveçëm, ai shtoi edhe fjalën shoku.

- Ngrihu, - tha Peshku i Kuq.

U ngritem.

Shtëpia qe afër. Qe vilë e vogël; e mbledhur, me avlli dhe portë.

Arritëm në rruginën e shtruar me çimento që zgjatej midis trëndafilave dhe limonave e portokalleve. Shtëpia përpara dhe anash kishte bahçe dhe verandën e madhe të ngritur nga toka.

- Këtu do të ulemi, - tha Peshku i Kuq dhe u lëshua te kanapeja në verandë.

U ula edhe unë. Veranda qe vërtet e rregulluar mirë. Qe e gjatë dhe e gjerë. Përballë kishte vazo me lule dhe nga puliazet sesi zbrisnin gjithashtu lule. Lart, në të dy këndet e verandës, dallëndyshet atëherë në pranverë kishin besuar dy fole. Ato tashmë kishin shtegtuar. Oh, qyshkur po ëndëroj për një vilë! Vilëz!

Verigat e rrushit dukej sikur qenë insektuar. Ajo shtëpi vetjake qe vërtet e këndshme dhe e mbajtur aq me kujdes! Aq bukur s'mund të të shkojë në mend kurrë se në apartamentin me fqinj mbi vete apo përballë është më mirë. Vetëm nëse je gënjeshtar. Apo dembel. Apo... O, sa apora mund të të ngacmojnë! Po: *shëëë!*

Nëna e shtëpisë solli një kanistër të vogël me rrush dhe u ul që të na pyeste sipas zakonit. Ajo fliste, buzëqeshte: Hë, bir, hë bir! ia bënte dhe duart e vjetra i mbante të shtrira në pëqinjtë.

Njerëzit vijnë me breza. Brezi i nënave sikur ngjan më shumë me njëri-tjetrin.

Ajo pastaj, iu kthye Peshkut të Kuq dhe e pyeti:

- Po ti, ore?

Ata sigurisht njiheshin mirë.

- Oh, unë! - tha Peshku i Kuq. - Unë! Lëre punën time: jam me kancer.

- Hy! - ia bëri nëna për të *trembur* kancerin. - *Plaç!* Hy! - ia bëri ajo prapë dhe e kërcënoi Peshkun e Kuq se donjë ditë do ta mallkonte që tallej edhe me frikëra të tilla.

Po Peshku i Kuq qeshte pa të keq dhe s'u duk shumë i këndshëm. Menjëherë m'u përhi figura e Djaloshit të Pashëm. Kur takoheshin Peshku i Kuq dhe Djaloshi i Pashëm sikur duheshin me njëri-tjetrin. Ajo miqësi u premtonte kënaqësi të vërtetë atyre.

- Sëmurë, sëmurë jam, - tha Peshku i Kuq disi i thelluar me një lloj mendimi, sikur dëshironte të luante teatër.

- Prapë bëra tomografi, - tha.

As unë, as Shoferi i Drejtorit s'e pyetëm. Shtireshim sikur do ta dëgjonim pa interes. Nëna shikoi gjatë nga unë; pastaj nga i biri. Siç duket, ajo s'kuptonte fjalën tomografi.

- Po s'tregoi gjë, - tha Peshku i Kuq. - Tomografia s'tregoi gjë. Kurse ajo doktoresha seç ndjeu ca vija të bardha në mushkëri. I ndjeu me vesh. Dhe do të t'i heq, thotë, do të t'i shuaj.

Fytyra ime natyrisht u bë e habitur. Goja tha:

- S'tregoi gjë tomografia dhe ajo i ndien me vesh!

- Ëhë.

Peshku i Kuq shikonte poshtë te këmbët. Shoferi i Drejtorit i tha:

- I shpure mish doktoreshës?

- Plënc! - thirri Peshku i Kuq. - Ja, ti s'ha dot plënc! As ky miku yt. Nënë, keni ngrënë plënc?

- Ç'fole, biro?

- Paçe keni ngrënë, ke gatuar?

- Ah, si e gatuanim njëherë e njëkohë! Atëherë, diku! - tha ajo. Dhe tundi kokën e kredhur thellë në ca mejtime për të thënë jo.

Peshku i Kuq qeshi me triumf. I biri shikonte fytyrën e nënës dhe ajo u ngrit duke mërmëritur:

- Shkoqituni me shoshoq.

Dhe humbi atje brenda.

- Ja, - tha Shoferi i Drejtorit dhe u çua e nxitoi.

- Ulu, ulu, - thirri Peshku i Kuq. - Ulu, aman! Pa trego në fillim, trego ashtu aman: me hollësira!

Peshku i Kuq fërkoj duart. Tani ai do të më bënte *dhuratën*. Dhe do të ma jepte. Po më përgatiste fillimisht.

U ul Shoferi i Drejtorit. Shikoi atë, më shikoi edhe mua dhe sytë i mbetën te kanistra me rrush. Mori një verigë në dorë.

- Hani, - tha.

Peshku i Kuq ngatërroi gjithë verigat gjersa iu mbush mendja se kë të zgjidhte.

- Tani folë, - i tha. - Aman, mos harro asgjë! Pastaj, e shohim! Dëgjoje! - më tha mua. - Sa ishte ora, atë kohë, atë ditë? - iu drejtua Shoferit të Drejtorit.

Peshku i Kuq më pëshpëriti në vesh emrin e Djaloshit të Pashëm. Sepse tani Shoferi i Drejtorit do të niste të tregonte diçka të bukur, sigurisht për Djaloshin e Pashëm. Kështu e kishte gjykuar ai, Peshku i Kuq.

Dhe Shoferi i Drejtorit hyri në mejtime dhe goja nisi t'i fliste dhe unë po mundohem t'i përfytyroj mendimet e tij.

Ai po merrej me reklamë ushqimore. M'u në mes të telajos kishte pikturuar miell, një arë me grurë, një makinë shirëse, pako makaronash, pako sheqeri e ku di unë! Ë, po atë kohë po pikturonte në po atë telajo edhe një verige rrushi të gjerë të madhe dhe nën të një vajzë të re të gjatë shumë të bukur, me dhëmbë të bardhë që hidhte kokrra rrushi në gojë. Diku një shishe me verë dhe një gotë të mbushur përgjysmë po me verë.

Unë u ktheva atje tek ajo biçim dhome ku ai punonte reklamat dhe më tha mendja të shikoja dy minuta. Atë çast del drejtori nga zyra. Unë u ktheva dhe iu qasa makinës.

- Sa është ora? - tha drejtori.

- Dy, - i thashë.

- Thirre pak, - më tha.

Unë thirra Djaloshin. Ai doli përjashta me penel në dorë dhe sepse m'u dhimbs. Sikur po e shikoja për herë të parë dhe ndieja dridhje që s'kisha mundur ta shikoja herë tjetër, që

s'ikisha thënë hajde të pimë një kafe.

U afrua me atë pelerinën e gjatë tërë bojra dhe drejtori i lëshoi dorën te supi dhe i tha:

- Me urdhër nga Ministria, sot, tamam pas një ore duhet të jesh në qytetin e S. Atje do të bëhet një panair pas ca dhe ti... Ata do të shpjegojnë se ç'do të bësh. Do të shkosh patjetër. Është urdhër.

Drejtori im s'foli më. Ai ngriti krahun dhe zbuloi orën.

- Ti, - më tha mua, - do ta shpiesh me automobilin tim. Urgjent. Dhe do të kthehesh urgjent. Me ecje normale në orën katër të pasdites, domethënë, duhet të jesh këtu. Ndodhu, se më duhet makina. Kuptohemi?

- Sa do të rri atje? - pyeti Djaloshi i Pashëm.

- A, po: 20 ditë.

Pashë si i lëvizi ajo pelerina ngallosur me bojra, e pashë si u mendua një hop dhe tha: Mirë.

U nda me Drejtorin. U zhvesh, rregulloi diçka, mori kasetën e ngjyrave dhe atë dosjen e vizatimeve e ku ta di unë!

Pastaj hipi në makinë përpara dhe më tha të shkonim në shtëpi të tij diku matanë shinave. E ka merak, i shkreti, atë shtëpi se atje quhet fshat. Tërë banuesit matanë shinave i thërrasin fshatarë.

Atje s'u vonua. Por kur doli, qe përgatitur sikur do të ikte delegacion. Iu afrua veturës dhe i fryrë, të thoshje, hapi derën e pasme. Dhe u ul atje te kolltuku i gjatë, e tërhoqi derën me pak bezdi, tamam si kryedrejtori Unë nxitova përpara me urgjencë.

Ndeza motorin dhe i ramë mespërme qytetit. Nuk flisnim. E vëreja në pasqyrë: a e shikonin...?!

Vetëm kur dolëm nga qyteti, tha:

- Ndall!

Ndalova. (Urdhë i Kryedrejtorit). Ai zbriti. Hipi përpara përskaj meje. Kur duhej të nisesha, më tha: Të lutem!

Ecnim me shpejtësi, se rruga qe me asfalt dhe bosh. S'flisnim. Nganjëherë e shikoja me bisht të syrit. Nuk shikonte nga unë. Mundohej të shikonte përjashta, sikur dëshironte të

përpinte të tëra ç'ishin atje: morpo ledhet, drurët, parcelat, bagëtitë që shfaqeshin aty-këtu, puset e naftës, gjithçka!

Dielli po vente nga deti dhe unë ula strehën mbi timon. Ishim lodhur nga heshtja. Ai nuk donte të fliste. Kur, fare papritur, thirri gati me llahtar:

- Aman!

U kujtova se ai s'dinte të thoshte aman! Ku përulet ai! Ndaia. -

- Aman! - mëmëriti sikur të lypte mëshirë.

Zbriti pa më shikuar dhe vërente diku. Kapërceu matanë asfaltit dhe shikonte i babëzitur. U ul në gjunjë, vuri faqen e anuar te pëllëmba dhe shikonte. Shikonte. Ç'të të them! Si i babëzitur.

I vajta pranë ngadalë. Unë doja ta zgjoja! Nuk më ndiente.

- Aha! - belbëzonte.

- ...!

- Sa bukur!

- Kush? - pëshpërta ulët.

- Bota!

- Bota?!

- Bota! Të mundesha e të ulesha m'u këtu e të punoja diçka!

Fliste si me vete. Po unë e dëgjova dhe vetëm ato çaste m'u duk i shkretë, një i shkretë, të cilit dikush i pat bërë padrejtësi!: S'e dëgjonin!

- Ç'të lypset? - i thashë.

- Dy orë, - tha. Ai foli me ah!

- Ç'domethënë dy orë! - i thashë.

Nuk shikoheshim në sytë e njëri-tjetrit.

- Dy orë të ulesha tani, tamam tani këtu dhe të punoja! Po ndofta më vonë gjej ndonjë makinë të rastit, kështu që ti kthehu.

- Nuk lëviz, - i thashë. - Katër orë po deshe vonohu, katër orë do të të shpie me këtë automobil në S. Do të të shpie unë.

- Po drejtori?

- Katër orë këtu të pres. Në dispozicionin tënd, - i thashë. - Ohu, do të vdesim! Unë jam shofer dhe e di ç'bëhet me automobiliët e popullit. Unë e di ç'bëhet me to pasditeve, të shtunave gjer natën vonë, të dielave dhe të hënave herët për të shpurë fëmijët nëpër shkolla në Tiranë. Tërë javën, tërë jetën! Lëre!

- Po ai do makinën, - tha dhe shikonte përsëri andej nga bota e tij.

- Le të mos e presë.

- Në orën katër, - mëmëriti.

- Makina nuk i duhet për punë.

- E di, - tha..

- Epo!

- E di, e di, - tha dhe përsëri s'shikonte nga unë.

Vrapova te makina dhe i shpura kasetën dhe dosjen. Nuk foli. U ngrit dhe u vëriti pak.

Pas ca, u ul mbi një gur dhe shpinën e ngjiti fare pak te trungi i një gorrice.

Nisa t'i veja pranë, por u ktheva. U ula më tej dhe njëherë u mundova të shikoja se ç'do të pikturonte. Tej ishte shtrati i një lumi të gjerë. Zallishte, piepa, ekualipte kavakë. Një stan delesh, puse nafte, kodra.

S'e ktheu kokën nga unë për dy orë e njëzet minuta. Plot për dy orë e njëzet minuta. Ai peneli i tij, o vëlla, lëvizte si gryka e bilbilit që ka pyetur vetëm bilbilin apo Kryetar beharin për të kënduar. Ashtu.

Kur u ngrit, rrotulloi qafën, lëvizi anash dhe i erdhi rrotull asaj tablosë. E kishte përfunduar, po më dukej sikur nuk ndjehej mirë. Sikur u bë i ndrojtur! Sikur, duke e parë me vëmëndje me sytë gjysmë të mbyllur, kuptonte se diçka nuk e kishte bërë siç duhej. Dhe m'u duk sikur trupi i tij psherëtiu i tëri, sikur mëmëriti një "Jo"?!

Unë s'kam ç'them! U mahnita! Hajde, kokë, hajde!, thashë me vete. Hajde, ore hajde! Ngrimë pas drejtorëve dhe na duket sikur ne bëjmë ç'të duam me botën! hajde kokë,

hajde! Për shpirtin e asaj mëme që sillet aty brenda!, ai djalë sikur më tundí. Sikur më sollí në jetë tjetër: Në jetë të bukur! Në jetë tamam të bukur, me të cilën ngopesh gjumë dhe s'sheh ëndrra me frikëra! Pupu, ç'pësova me atë djalë, unë! Pupu!

Mbaje në shtëpi, tha, se kur të kthehem, do të punoj akoma me të.

Automobili im fluturonte drejt qytetit S dhe ai ndihej i gëzuar dhe unë për vete ndihesha shumë i gëzuar. Për jetën e mëmës! Për jetën e saj, shumë më i gëzuar sesa kur hamë badjava poshtë e lart dhe sjellim edhe copëra mishi të fshehura atje te bagazhi. Copëra mishi. Etj. Etj!

U ngjit në hotel dhe, kur zbriti, i pagova një kafe e një ponç. Nuk kundërshtoi hiç.

Kur u ndamë, e putha. Ai s'më puthi. Po u kujtua që të më buzëqeshte ndryshe: me mirënjohje.

Unë e ngacmova atë kohë dhe i thashë:

- Kush ua aprovon këto?

Nuk foli. Çoç kam dëgjuar që nuk e sheh dot atë të madhin e artistëve këtu në qytet dhe e ngacmova për atë që është edhe anëtar i byros së Partisë këtu në rreth.

- Nuk e njoh, i thashë, se i flas edhe unë një fjalë të mirë për ty.

E kuptoi, tundi kokën, megjithatë tha:

- Njihet lehtë; i vetmi surrat në qytetin tonë, që ka nevojë të kruhet me letër zmerili. Surrat pa sedër. Kutërbon shpifje dhe egoizëm. Dhe është anëtar i byrosë së Partisë sonë në rreth. Sigurisht.

Qeshëm, më nderoi dhe erdha.

Dhe vërtet, ai që merret me këta, me ju, ai i këtyre, juaji, ç'është? Skulptor? Hë mo, ai që dëshiron t'i thërrisni: o Kryetar i Degës! E? Po, tamam kryetar i degës së Lidhjes së rrethit. E qëllova në rrugë dhe e mora e ia tregova. Më vinte të qeshja kur i shikoja surratin dhe më kujtoheshin fjalët e Djaloshit se duhet t'ia kruaje fytyrën me letër zmeril! E pa dhe buzët e tij të holla ia bënin: Bukur, bukur!

Pra, mos i ka bërë ndonjë të keqe ky lloj përgjegjësi

këtu! Se edhe thoshte "bukur" edhe sikur kafshohej përbrenda! Se më duket si baltë, si zhabë, ai njeri mua! Nxin! Si tinzar! Kam dëgjuar vërtet se ka qejf t'i thonë Kryetar Dege e jo kryetar i degës së Lidhjes! Çudi! Po ku ka çudira tani, thuaj!

- Tani, pa ngrihu e na e nxirr këtu përjashta. Hajt, dhe vendose atje te ajo vazò, atje ku e shikova qëparë unë. Se atje i bije drita dhe nuk shkëlqen.

Peshku i Kuq s'përmbahej dhe sillej si në shtëpi të tij. I këndonin tulet dhe shpirti me brumë diellor. Qe atë kohë, edhe i hijshëm edhe i ngrohtë.

Shoferi i Drejtorit hyri brenda dhe doli përjashta me tablonë në duar. Ai gjithashtu qe skuqur: a do ta pëlqeja unë?!

E vendosi. E lëvizi. U ngrit Peshku i Kuq; e lëvizi përsëri, e shikoi vetë. Prapë e lëvizi dhe prapë na doli përpara dhe e shikonte.

Pastaj u ulën të dy bashkë, duke më lënë vendin më të mirë. Shikonin edhe ata peizazhin dhe vërenin nga unë. Gryka e Peshkut të Kuq gurgullonte diçka të rrjedhshme, të gëzueshme, po pa fjalë.

Unë ngriva pas pak. Ose ngriva përnjëherësh. Sikur të më kishin goditur. Si dikur një djalkë në fshatin tim në SUHË atje në Jug, atëherë në fëmijëri, më kujtohet se thanë se, u përball me ujkun dhe humbi gojën.

Unë u përballa me bukurinë dhe humba fjalët. Ç'mund të thosha! Peshku i Kuq fare kot e mundoi aq shumë Shoferin e Drejtorit që të na tregonte ca gjëra me hollësi! Ato, të bukurat ishin aty, ja!

Në atë kuadrat kishte një harmoni të rrallë në ngjyrat e pemëve dhe transparencën e ujit në vjeshtë. Diku silleshin gjethe që lëviznin mbi ujë. Disa kojrrilla atje në qiell. Qielli qe me dritë gri në okër. S'qej bërë, po qe. M'u në qendër ishte qielli që hidhte pluhur të bardhë të flakëruar kudo mbi majat e pemëve.

Dhe pjesët e metalta të pemëve i ngrohte gjithësesi ai diell dhe ato, sesi po thoshin se përçark, kudo sundoheshin nga njeriu. Dy silueta gjithashtu të ndodhura në kapriçelin e pusit të naftës. Në linjat anësore piktori kishte futur ngjyrën e ngrohtë të marrë nga hambari i pambaruar i diellit. Më tej, në përmasa të vogla sigurisht, aq sa e kishte parë të arsyeshme, artisti kishte vendosur një punëtor. Ishte Ai, qe i vetmuar dhe njërën dorë, të djalhtën, e mbante lart natyrshëm. Padyshim i thërriste dikujt me atë dorë. Po, atje përballë qe ai!: Dielli. Dhe punëtori. ndihej, po, po! Sa ndihej nënqeshja njerëzore e punëtorit që dukej sikur bisedonte me të dëshiruarin mik të tij: me Diellin. Dhe i thoshte: Do të të sjellim, Diell! Do të të montojmë. Do të MUNDOHEMI! Prandaj kam ngritur dorën time lart. Dhe do të të zgjedhim në krye një Sekretar të Parë, Sekretar i Parë, o Diell! I të gjithë kohëve! Më saktë: Sekretarët e Parë të kohës. Jo: Të URTËT, o Diell, të URTËT e popullit! Dëgjo: SHUMËSI: TË URTËT. Ja.

Dhe dielli dëgjonte! këto fjalë të sinqerta, e shihte atë dorë që dëshëronte të vinte lirshëm që të sillte DËSHIRËN. Dhe i flakëruar e i bukur shpërndante drejtësi si KËSHILLI I TË URTËVE.

Në planin e fundit të peizazhit ngrihej butas një kodër e mbjellë me një kope të tërë pusesh naftë. Po si një tufës mërzie ngjanin ato puse! Të ftohtë. Në peizazh sundonte qetësia dhe trishtimi. Dhe harmonizimi i ngjyrave. Sundonte magjia e shpirtit të përvëlur për të bërë art.

Djaloshi i Pashëm pat derdhur ato ngjyra, sikur kishte një hon me bukuri e brengë dhe nga ai hon dilte ai zë: piktura. Ai që pat pikturuar aq bukur me aq afsh e dëshirë të dukej sikur diku vazhdonte të mbushte botën me bukurira. Por edhe me dridhje dhe zymti.

Në atë tablo ndihej qartë frymëmarrja e tokës. Sikur kllithte edhe një rënkim i gjatë. Rënkim njeriu, drurësh dhe delesh! Bile ai u kishte thënë kojrrillave që të sillleshin nëpër qiell dhe të krrokërinin (Po kojrrillat nuk krrokërijnë!) Se qielli bëhej tamam ashtu... Edhe qëniet ndiheshin qënie, dhe sendet ndiheshin sende. Me një brengë të vjetër tashmë përmbi. Aty

asgjë s'bërtiste. Ndihej frymëmarrja e drurëve, e gjithçkaje. Ndihej çapitja e ngrohtë e njeriut. Duke e parë atë në çast, shtyheshe që të mendoje për vendin tënd. Dhe kjo bëhej me atë, me artin e bukur!

Kishte në atë peizazh edhe një çikë pranverë, diçka si e parakoshme ajo pranverë, po që do të vinte. Do të qe pastaj e vërtet, e lulëzuar. Siç duket, ajo pranvera brenda gjirit të vjeshtës së begatë e të ngrohtë. Pra, atje kishte dimër. Edhe vjeshtë edhe pranverë. Sikur që të tria i kishte thirrur ai Djaloshi i Pashëm që të dilnin së toku. Se qenë.

Dhe prapë ato tri stinë: s'qëndronin veç e veç! Se ç'djall fuqie ka arti! Se ç'djall!... Ja, tek ajo pikturë, që ndoshta do të punohej edhe ca, që, për shumë arsye, s'do të realizohej kurrë plotësisht, ndihej gjithashtu edhe shpërndarja e një shprese.

Toka kudo ishte e majme. Dhe unë e vëreja. E vëreja. Dhe ndieja edhe atë britmën virtuoze të zogjve në orët e parambrëmjes që po nxiton. Ata qenë tërë melodi, pa pikë kakofonie. E vëreja. Shikoja dhe dëgjoja. S'dija ato çaste, se ç'do të bënin, të shkretët violinistë të vendit, po të dëgjonin atë koncert siç po dëgjohej atje në atë tablo! Po sikur Djaloshi i Pashëm të kishte qenë djali i shokut Zylo; Ose...

Ajo tablo të nxitëte aq mendim në shpirt.

Si do të t'i tregoj tërë këto, shpirti im: Krisanthi! Si do të të flas, o begatia e jetës sime! Për këto *lojra* me ngjyrat! Në këtë tablo ka realitet, dhe sakaq nuk ka. Dhe së fundi: KA. KA REALITET. Ka linja tërë transparencë, të lëngëshme. Ndihet që ky peizazh ka lindur pikërisht aty së pari. Ndaj është ende i përलगur nga ujrat e mitrës së Tij. Sa pafajashmëri dhe rrebelizëm apo rrëmbymëri ka njëherësh! Është pikturë e nxjerrë nga palca nën kafazë. Pikturë që vjen nga *ajogalaktikë*. Aty çdo gjë... çdo vjen pa *leje*, me dëshirë të vet, pa kaluar në ndonjë zyrë apo doganë. Aty baritet pa pasaportë. Qenë të një planeti, me identitet, po pa... pa parti me vete!

Dhe sa zhurma e fjalë dëgohen tamam aty! Kr, dëgjo! Duhet 200 palë sy që ta shohin 100 për qind këtë. Ndaj, si të ta sjell këtë imazh? Shikoj, peizazhin dhe ndiej se ai merr frymë.

Dhe po ushqej shpirtin. Ndërsa në etër, se si! po shquaja një gisht tregues i cili qortonte. Se Njeriu e gishtit nuk e linin të çapitej: të shihte, të... të punonte! Që mbi kryet e tij të bukur të kishte më shumë qiell. TË KETË.

Ç'të të flas për këtë talent, Krisanthi! Për këtë peizazh që u testua edhe nga më i vështiri komision: nga Shoferi i Drejtorit. Shofer që është mësuar të zbutet vetëm me ca marifete të tjera. Kurse tani dukej shumë më i gëzuar dhe i trishtuar njëkohësisht nga ajo pikturë. Arti i vërtetë zgjon Njeriun te Njeriu.

Ajo tablo , më në fund, s'shkruhet me fjalët e mia.

Qe një tablo, në të cilën realiteti shfaqej hapur dhe unë, jam i ndërgjegjshëm; gjithsesi s'i klasifikoj dot të tëra detajet me emrin e tyre të vërtetë. Atë e shkroi peneli i Djaloshit të Pashëm. Ai penel që tregonte se shpirti i autorit që shpirt i kësaj bote. Qe dialogu i tij me kohën. Klithmë.

Unë e njoha, prandaj kam këtë bindje.

Dikush shtyu portën atje tej tek zbrisnin katër shkallë për te rrugina midis trëndafilave, limonëve e portokalleve. Në suazën e portës së ulët, ngjitur me njëri-tjetrin ishin dy vetë. Buzëqeshnin si të zënë në gabime. Peshku i Kuq s'foli, po gjithsesi sepse, po qe i helmët.

Domosdo.

Ata të dy po vinin që të shihnin tablönë.

Prapa nesh, te korniza e derës, doli e Madhja e Shtëpisë dhe vazhdonte të fshinte duart te përparsja, megjithëse s'i kishte të lagura.

Nga zakoni, ndofta;

FUND

Nga revista "NËNTORI" Nr.5, viti 1968

(Kjo pjesë e dytë e Novelës u gri në makineri, se u ndalua. Shpëtuan vetëm disa kopje)

Dhe...

**MBI NOVELËN THELLËSISHT TË GABUAR
"ATA TË DY E TË TJERË"**

Në këtë numër të revistës "Nëntori" duhej të botohej vijimi dhe fundi i novelës së shkrimtarit Koço Kosta "Ata të dy e të tjerë" pjesa e parë e së cilës u botua në numrin 4 të revistës. Redaksisë, pas botimit të pjesës së parë, i kanë ardhur mjaft vërejtje nga lexues së ndryshëm si dhe nga krijues, ku kjo novelë cilësohet si një vepër thellësisht e gabuar me të meta të theksuara ideore. Në to shprehet mendimi i prerë dhe i argumentuar, se nuk duhej botuar kurrsesi një vepër e tillë që nxin dhe diskretiton realitetin tonë të sotëm, në të cilën ka fatalizëm dhe del sikur fenomenet negative janë të pashmangshme, një vepër që ve në pedestal të artit e të shoqërisë mikroborgjezinë, që shpreh konceptin idealist mbi rolin vendimtar të artistit në shoqëri dhe është tipike për një deheroizëm absolut, një vepër e dështuar, vulgare e krejt mediokre.

Redaksia e revistës, duke e parë dhe studiuar me seriozitet dhe ndjenjë të thellë përgjegjësie këtë novelë, arriti në konkluzionin se ata që i kanë shkruar "Nëntori!" kanë plotësisht të drejtë dhe se ajo vetë është treguar miope dhe oportuniste. Redaksia, duke botuar këtë shënim, deklaroi hapur se ajo ka përgjegjësi të rëndë për botimin e kësaj novele dhe se ajo vendosi të mos e botojë fare në këtë numër të revistës "Nëntori" vijimin dhe fundin e novelës "Ata të dy e të tjerë", aq më tepër që kjo pjesë ishte edhe më e keqe se pjesa e parë.

Duke u thelluar në analizën e novelës, në shkaqet e rrethanat që shpunë në botimin e pjesës së parë të saj, redaksia e kuptoi se novela është dërguar në shtyp pas një leximi shkeleshko, pa një punë kolegjinale, pa u diskutuar në redaksi, me ngutje e me mendjehetësi, me nënvleftësimin të rrezikshmërisë që paraqesin veprat e çoroditura ideoartistikisht. Ajo është dërguar në shtyp duke treguar tolerancë dhe oportunitizëm ndaj një autorit, siç është rasti i shkrimtarit Koço Kosta, të përkëdhelur, të mbivlerësuar e fryrë nga kritika letrare. Redaksia nuk duhej t'ia lejonte vetes të sugjestionohej nga emri i autorit dhe nga ndonjë vepër e mirë e tij, të cilën kritika me të drejtë e ka vlerësuar, dhe të lëshonte pe para këmbënguljeve dhe vetëreklamës së autorit, duke botuar një vepër kaq të dobët

Kjo novelë dëshmon se, duke luftuar për cilësinë artistike, ne ndodh që harrojmë cilësinë ideologjike duke harruar kështu se, sigurisht nuk ka përmbajtje, sado e drejtë dhe e rëndësishme të jetë, që ta shpëtojë një vepër të dobët artistikisht, ashtu si nuk ka formë artistike, sado e "solistikuar" të jetë, që mund ta shpëtojë një vepër me përmbajtje të gabuar. Merret me mend se ç'rezultat i vajtueshëm arrihet pastaj nga një autor, kur ai në veprën e vet çalon me të dy këmbët, si në rastin tepër flagrant të novelës së Koço Kostës, një vepër pa vlerë artistike dhe me gabime të patolerueshme ideore, një mish i huaj në trupin e shëndoshë të letërsisë sonë të realizmit socialist, një vepër kryekëput e dështuar, që nuk duhej t'u jepej në dorë lexuesve.

Duke i falenderuar lexuesit dhe krijuesit për vërejtjet e drejta, parimore e të thelluara, edhe duke e ndier thellë peshën e gabimit të bërë me botimin e novelës "Ata të dy e të tjerë" redaksia u premtonte atyre se do ta forcojë çdo ditë e më shumë preokupimin militant për pastërtinë dhe cilësinë e letërsisë dhe arteve tona të realizmit socialist.

Novela e shkrimtarit Koço Kosta, një novelë-pamflet nga njëra anë vështirësisht e lexueshme dhe e mërziqshme, me stil çapraz e gjuhë mjaft herë të përdhunuar, me situata të paqena,

pa tipa realë e pa ngjarje, që u paguan haraç sevdave moderniste e dekadente është, nga ana tjetër, një novelë me prirje agresive nxin realitetin tonë socialist. Në të, në planin politik, çdo gjë është së prapthi. Duke folur për nxirjen e jetës në këtë novelë, sigurisht, këtu fjala nuk është që në veprat letrare të mos ngrihen probleme nga më të mprehtat, por ato të ngrihen të qenësishme e për t'i zgjidhur dhe jo për ta nxirë gjithandej në vepër realitetin. Shoku Ramiz Alia ka theksuar me forcë se "art i vërtetë është ai që ecën në një hap me preokupimet e rëndësishme të popullit dhe që i ngre shoqërisë problemet që dalin në jetë duke treguar dhe zgjidhjet e tyre". Kurse në novelën që analizojmë realiteti ynë jo vetëm nxihet, por edhe mohohet. Novela estetikisht është konceptuar krejtësisht shtrembër. Duket qartë se autori është nisur të shkruajë një vepër "origjinale" në mendimet dhe në format e trajtimit të saj, duke bërë një prapaktheu të dukshëm në rrugën e vet krijuese. Novela dëshmon për një evoluim në sens të gabuar të individualitetit krijues të Koço Kostës.

Novela "Ata të dy e të tjerë" është dëshmi se një autor e pret vetëm dështimi kur ai shmanget nga rruga e drejtë e letërsisë në shërbim të popullit e të socializmit, e një letërsie realiste, me partishmëri të lartë dhe të mbështetur for në tabanin kombëtar, në realitetin e gjallë të vendit të vet. Vetë e ardhmja e Shqipërisë socialiste nuk përgatitet në këtë novelë nga puna e ndershme, e ndërgjegjshme dhe heroike e popullit nën udhëheqjen e Partisë. Lexojmë në novelë një pasazh të tërë se si ëndrrën për një jetë më të mirë autori e bazon te fati, te "sihariqi" për gjetje floriri të fshehur. Novela, e ndërtuar artistikisht mbi thashethemet dhe që është një grumbullim mendimesh të çoroditura, nën pretendimin e "guximit" krijues, bën pohimin se na paskësh pushtuar të gjithëve lakmia për floririn! Letërsia nuk është dhe nuk ka pse të jetë një montazh reportazhesh bulevardeske e aq më pak një procesverbal muhabetesh e thashethemesh rrugaçësh. Autori shpreh në veprën e vet një fatalizëm të pashmangshëm ndaj fenomeneve negative të shoqërisë, që trajtohen jo si shfaqje po si thelb. E

ardhmja përherë e më e mirë dhe e ndritur e vendit tonë socialist në novelë është errësuar. "Bulevardi i verbër" quhet pikërisht rruga kryesore e qytetit, ku e kalojnë kohën më tepër në kafene autori, që është gjithashtu personazh kryesor i veprës, dhe dy "heronjtë" e autorit, të cilët ai i ka quajtur jo me emra njerëzorë, por i ka pagëzuar Djaloshi i Pashëm dhe Peshku i Kuq.

I pari, Djaloshi i Pashëm është një njeri që nuk lufton për asgjë e vetëm ëndërron "me afsh", që është i dëshpëruar se pjesa e qytetit tej shinave të trenit, kú ai banon, quhet fshat e jo qytet dhe që fyhet tepër rëndë kur i përmendet emri dizenjator, paçka se ai punon pikërisht dizenjator. Ai vuan nga narcizizmi, gratë e mëhallës qënqeshin habitur nga bukuria e tij kur e lindi mamaja. Vetë autori na e thotë në novelë se Djaloshi i Pashëm nuk ngcjej me komplimenta. I dyti, i quajtur Peshku i Kuq, një qënie e deformuar, është "më praktik" se personazhi binjak Djaloshi i Pashëm. Ky mikroborgjez me triçiklin e qendrës së vet të punës bën matrapazllëqe dhe merret me allishverishe. Peshku i Kuq rri duke qerasur në kafene, ku bën muhabete dhe vjedh "diçka nga ato vise të hijshme të kurmit" të kamarieres, nga "mishrat intime" të së cilës mahnitet edhe vetë autorit. Të çuditshëm e të dyshimta janë marrëdhëniet e këtyre dy "heronjve" të novelës, të cilët, siç e lexojmë në të, "kanë zgjedhur udhë të drejtë: të ndjekin instiktet e veta të natyrshme". Ata na qenkan të dy artistë të lindur dhe, në të njëjtën kohë, ata paskëshin "një dashuri marrëzore për njëritjetrin", aludohet, pra, për homoseksualizëm dhe kemi kështu shfaqje tipike të një letërsie bulevardeske. "Kur takoheshin, Peshku i Kuq dhe Djaloshi i Pashëm, sikur duheshin me njëritjetrin - lexojmë përsëri. - Ajo miqësi u premtonte kënaqësi të vërtetë atyre". Ata duhen e grinden si dy dashnorë.

Është krejt e patolerueshme që, në vend të heronjve pozitivë, tipikë, që jeta jonë socialiste na i ofron kudo, autori vë në veprën e vet, siç u pohua në krye në pedestal mikroborgjezin, matrapazin: në vend të realitetit të ri frymëzues revolucionar plot realizime epokale dhe luftë heroike për kapërcimin e vështirësive dhe fitoren e së resë në të gjitha

fushat, autori e nxin dhe e diskretiton këtë realitet. Jo, skematizmi nuk luftohet në letërsi duke mohuar realitetin tonë, siç ndodh në novelën e shkrimtarit Koço Kosta. Bartës të idealeve të larta komuniste dhe të artit të vërtetë revolucionar nuk mund të jenë kurrësi figura të tilla, si Peshku i Kuq dhe Djaloshi i Pashëm. Tipa të tillë lumpen nuk ka se si të na vihen në qendër të një veprë letrare, si në këtë novelë, për të treguar se ne nuk jemi skematikë, se dimë të krijojmë personazhe "komplekse" duke zëvendësuar kështu heroin e veprës letrare, njeriun me shkronjë të madhe, me antiheroin, me njeriun e vockël; me vanitozin, me dështakun, me njeriun e deformuar fizikisht e shpirtërisht, me matrapazin që në këtë novelë është plot mllëf kundër ish-partizanëve që luftuan ndershëmrisht dhe tani "po e mjelkan socializmin". Dhe është e qartë se çdo mllëf vetjak merr kuptim shoqëror, kur ai futet në kufijtë e një veprë letrare.

Kjo novelë është vepër tipike e deheroizimit absolut. Do të zgjateshim po të flisnim më shumë për Djaloshin e Pashëm dhe Peshkun e Kuq, për këta artistë "të lindur" e të pavlerësuar, të çuditshëm e enigmatikë, për të cilët autori bën thirrjen t'i mbrojmë nga burokratët e nga mediokrit. Duke e luftuar gjoja, në novelë konservatorja, kjo luftë bëhet nga pozita krejt liberale dhe nihiliste. Cila është në novelë tabloja e qytetit ku çojnë jetën e tyre boshe Djaloshi i Pashëm dhe Peshku i Kuq? Këtu nuk dihet fare jeta e gjallë e sotme e qendrës së një rrethi as në industri e as në kulturë, këtu nuk vjen asnjë jehonë e aksioneve revolucionare dhe e punës që vlon në fshatin tonë të ri. Autori, përkundrazi na flet për "të shkretin njeri". Ai qëmton me skrupilozitet anët negative të jetës dhe u jep në novelë vendin kryesor. E bukura që është mbizotëruese në Atdheun tonë socialist, ia le vendin së shëmtuarës. Duke mbetur në një njohje të jashtme empirike dhe të rastit, autori ka trajtuar anën sipërfaqësore të fenomeneve. Në këtë ambient të zyrtë të novelës, pa gjallërinë dhe pa luftën e së resë me të vjetrën, fllitet për preokupime meskine. Kjo është një vepër që nxin realitetin dhe që s'ka gjë të përbashkët me realizmin socialist.

Në këtë novelë mbizotëron vulgariteti. Dhe ç'është më e keqja, personazhet vulgare i jepen shoqërisë si model. Përshkrimi i specave që skuqen apartamenteve, ironia për "dobinëe zarzavateve", "njerëz që fjalosen me vete", "palo djemtë e papunë", d.m.th. rrugaçët e parazitët, nuk sjellin në këtë novelë vetëm një atmosferë të shpifur, të paqenë e vulgare, por një tendenciozitet të theksuar mikroborgjez dhe, nga ana tjetër, një mosbesim ndaj shoqërisë sonë.

Ndërkaq, për njerëzit e talentuar, sipas novelës, kudo ka njerëz që ua hanë shpirtin dhe vetë kryetari i degës së Lidhjes është një tinzar, egoist e shpifarak. Duke pretenduar të trajtojë temën e artit, autori nuk ka vënë asgjë konkrete për jetën e artistëve, ku Partia dhe pushteti tregojnë një kujdes të posaçëm dhe radhët shtohen çdo vit me krijues të rinj të talentuar. Kur është fjala për nevojën e piktorëve të aftë e me shije nëpër ndërmarje, që është një kërkesë e vazhdueshme e jetës dhe praktikës sonë, autori me tendencë ngutet të shtojë se ata duhen siguruar, pa le të mos kenë kushërinj në komitet apo në Ministri. Djaloshi i Pashëm, si piktor që është, nuk shquhet në novelë për kurrfarë veprimtari dhe vlerash artistike. Për të na thuhet vetëm se fuqia e tij është "ndershmëria", një ndershmëri abstrakte. Kurse për krijuesit tanë partishmëria është më e madhja ndershmëri: se artisti militant flet në emër të popullit të vet, të revolucionit, të komunizmit. Novela shpreh, në fakt, mosbesim ndaj Partisë dhe vijës së drejtë të saj. Në novelë ne kemi një fetishizim të artit, një absolutizim të rolit të tij në shoqëri mbi atë të ekonomisë dhe një mohim të rolit të kiasës punëtore, të masave punonjëse dhe të Partisë.

Në novelë ka një konceptim të mjegullt të personazheve, që lëvizin si hije, pa botë të pasur, pa fizionomi, pa jetë, që pohojnë gjëra të paqarta e plot ekuivoke, bëjnë arsyetime të turbullta, të shkapërdredhura, nga më të çuditshmet e më të gabuarat, gati psikopatike. Dhe ka një inkoherencë të plotë në pasqyrimin e këtyre personazheve që herë janë të gati të neveritëshme herë pothuajse "e mallëngjejnë" rrëfimtarin Koço Kosta. Ka përçarje, përshkrime

kot më kot, fjalë e fraza pa një synim të qartë, që derdhen me rrëmuje pa arritur të bashkohen në një rrjedhë të vetme. Copëzimi kompozicional është, nga njëra anë, një synim i autorit nën ndikimin e prozës moderniste dhe, nga ana tjetër, është shprehje e drejtpërdrejtë e çorientimit ideor të autorit. Në mënyrë vërtetë të çuditshme, për shembull, në novelë bëhet pohimi këmbëngulës se njeriu u dashka gjykuar nga kafka e kokës: "Komiteti duhet t'i shikojë edhe kafkën atij që emëron në vende të rëndësishme!"

Për ditët tona, sikur të qëmtosh me kujdes, do të gjesh fare pak anë dhe pohime pozitive, si përskrimi i një peizazhi të realizuar të Djaloshtit të Pashëm nga fundi i novelës apo si kritika e drejtë për një piktor që shet domate të kopshtit të vet. Autori, përkundrazi, deklaroi me mendjemadhësi se ai nuk i sheh ashtu gjërat, si disa të tjerë nëpër libra apo si ndër artikuj të gazetave. Ai ka bindjen se te ne, siç pohon Peshku i Kuq, ambienti "ngre mediokrin dhe të ndershmin e shpall tuhaf". Mendjemadhësia e autorit arrin deri aty sa të shprehi bindjen se vetëm duke shkruar si ai vetëm në këtë novelë, librat letrare, do të kenë sukses të vërtetë, lexuesit do t'i përpijnë, se do të shiten pa asnjë propagandim. "I them autorit, - i shkruan redaksisë së "Nëntorit" një punëtor, - se ata libra, që do të kishin brenda shkrime si novela "Ata të dy e të tjerë", edhe të na i dhuronin falas, ne nuk do t'i prananim". Dhe si për t'i dalë përpara së keqes e për t'i mbyllur gojën kritikës, autori në mënyrë sfiduese e megallomane shkruan: "Kurrkush me dy pare mend në kokë s'do të më akuzojë se në novelë merrem me një temë "ekstrafagante". Unë ndiej se këtu lëviz një problem i madh shoqëror. Problem "aktual". Se ç'problem "i madh shoqëror e aktual" lëviz në këtë novelë të çoroditur, për këtë folëm më lart. Këtu duam vetëm të theksojmë se asnjë presion, në çfarëdo forme e nga kushdo qoftë, nuk mund t'i frenojë e t'i ndalojë njerëzit tanë të shfaqin hapur mendimet e tyre dhe të kritikojnë me guxim vepra të tilla, si novela në fjalë, dhe ta cilësojnë atë me emrin e vërtetë që ajo e meriton. Partia i ka edukuar krijuesit e lexuesit të jenë të papajtuësëm me çdo

vepër të dobët, të huaj e të dëmshme, pavarësisht nga emri i autorit të saj.

Nënvizojmë gjithashtu se nxirjen e realitetit nuk e shpëtojnë dot disa deklaratatë të përgjithshme të autorit për punë gjoja të ndërgjegjshme e sipas thirrjes së Partisë, nuk e shpëtojnë dot as citatet e klasikëve, madje në novelë kemi eklektizëm dhe lojë të palejueshme me citatet dhe në gojën e "Heronjve" të tillë si Djaloshi i Pashëm citatet e Marksit dhe të tjerëve zhvlerësohen e diskretitohen.

Duke e studiuar tërësisht këtë novelë, ne e shohim tashti qartë se shprehjet publicistike ose përdorimi i citateve të klasikëve nuk mund dhe nuk duhet të na shërbejnë asnjëherë ne botuesve, ashtu si edhe kritikëve, si leje kalimi të veprave me të meta ideore. Iidetë tona marksiste-leniniste dhe bindjet tona politike na mëson shoku Enver, - në çdo kënd e qelizë të veprës artistike, janë bindëse, tingëllojnë fuqishëm dhe i frymëzojnë lexuesit, ndihmojnë vërtet në edukimin e tyre komunist. Kërkimet novatore, për të cilat Partia na ka porositur e na porosit, në këtë novelë kanë kaluar në një deformim të tillë të formës, saqë kanë ndeshur në një reagim dhe mospëlqim unanimit. Zor të gjendet sot një autor, që do të kishte dëshirën të imitonte atë që në novelën e vet autori na e ka paraqitur si një novacion origjinal.

Shembulli negativ i kësaj novele të pabotueshme ngre edhe një herë përpara nesh nevojën dhe dosmodoshmërinë e edukimit marksist-leninist, të njohjes së jetës në mënyrë të thellë e të vazhdueshme. Çdo mendim se ne tashmë e paskemi shëtitur Shqipërinë e kemi njohur dhe e njohim jetën e vendit, se jemi shumica krijues me studime të larta dhe që kemi tashmë mjaft njohuri për estetikën tonë marksiste-leniniste është shprehje e qartë megallomanie e që, në fund të fundit, të lë prapa kohës, të lë në vend dhe, madje, ndonjëherë edhe në prapaktheu. "Vetëm duke u bazuar fort në ideologjinë tonë, në botkuptimin materialist dialektik, - ka thënë shoku Enver - mund ta kuptojmë drejt botën, jetën, të gjitha fenomenet e saj". Kryerja e detyrës bazë, që Kongresi i 8-të i Partisë ka ngritur

para shkrimtarëve e artistëve, që ata të trajtojnë dhe të pasqyrojnë gjerësisht në veprat e tyre problemet e mëdha të kohës, që dalingadalë të kompletohet prej shkrimtarëve dhe artistëve tabloja e madhe e epokës socialiste në Shqipëri, e ngushton patjetër mundësinë e veprave të tilla të dështuara ideartistikisht mbi jetën dhe problemet e sotme.

Duke përfunduar analizën e kësaj vepre qmobilizuese e fyese, që nuk shpreh e nuk merr fare parasysh mendimet e ndjenjat e lexuesve, të cilët sot janë aq të shumtë dhe të përgatitur për të dhënë gjykime të pjekura mbi veprat letrare e artistike dhe që është njëkohësisht, siç e theksuam edhe më sipër, një vepër krejt mediokre artistikisht, edhe pse autori spekulon gjatë gjithë novelës, pikërisht me luftën tonë kundër mediokritetit, le të përsërisim fjalët e shokut Rrniz kur thotë: "Artisti duhet të shtrojë gjithnjë përpara vetes pyetjen se vepra e tij shpreh mendimet e ndjenjat e masave, sa ndikon që të nxisë më tej përparimin në rrugën e zhvillimit socialist".

Ky rast i kalimit në shtyp të një vepre të patolerueshme do të jetë, pa dyshim, një mësim për të gjithë ne, që të përmirësojmë shumë metodën dhe stilin tonë të punës, që të forcojmë kolegjalitetin dhe të rrisim vigjilencën revolucionare, që të thellohem çdo ditë e më shumë në mësimet e Partisë e të mësuesit tonë të madhe e të pavdekshëm shokut Enver Hoxha, duke e merituar besimin e Partisë e të lexuesve të revistës, që na kanë ngarkuar një punë kaq fisnike, siç është botimi i një organi të rëndësishëm shtypi, duke merituar kështu kujdesin e përhershëm të Partisë dhe cilësimin e lartë të shkrimtarëve dhe artistëve si ndihmës së saj në edukimin komunist të njerëzve.

Marrë nga revista "Nëntori" Nr.5
Maj 1986

QARKORE: Tërë degëve të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve në rrethe

**LIDHJA E SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE
TË SHQIPËRISË**

Tiranë, më 20 Qershor 1986

**DEGËS SË LIDHJES SË SHKRIMTARËVE
DHE ARTISTËVE**

Në numurin 5 të revistës "Nëntori" do të botohet shënimi i redaksisë mbi novelën thellësisht e tërësisht të gabuar të Koço Kostës "Ata të dy e të tjerë". Porositeni, që pasi të studioni këtë shënim të redaksisë si dhe pjesën e parë të novelës (botuar në numrin 4), t'i diskutoni këto materiale në mbledhjen e Degës duke nxjerrë mësimet e nevojshme për rritjen e cilësisë së veprave letrare e artistike e për luftën kundër mediokritetit, për rritjen e militantizmit, që të ruajmë gjithmonë pastërtinë e artit tonë të realizmit socialist, që të mbështetemi përherë në mësimet jetëdhënëse të Shokut Enver dhe të konkretizojmë e të vëmë në jetë porositë e shokut Ramiz Alia në takimin me krijuesit e Korçës, si dhe në takimin e madh frymëzues me rininë e aksioneve revolucionare.

Për zhvillimin dhe rezultatin e mbledhjeve të na njoftoni menjëherë.

Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve
të Shqipërisë

**LIDHJA E SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE
TË SHQIPËRISË**

Nr. 123 Prot.

Tiranë, më 6.6.1986

**KOMITETIT TË PARTISË SË RRETHIT
KOMITETIT EKZEKUTIV TË K.P. RRETHIT
KRYESISË SË DEGËS SË LIDHJES SË
SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE**

F I E R

Kryesia e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë analizoi novelën thellësisht e tërësisht të gabuar të shkrimtarit Koço Kosta "Ata të dy e të tjerë" (pjesa e parë e botuar në "Nëntori" Nr.4,1986, kurse pjesa e dytë dhe e fundit u hoq nga Nr.5) dhe duke u mbështetur edhe në analizën e zhvilluar në degën e Fierit si dhe në propozimet konkrete të degës, vendosi:

1) Shkrimtari Koço Kosta kthehet në kandidat të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve.

2) Përrjashtohet nga Komiteti Drejtues i Lidhjes.

3) I hiqet prari i reduktuar, e drejta e marrjes së lejes krijuese si dhe hiqet nga lista e kandidaturave për të dalë në profesion të lirë.

4) I hiqet e drejta e botimit për një periudhë trevjeçare.

Ky vendim i Kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve t'i njoftohet menjëherë shkrimtarit Koço Kosta.

**Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve
të Shqipërisë**

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
KOMITETI EKZEKUTIV I KP TË RRETHIT
"Seksioni i kuadrit"

Nr. 2913

Fier, më 3.6.1986

SHOKUT KOÇO KOSTA
LAGJIA "KONFERENÇA E PEZËS "

F I E R.

Me vendim të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit datë 2.6.1986 në bazë të nenit 98 të Kodit të Punës gërma ç largoheni nga puna dhe po ky Komitetit u sistemon me punë në prodhim në kooperativën bujqësore Greshice.

Vula dhe firma e Komitetit Ekzekutiv
të KP të Rrethit

NOVELA E THYER

(Marrë nga Gazeta "Fjala" e përdyjavshme, kulturë, art e letërsi.
Viti XX, 1 Janar 1987, Prishtinë, çmimi 100 din.)

Proza e Koço Kostës "Ata të dy e të tjerë" të cilën po e sjellim këtu është në të vërtetë kaptina e pestë e novelës me të njëjtin titull, një pjesë e së cilës u botua në numrin e prillit (4/1986) të revistës letrare "Nëntori" që del në Tiranë. Në vend të vazhdimit, redaksia e "Nëntorit" e cila ndërkohë kishte pësuar ndërrime (ishte larguar kryeredaktori Dalan Shaplo dhe një anëtar i redaksisë), në numrin 5 të kësaj reviste të përmuajshme doli me një shkrim tejet autokritik me titull "Mbi novelën thellësisht të gabuar "Ata të dy e të tjerë", ku, në mes të tjerash, jepet edhe ky shpjegim: " Në këtë numër të revistës "Nëntori" duhej të botohej vijimi dhe fundi i Novelës së shkrimtarit Koço Kosta "Ata të dy e të tjerë" pjesa e parë e së cilës u botua në numrin 4 të revistës. Redaksisë, pas botimit të pjesës së parë, i kanë ardhur mjaft vërejtje, ku kjo novelë cilësohet si një vepër thellësisht e gabuar me të meta të theksuara ideore. Në to shprehet mendimi i prerë dhe i argumentuar se nuk duhej botuar kurrsesi një vepër të tillë që nxinte dhe diskretitonte realitetin tonë të sotëm, në të cilën ka fatalizëm dhe del sikur fenomenet negative janë të pashmangshme, një vepër që ve në piedestal të artit e të shoqërisës mikroborgjezinë, që shpreh konceptin idealist mbi rolin vendimtar të artistit në shoqëri dhe është tipike për një deheroizëm absolut, një vepër e dështuar, vulgare e krejt mediokre" (F.20)

E detyruar t'i pranojë këto "vërejtje", që në të vërtetë nuk janë tjetër veçse diskualifikime ideologjike, redaksia në shkrimin "Mbi novelën thellësisht të gabuar..." i nënshtrohet një

vetëkritike të çuditshme. Redaksisë i duhet të pranojë se ka vuajtur nga miopia, kurse kritikën ideologjike e mirëpret si shërim të vetin. E pas efekteve çuditbërëse të kritikës ideologjike, redaksia e "Nëntori" nxjerr edhe këto përfundime - mësimë : " Redaksia e revistës duke e parë këtë novelë, arriti në konkluzionin se ata që i kanë shkruar "Nëntorit" kanë plotësisht të drejtë dhe se ajo vetë është treguar miopë dhe oportuniste. Redaksia, duke e botuar këtë shënim deklaroi hapur se ajo ka përgjegjësi të rëndë për botimin e kësaj novele dhe ajo vendosi të mos e botojë fare në këtë numër të revistës "Nëntori" vijimin dhe fundin e novelës "Ata të dy e të tjerë", aq më shumë që kjo pjesë ishte edhe më e keqe se pjesa e parë" (21)

Meqë Koço Kosta qysh me shkrimet e para u imponua me talentin e individualitetin e vet krijues dhe si i tillë u mirëprit dhe u çmua lart nga kritika letrare, autori/autorët e shkrimit "Mbi novelën thëllësisht të gabuar" e ka(në) pa të udhës të zbulojë/zbulojnë se kritika e ka përkëdhelur këtë shkrimtar. Pra, kur i vë gjyslykët për korrigjim, redaksia e "Nëntorit" i sheh edhe gabimet e kritikës letrare që është marrë me Koço Kostën. Në vazhdim, redaksia e sheh të udhës që kritikën ideologjike ta ndihmojë edhe me kritikë stilistike e gjuhësore. Kështu, tash, pasi është kthjelluar redaksia e "Nëntorit" e sheh se Koço Kosta na paska "stil çapraz" dhe "gjuhë të përdhunuar"! Po nëse kemi parasysh "*mjaft vërejtje nga lexues të ndryshëm si dhe krijues*", që i arritën redaksisë së "Nëntorit" pas botimit të pjesës së parë të novelës "Ata të dy e të tjerë", në të cilat "*kjo novelë cilësohet si një vepër thëllësisht e gabuar me të meta të theksuara ideore*", atëherë mund të kuptohet përpjekja e redaksisë që edhe në këtë mënyrë të arsyetojë pozitën e vet të palakmueshme. Por, për ata që kanë pasur rast ta lexojnë Koço Kostën, këto "kritika" stilistike e gjuhësore nuk janë aq bindëse. Për këta më bindëse edhe pas kësaj do të mbeten vlerësimet e mëparshme, mjaft të favorshme të kritikës letrare për veprën e Koço Kostës. Prandaj, këtu na mbetet vetëm të shprehëjmë se redaksia e "Nëntorit" dhe "lexuesit" e "krijuesit" që protestuan për botimin e pjesës së parë të novelës "Ata të dy e të tjerë" me

kohë do të kuptojnë se ndalimi i botimit të pjesës së dytë të kësaj proze është me pasoja të shumta negative. Po ashtu, na mbetet të shpresojmë se ndalimi i botimit të novelës së Koço Kostës dhe kritikak që iu bënë atij me këtë rast nuk do të kenë ndikim vendimtar për fatin e këtij shkrimtari, i cili për mendjen tonë hyn në rradhën e prozatorëve më të mirë të gjeneratës së vet.

ISUF BERISHA / SHKËLZEN MALIQI

REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE
E SHQIPËRISË
KOMITETI EKZEKUTIV I KP TË RRETHIT

Seksioni i Kuadrit
Nr.6722/1 Prot.

Tiranë, më 27.12.1990

Lënda: Përgjigje shkresës nr.538, dt. 1.12.1990

LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE

T I R A N Ë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 538, datë 1.12.1990, sqarojmë se Koço Kosta është shqyrtuar për transferim në mbledhjen e organizmit të 31.7.1990 dhe nuk është miratuar, gjë për të cilën ju kemi njoftuar zyrtarisht me shkresën Nr.4656, dt.10.8.1990.

Vula dhe firma

ARTI DHE DIKTATURA

I

1

Për novelën "Ata të dy e të tjerë..." krerët e regjimit monist kurdisën një skandal ideologjik me përpjestime kombëtare. Ka qenë i fundmi skandal i madh në rradhën e gjatë të atyre që prodhoi mekanizmi makabër i diktaturës. Që të themi të vërtetën, këtë radhë alarmimi i egër i Përbindëshit nuk ishte pa shkak: Novela e K.Kostës ishte shembull i një disidence sfiduese dhe fyese për rendin. Çudia nuk është që censura e KQ të PPSH menjëherë u vërsul ta ndalonte qarkullimin e pjesës të parë të Novelës (botuar në revistën "Nëntori" Nr.4 të V.1986), dhe që urdhëroi të asgjesohej pjesa e dytë. Çudia është se si u arrit të botohej goftë edhe pjesa e parë.

Mos ndofta autori dhe dy drejtuesit e "Nëntorit" nuk qenë aq të vetëdijshëm për shkallën e lartë të frymës protestuese të Novelës? Mos ndofta pandehën se disidenca e saj ishte e maskuar mirë? Mos e nënveftësuan nuhatjen prej bishe që rrëfente regjimi kur ishte puna për të diktuar çdo gjë që ishte sadopak e dyshimtë, pa le armiqësore? Një farë roli mund të ketë luajtur edhe fakti që gati një vit më parë kishte vdekur Kryediktatori dhe kishin lindur disa shpresa të zbeta (po që u rrëfyen iluzione).

Lexuesi, që tani, më së fundi, e ka në dorë të plotë Novelën, le ta gjykojë vetë këtë çështje. Sidoqoftë kryesorja nuk është tek karakteri thellësisht jokonformist e disident i Novelës, por te fakti që Novela përfaqëson një krijesë artistike të mirëfilltë, novatore, të ndërtuar me mjeshtëri dhe të përshkruar nga një frymë e ngrohët humanizmi. Pra kemi të bëjmë me *disidencë artistike*, apo me *art disident*.

Vepra letrare disidente, po që s'e kanë dozën e mjaftë artistike, ka pasur tek ne. Ato kanë vlerën e tyre relative dhe do të kujtohen për rolin kulturor-moral, si shprehje të qëndresës së inteligjencës ndaj shtypjes. Por sidoqoftë vepra të tilla janë dokumente të sferës ideologjike -kulturore dhe jo të asaj estetike. Me kohë, shumica e tyre do të harrohen, kurse ato më të dokumentuarat do të mbeten si dëshmi faktike, që do t'u vlejnjë sidomos studjuesve të psikologjisë shoqërore dhe të historisë së publicistikës e të mendimit politik. Kurse publiku i gjerë nga veprat letrare kërkon patjetër art. Dhe ka të drejtë. Suksesin dhe jetëgjatësinë veprës ia garanton mbi të gjitha bukuria artistike, mjeshtëria dhe novatorizmi.

Koço Kosta njihet si një ndër përfaqësuesit më të talentuar të prozës sonë të shkurtër. Si tregimtar e novelist ai i ka shokët e rrallë. Tek "Ata të dy e të tjerë..." ai paraqet me anët më të mira e më tërheqëse të talentit të vet. Mund të themi se në vargun e prozës sonë artistikisht më të arrirë Novela "Ata të..." është një ndër ato që e kanë në shkallë më të lartë elementin jonkonformist e protestues. Dhe ndër veprat tona disidente ajo shënon një nga majat artistike.

Kjo ishte e para gjë që dëshiroja t'i theksoja lexuesit.

2

Në pamje të parë Novela ka tiparet e një etydi artistik-gnoseologjik. (Termin "gnoseologji" e ka sajuar Kanti për të emërtuar atë disiplinë filozofike që merret me problemet e dijes, me caqet e mundësisë e njohjes, me ecurinë e zbulimit dhe të verifikimit të së vërtetës). Te "Ata të dy e të tjerë" trajtohet një aspekt i posaçëm i problemit të njohjes e pikërisht çështja: a mund të njihet karakteri njerëzor, thelbi i tij më i thellë dhe në se kjo është e mundshme, me ç'rugë arrihet. Ky është boshti i parë i rëndësishëm i Novelës. Pastaj në Novelë nis e mbisundon një bosht tjetër i një natyre sociale-etike: fati i karaktereve njerëzore dhe i talenteve në kushtet e një regjimi diktatorial despotik.

Novela këto probleme i trajton në një rrafsh psikologjik e artistik. Veprat e artit letrar zakonisht nuk durojnë dot abstragime të tepërta, mbingarkesë konsideratash teorike, qofshin dhe të sakta e të thella. Le që K.Kosta nuk priret aspak për një krijimtari të atij tipi. Ai, problematikën sociale e etike, e mishëron gjithnjë në figura konkrete njerëzore, të ngjeshura me emocione, me lirizëm autentik, me detaje konkrete shumë shprehëse.

Këtë Novelë autori e ka ndërtuar sipas një modeli strukturor të cilin e ka përdorur dendur në tregimet e novelat e veta, sidomos në ato më të suksesshmet: një personazh kryesor (le ta emërtojmë konvencionalisht "Rrëfyesi i ngjarjeve" dhe që shpesh ka tipare psikologjike mjaft të afërta me ato të autorit) u drejtohet lexuesve. Në vetë të parë ai u rrëfen përshtypjet që i lindin gjatë njohjes me një njeri ose me disa njerëz, të cilët atij i duket se janë interesantë dhe që ia vlen të flitet për ta, për t'u zbuluar thelbin e karaktereve. Ky rrëfyes, si rregull, nuk tregon një subjekt të plotë, të lidhur, të shtjelluar sipas ligjësisë përkatëse të naracionit. Subjekte të plota, intriguese në vetvete, në veprat e K.Kostës nuk gjen veçse rrallë. Atij (apo Rrëfyesit) i pëlqen më tepër të na tregojë një varg episodesh të shkëputura, të zgjedhura me kaq kujdes, sa që janë të mjaftueshme që lexuesi të nxjerrë konkluzione të sakta mbi personazhin. Kështu nga leximi i prozës së K.Kostës në mendje nuk të mbeten vija të plota subjektesh, por tipa njerëzore nga më të ndryshmit si dhe figura e vetë autorit (apo e Rrëfyesit). Pra na kujtohet një galeri portretesh psikologjike tërheqëse, të cilave vetë lexuesi u ve një çmim moral të caktuar.

Mjeti më kryesor për pikturimin e portreteve është detaji karakteristik. K.Kosta është mjeshtër i gjetjes dhe i përdorimit të detajeve shprehëse, të natyrshme dhe plastike. Detajet e tij janë të llojeve më të ndryshme: ka asish që janë mjaft të ndërlikuar, përfaqësojnë si të thuash, një sistem detajesh të vogla: një episod, një dialog, një pejzazh o mjedis, një përshkrim i jashtëm fizik, apo i brendshëm-emoçional etj. Por më të shumtat janë detaje miniature: një e thënime e veçantë e personazhit, një gjykim mbi të, një fjalë, një reagim i hollë

emocional, një lojë e lehtë e fizionomisë, një krahasim një, veprim o gjest, një shikim, një heshtje e kështu me radhë. Dhe tërë këto nën një pamje shpesh "modeste e të pafajshme" por herë-herë mjaft pikante e ekspresive. Këto detaje fshehin në vete një informacion të pasur psikologjik e artistik, plot vërtetësi e fuqi emocionuese. Ato i kanë rrënjët të futura në thellësitë e karakterit. Mund të flasësh gjatë e gjerë për një njeri, për një personazh. Dhe mbi të gjitha ato që thua, mund të jenë të vërteta. Megjithatë karakteri njerëzor për të cilin flet, mbetet një mister për ne. Pse? Sepse tërë ato që rrëfeve ti, janë të lidhura vetëm me sipërfaqen e karakterit. Nuk na lejojnë të hedhim ndonjë vështrim në thellësitë e habitshme të shpirtit njerëzor, aty ku ndryhen dhe lëvizin enigmat më të mëdha të jetës, atë të ndërgjegjes së njeriut, - kësaj qenie të çuditshme, që herë meriton cilësimin shekspirian "Kryexhehahir i botës", por herë të tjera mund të shfaqet me pamjen e një përbindëshi moral, apo edhe si një përzierje e pabesueshme e së mirës dhe e së keqes. Përkundrazi, mjafton një detaj apo disa të pakta, të skalitura nga një dorë mjeshtërore, dhe je ja se si me magji zbulohet thellësia njerëzore, ndriçohet kjo apo ajo anë e misterit njerëzor. Tani nis me të vërtetë procesi gnoseologjik, ai i njohjes së karakterit.

Koço Kosta e ka mjaft të zhvilluar aftësinë për të ndërtuar detaje shprehës të këtij lloji. Kryesisht mbi to e mbështet mjeshtërinë e vet dhe suksesin letrar.

Te "Ata të dy e të tjerë..." kjo veçori e K.Kostës na shfaqet në mënyrën më të plotë e më joshëse.

Të përdorësh kësi detajesh karakteristike shpesh mund të duket si një gjë fare e thjeshtë, që mund ta bëjë cilido shkrimtar. Po s'është aspak kështu. Hajde, të lutem, gjeji në jetë e në fantazi këto detaje! Nuk mjafton dëshira, kultura. Të duhen të dhëna natyrore, aftësi të ralla vrojtimi, mprehtësi psikologjike, ndjeshmëri ndaj elementit estetik të realitetit. Të duhet pastaj dhe një përvojë jetësore, e cila e pasuron dhe e përsos prirjen natyre. Nevojiten dhe përpjekje sistematike të lodhshme.

Koço Kosta i ka mjaft të zhvilluara këto veti natyrore e të

fituara. Veçanërisht e ka shumë të begatshme përvojën jetësore. Ata që e njohin nga afër K.Kostën si shkrimtar, formojnë përshtypjen sikur ai ka në mendjete e vet një farë mekanizmi që regjistron dhe seleksionon pa pushim materiale nga jeta, detaje nga më të ndryshmet, të cilat pastaj i vendos në arkivën e kujtesës dhe të fantazisë (por dhe në skeda e në blloqe shënimesh). Në kohën e duhur, në procesin e krijimtarisë, nga kjo arkivë detajet shprehëse dalin vetiu - shpesh të transformuara, të përpunuara, - dhe shërbejnë si lëndë ndërtuese e klasit të parë, gjithë vërtetësi, freski, vitalitet. Kjo ndodh sa spontanisht aq edhe me vetëdije.

Ajo që dua të them është se K.Kosta është ndër shkrimtarët tanë që e njih më gjerë, më saktë e më larmishëm realitetin e jetës sonë. Ai mban lidhje të shumëanshme, intensive me jetën, me njerëzit. Habitesh kur konstaton se sa shumë njerëz njih ai, njerëz të moshave, profesioneve, përvojave, kulturave, tipeve e vlerave më të ndryshme. E kam fjalën, për njohjen e llojit artistik, d.m.th. për depërtimin në karakteret, nëpërmjet gjetjes së detajeve që përmenda më lart. Dhe diçka interesante: nuk është vetëm K.Kosta që prirët vazhdimisht të shkojë tek këta njerëz që janë "furnizuesit" e tij me detaje e informacione bazë. Janë sidomos ata që venë tek ai; dhe venë me kënaqësi. Është çudi pastaj se çfarë gjërash i rrëfejnë ata pa droje shkrimtarit mbi jetën shoqërore, ekonomike, kulturore etj e deri mbi jetën e tyre intime. Lexuesi do ta verë re në Novelën "Ata të dy..." këtë dukuri, sikundër dhe seleksionimin dhe përdorimin mjeshtëror të detajeve karakteristike. Zaten kjo përbën një nga shtyllat mbajtëse kryesore të Novelës. Në përgjithësi shumica e krijimeve më të pjekura të K.Kostës e kanë zanafillën tek ky burim informativ, tek mcria e detajeve, që pastrohet në shumë sita derisa veçohet materiali i çmuar psikologjik estetik. K.Kosta ka edhe fantazi të zhvilluar, por ai nuk është nga ata që presin t'i pjellë fantazia materiale ndërtuese. Fantazia e tij nxitet, frymëzohet sidomos kur në të futen me shumicë detajet reale.

Kjo metodë pune krijuese nuk është aspak ndonjë

prapa. Ata s'e kishin ulur mushamanë. E uli vetë dhe nga jashtë s'dukej asgjë. Unë megjithatë mendova se në trupin e tij kishte shumë limfë. Po. Matrapazët janë tipa energjikë.

Më përshëndeti i qeshur, ngriti supet, bëri me të shpejtë gjysmën e udhës gjer tek unë, ndaloi, qeshi prapë dhe tha:

- Popull! Shtresë! Ne i djegim etapat, babam! Kështu. Neee... Ej! Në darkë. Mirupafshim!

Foli kështu me eliptizëm, në një mënyrë enigmatike dhe iku.

Iku duke gurgulluar gaz. Doçka e tij si putër arushi u ngrit përsëri dhe më përshëndeti. Pastaj të dy gishtat e doçkës u afruan sikur të numuronin lekët.

Triçikli nxitonte. Në shpinën e mushamasë së lyer me ngjyrë të bukur u mundova të dalloja se ç'tregonte *ekrani i televizorit*. Shikova fytyrën e kuqe buçko të njeriut të shkurtër. Skërmita dhëmbët. Në mend, tingëlluan prapë fjalët e tij të fundit. *Shtresë. Ne i djegim etapat! Në darkë!*

Kurse në trurin tim të ngrohur, të trazuar e të inatosur, fytyra e shkëlqimtë e spikerës së mbrëmjes me buzëqeshjen e përnjohur e të përhershme që tha:

FUNDI I PJESËS SË DYTË

U shkunda dhe hapa sytë dhe nxitova nën ballkon pranë një librerie. Aty erdhën shumë kalimtarë dhe bënin potere. Gjithashtu shiu po vinte edhe ai me potere. Dhe buzëqeshja e përnjohur dhe e përhershme e spikerës, që më doli përsëri te mendja, te ekranin e vizatuar në mushamanë e televizorit. Dhe fjalët e saj të fundit.

3

Pasdite do!a nga apartamenti para orës 18.00. Në shëtitoren "Bulevardi i Verbër" s'takova asnjë të njohur. Në të dy

anët degët e rrapeve shushurinin ngadalë.

Lashë prapa shëtitoren dhe hyra në Qendër të qytetit. Askush. Askush me të cilin të përshëndeteshim.

Nxitova çapat dhe ata e gjetën vetë lokalin. Tavolinat ishin të ngarkuara me njerëz aty këtu. Një krah i shkurtër me pëllëmbën e kuqe si petull e fryrë që lëvizte në ajër. Ata atje ishin tre.

U ula vetëm. Dhe piva me dëshirë dhe me fund një gotë me ujë mineral. *Eau minerale naturelle*. Shumë bukur! Me shumë kënaqësi nisa të shijoja kafën.

Po sepse përnjëherësh më pushtoi zymtia. Me siguri dukeshja i ngrysur. Shikova tek ata të tre: Peshku i Kuq dhe tjetri po qeshnin. Eh! Djaloshi i Pashëm rrinte krenar, drejt dhe shikonte diku pa përcaktim. Tjetrin e njihja. Ai që pompist në naftë dhe punonte me turne. U kthye dhe lëvizi nga karrigia dhe më përshëndeti. Gjer atë kohë ai më kishte përshëndetur disa herë, por unë s'e kisha vënë re. Sepse më që bërë mjegull përpara retinës së syve.

Si është i shkreti njeri! Befas, fare pakuptuar, diçka e ngrysur e ngacmon në palcën e shpirtit dhe ai gremiset në zymti! Gjithmonë mund të gjendet diçka në jetën e gjatë të njeriut që mund ta ngacmojë! Të del përpara një matrapaz, të buzëqesh si të të ketë ortak dhe kështu të nxin jetën.

Pompisti dhe Peshku i Kuq qeshnin! Vetëm Djaloshi i Pashëm i shikonte ndonjëherë pjerrtas përtej supit dhe diçka thoshte. Pas atyre fjalëve Peshku i Kuq lëvizte. Bërte ca gjeste që ia njihnin njëri-tjetrit sigurisht. Dhe qeshnin. Qeshnin me zë, po s'm'u duk se shqetësonin sallën. Dy herë një pas një Djaloshi i Pashëm foli dhe ngriti krahun e lartë dhe i shoqëroi fjalët me pëllëmbën e hapur dhe gishtat e gjatë. Pastaj shikoi përsëri gjetkë. Ai sikur që regjizori i bisedave.

Pompisti, i tëri i qeshur në fytyrë, uli kokën, i belbëzoi diçka Peshkut të Kuq dhe të dy riqeshën. Peshku i Kuq njëherësh u bë i vrenjtur, zgjati qafën, gusha iu tund dhe mjekrën e uli mbi pëllëmbën e vogël të hapur. Dhe shikonte te perdet i menduar. Në atë pozicion kishte diçka komike. Pompisti

paradoksale detyroheshin të krijonin shkrimtarët tanë më të zotë. Por këto mjete mbrojtëse nuk i vlejten fare Novelës: censura partiake u muar me boshtin disident të veprës dhe as i përfilli "mbrojtjet" e tilla. Madje me zemërim i konsideroi si dredhi politika dinake.

4

Detyrën e vështirë të zbërthimit të karaktereve të dy protagonistëve ("Atyre të dyve") e merr përsipër Rrëfyysi. Ky zbërthen edhe veten, nëpërmjet vetëanalizës. Procesi i njohjes është gradual, me zik-zake të koklavitura, turbulluese, me gabime, dyshimesh, intuicione, arsyetime, analiza. Vetëm me një rrugë të tillë të vështirë arrin më së fundi Rrëfyysi tek ndriçimi i enigmës së personalitetit të dy protagonistëve. Njëkohësisht ai na zbulon dhe vetveten si dhe disa anë të rëndësishme të realitetit shoqëror të asaj kohe. Autori është nga ai soj shkrimtarësh që është i bindur se mund të arrihet e vërteta mbi shpirtin njerëzor, qoftë dhe me mundime e gabime. Për këtë është e huaj fryma agnosticiste apo skeptike, që karakterizon mjaft shkrimtarë modernë. Lexuesi le të gjykojë në se autori ka të drejtë apo jo në këtë pozitë krijuese të tijën.

Rrëfyysi i shikon për herë të parë të dy miqtë ("Ata të dy") një ditë kur, pas lodhjes së krijimtarisë, ka ardhur në një lokal për të pushuar dhe për të pirë kafën tradicionale. Atë ditë dhe ditë të tjera ai vëren se në një qoshe të preferuar, të mënjanuar të lokalit ulen dhe pijnë ponç të dy miqtë, të shoqëruar herë-herë nga ndonjë i njohur i tyre. Në fillim Rrëfyysin e tërheq fakti se çifti është çuditërisht i pagoditur, sikur midis të dyve nuk ka ndonjë pikë zfrimi. Djaloshi i Pashëm, siç e thotë nofka e tij, është i pashëm, me një fizionomi fisnike, serioze; është fjalëpakë, i veshur thjeshtë, por me një prerje dhe me kombinim ngjyrash që i shkon fort. Tjetri, Peshku i Kuq, sikur është antipod i të parit (si "gëzimi pranë hidhërimit", thotë Rrëfyysi). Ka një dozë të madhe vulgariteti në trup e në fizionomi, në sjellje

e në fjalë. Djaloshit të Pashëm nuk i pëlqen të lëshojë asnjë fjalë të vetme të pahijshme, veç rrallë kur zëmërohet. Dhe di të bëjë humor të mprehtë, të vërë në lojë me zotësi tjetrin, duke ia zbuluar anët komike. Por për vete nuk lejon një gjë të tillë. Në qëndrime e sjellje ka një farë aristokratizmi, apo snobizmi, që mund të duket e çuditshme, në mos ca qesharake, kur merr vesh se nga profesioni është thjesht një dizenjator, pak a shumë një "bojaxhi" i ndërmarrjes. Dhe është i pashkolluar. Tjetri, që është shoferi i një triçikli, d.m.th. transporton mjetet elektroshtëpiake nga banesat në qendrën e riparimit të tyre, - as që merakoset fare për sjelljen e jashtme dhe duket sikur i pëlqen që miku i tij ta verë në lojë.

Këto e të tjera përshtypje të jashtme e intrigojnë Rrëfyenin.

Ç'të jenë këta dy tipa ca të çuditshëm? Që janë interesantë, s'ka asnjë dyshim; por mos janë thjeshtë "karagjozë" interesantë? Mos janë nga ata tipat tuafë që provinca e prapamenbetur i prodhonte me shumicë? Iritohet kur vë re se të dy nisin ta vëzhgojnë me ngulm vazhdimisht që nga tavolina e tyre dhe sikur bëhen gati ta ftojnë. Ai një farë kohe i shmanget njohjes me ta. Por një ditë kureshtja e shtyn ta pranojë ftesën e tyre. Intuita i thotë se këtu fshihet diçka që mund t'i vlejë si shkrimtar. Sepse këta të dy, në daç të jenë njerëz për të qenë, në daç jo, sidoqoftë pa dyshim janë origjinalë, me një origjinalitet qëndofta ia vien të zbërthehet së brendshmi.

Karkateri origjinal e tërheq njeriun, sidomos shkrimtarin, për të cilin mediokriteti i zbetë, mungesa e origjinalitetit është një mjerim i vërtetë njerëzor.

Dhe kështu Rrëfyeni futet në vallen e njohjes. Përshtypjet e para janë kontradiktore: i pëlqen humori i hollë, i goditur i Djaloshit të Pashëm. I pëlqen e qeshura e të dyve (Nga e qeshura mund të kuptosh njeriun, ka thënë Dostojevski), si dhe sjellja diskrete në lokal, ku nuk trazojnë askënd dhe flasin përherë me zë të ulët. Por ama këto nuk dëshmojnë akoma për vlera thelbësore. Rrëfyeni nuk nxitohet

të konkludojë. Aq më tepër që e nervozon dhe e çgënjën fakti se Peshku i Kuq e përdor triçiklin e ndërmarrjes për të transportuar për llogari të vet personale mobiliet e qytetarëve. Dhe për më tepër i bën përshtypje të keqe që Peshku i Kuq e pöhon këtë gjë si fare pa të keq dhe me fjalë banale: "Përgjo se mos rrëmbej ndonjë lek. Nxjerr diçka që të ulemi të ngrëhosur në lokalin afër detit të bekuar". Rrëfyesin e neveritin marifete të tilla dhe menjëherë gjykon: "Mbase jam në sipërfaqen e tyre. Po thelbi, thelbi? Cili është thelbi? Ja, bre, aty përpara hundës është thelbi: matrapazi... Peshk i Kuq, Peshk i Zi! Matrapaz".

Mirëpo e ndjen se është ngutur. Dhe Rrëfyesi e di se ngutja pjell këlyshë të verbër, të shpie në përfundimë të parakohshme, mashtruese, sidomos kur gjykon një karakter njerëzor. Matrapazi i vërtetë ka diçka banale, thellësisht vulgare në karakter. Kurse nën vulgaritetin e sipërfaqshëm të Peshkut të Kuq sikur fshihet diçka e ndryshme, larg vulgaritetit. Këtë ia thotë intuita prej shkrimtari me përvojë. Prandaj lëkundet, nuk vendos dot. Rrëfyesit i bën përshtypje të veçantë një konstatim: të dy miqtë kanë një sens plastik dhe koloristik të zhvilluar: të domosdoshëm në artet figurative. Ky dizenjator, ky "bojaxhi" dhe ky shofer "matrapaz" që të dy të pashkoilë, dinë të japin vlerësime mjaft origjinale, të mprehta e të shakta për veprat e pikturës. Janë vlerësime jo të huazuara nga leximet o të dëgjua nga të tjerë. Ata dinë të japin gjykime çuditërisht profesionale dhe estetikisht të bazuara. Duket qartë se kanë shije të sigurtë, predispozitë të lindur. Dinë të kritikojnë por dhe të lëvdojnë pa kurrfarë zillie.

Pas kësaj Rrëfyesi provon një befasi që e bën të mendohet: Djaloshi i Pashëm një ditë, papritur, si i shtyrë nga një forcë e brendshme, nxjerr një skedë dhe me karbon me shpejtësi improvizon profilin e një vajze. " Në kokë e në shpirt duhej ta kishte. Ajo vajzë tanimë na shikonte që nga copa e letrës..." Dhe pastaj Djaloshi i Pashëm e gris me mospërfillje skedën dhe e flak. S'ka dyshim që ky është një njeri me aftësi krijuese. Një herë tjetër Rrëfyesi do të marrë vesh se ky është

dhe pejzazhist i hollë plot lirizëm, kolorist me shije. Për jo vetëmka shije të mbrojtë të bukurën në art e në jetë dhe të diktojë e të përbuzë të shëmtuarën, skematiken, por di dhe të krijojë ai vetë, me profesionalizëm, ndonëse me ndonjë mangësi që vjen nga boshllëqet e kulturës akademike. Rrëfyesi, që është vetë një natyrë artistike e mirëfilltë, menjëherë konkludon se ka të bëjë me një artist, me një shok arti, që duhet marrë seriozisht. Patjetër seriozisht e me respekt e mirpëkuptim. Profesionit "dizenjator" është një aksidencë, një tipar jothelbësor, i lindur nga rrethana fatkeqe.

Po prapë ka një çast lëkundjeje të fundit; ai i thotë vetes pak a shumë si Hamleti: "Dua provë më të sigurtë". Dhe prova e sigurtë vjen shpejt. Në Novelë ka disa prova të tilla, njëra më e bukur se tjetra, që e mbyllën ciklin e njohjes të të dy miqve.

I pari është një episod mallëngjyes kur të dy miqtë takohen në Galerinë e arteve figurative në Tiranë, ku kanë shkuar për të parë portretin që, sipas kritikëve tanë, kishte dalë nga peneli i Rembrandit. Vetëm njerëz të mirë dhe natyra të vërteta artistike mund ta përjetojnë ashtu kontaktin me një vepër arti mjeshtërore, me aq mallëngjim e lumturi siç e vërejmë te të dy miqtë.

Pastaj vijon episodi i bisedës së Djaloshit të Pashëm me Rrëfyesin, kur i pari flet me një dashuri e dhembshuri të habitshme për Peshkun e Kuq dhe zbulon disa të dhëna prekëse për jetën, karakterin humanist dhe aftësi artistike të këtij njeriu, që dukej aq "banal". Peshku i Kuq na zbulohet si një njeri tërë poezi e humanitet e me shpirt delikat e fisnik. Rrëfyesi arrin një thellim tjetër në karakterin e Peshkut të Kuq, kur ky i flet për pasionin e vet për artin figurativ. Ai do të ishte i gatshëm ta falte tërë "thesarin e Ali Pashë Tepelenës" vetëm e vetëm që të kalonte disa javë në muzeumin e pashoq të Luvrit, për t'i përpirë kryeveprat botërore, që ai fatkeqësisht i ka admiruar vetëm në riprodhime librash e kartolinash. Por kërkon si kusht që në Luvër të shkojë patjetër bashkë me mikun e pandarë, Djaloshin e Pashëm. Se pa të, i duket sikur gëzimi do t'i fashitet. Episodi përfundimtar është ai i rrëfimit të Shoferit të Drejtorit. Ai na flet se

si e pa Djaloshin e Pashëm kur pikturo! një pejzazh të bukur në pak orë.

Rrëfyesi (dhe lexuesi) binden përfundimisht se nuk kemi të bëjmë me dy tipa tuafë, ekstrasfantë, të përcudnuar nga kushtet e vështira të provincës së varfër shqiptare. Aq më pak nuk janë dy qenie vulgare. "Këta janë si fëmijë pa të keqe në shpirt... Ata fshehin një dashuri marrëzore për njëri-tjetrin dhe për artin e madh... Janë njerëz të mirë. Pikë... Ky është thelbi i tyre, që unë kërkoja të zbuloja. Tani duhet të thellohem, ". Ky është konkluzioni logjik i Rrëfyesit, që ndjen simpati, respekt e miqësi për ata të dy.

Vetëm kur i ka njohur me themel, Rrëfyesi papritur ndjen nevojën e thellë që të shkruajë për ta një novelë, ku t'i pikturojë siç janë të vërtetë dhe t'i marrë në mbrojtje njerëzisht. Këtë nevojë e ndjen aq natyrshëm sa e "ndjen" pema lëvizjen e padukshme të limfës në stinën e pranverës, atë lëvizje që do të bëjë të çelin lulet e të lindin frutat. Apo siç i ndjen me gëzim femra shenjat e procesit të magjishëm të dridhjeve të para të jetës së embrionit që mban në mitër. Ja, me një spontanitet të tillë të pafrenueshëm, - që ndryshe quhet edhe frymëzim, - nis akti i krijimit të vërtetë artistik.

Tani ne e kuptojmë pse Djaloshi i Pashëm u zemërua aq fort kur Peshku i Kuq e prezantoi si "dizenjator". Nuk ishte puna te sëdra e lënduar, por për një gjë ka rëndësi jetike për të. Djaloshi i Pashëm, (si dhe Peshku i Kuq), është artist në themel të shpirtit të vet dhe e quan si zanatçi të zakonshëm. Ai nuk lëndohet fare që Dega e Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të qytetit të tij nuk e konsideron dhe as që e di se Djaloshi i Pashëm është artisti i mirëfilltë, një nga të paktët artistë në rreth. Djaloshi i Pashëm as e përfill fare ekzistencën dhe autoritetin e Degës së Lidhjes sepse e quan këtë organizëm si vatër skematizmi e si rezatuese të antiartistit. Pra nuk i duhet aspak përkrahje e Degës. Por ama nuk mund ta durojë që miku i tij, Peshku i Kuq, qoftë dhe me shaka, të verë sadopak në dyshim vetinë e tij si artist. Ka gjëra me të cilat nuk mund të bëhet asnjë shaka; të paktën Kështu mendon ky njeri.

Pamë pak më lart se Rrëfyysi, pasi mendoj se e kishte njohur thelbin e dy miqve, prapë se prapë nuk e quante punën e vet ('gneseologjike") të përfunduar. "Tani duhet të thellohem", tha ai. Sepse mund të thellohem edhe në njohjen e thelbit. Rrëfyysi e ndjen se jeta e këtyre dy miqve përmban një dramë që duhet ndriçuar. Dhe trajtimi i kësaj drame e shpie Rrëfyysin në disa konkluzione shoqërore nga më të rëndësishmet e më aktualet për realitetin shqiptar. Kështu del në pah ai që quajta boshti kryesor i Novelës. Përse këta dy njerëz aq të mirë, humanë e të talentuar nuk përfillen fare nga zyrtarët partiakë të rrethit dhe nga drejtuesit e Degës së Lidhjes? A është ky një gabim i rastit e individual apo një dukuri e përhapur në fusha të tjera të jetës sonë? Si vlerësohen e administrohen nga krerët e partisë dhe të shtetit energjitë krijuese të popullit? Këto e të tjera pyetje analoge dalin vetvetiu, haptazi apo të nënkuptuara, në Novelë.

Peshku i Kuq bën një vërejtje që shërben si kyç për të kuptuar kryeproblemin që përmendëm: "Ambienti mund të të zvogëlojë. Ose të fal drejtësisht dimensionet që të takojnë. Ose të bën hatanë: ngre mediokrin, kurse të ndershmin e shpall tuaf". Ambienti, mjedisi shoqëror ndikon fuqimisht mbi fatin e individit, po dhe të grupeve shoqërore e të mbarë kombit. Mjedisi mund ta favorizojë zhvillimin, rritjen normale të personalitetit njerëzor. Por mund edhe ta frenojë. Është një ide e hershme që ka lindur shumë shekuj më parë. Një nga iluministët më të shquar francezë thoshte se janë të shumtë në jetë njerëzit që kanë pasur predispozita të jashtëzakonshme, madje gjeniale dhe megjithatë nuk e kanë rrëfyer kurrë forcën e vet, ose dhe që s'kanë dyshuar fare se ç'potencial të habitshëm kishin trashëguar nga natyra. Dhe kjo vetëm pse mjedisi ku i kishte vërvitur rasti, ishte krejt i disfavorshëm, i shtypte.

Në thënien e Peshkut të Kuq për rolin e ambientit, ndjehet një notë trishtimi, sepse ai aludon për kushtet ndrydhëse të ambientit të kohës moniste, kushte të tilla që nuk i

kanë lejuar të dy miqtë dhe shumë e shumë të tjerë të rrëfejnë vlerat e tyre të vërteta. Po çfarë e bënte ambientin kaq të pafavorshëm e ndrydhës? Mos vallë vetëm trashëgimia historike, prapambetja ekonomike-kulturore me rrënjë në të kaluarën? Jo vetëm ajo; dhe jo kryesisht ajo. Ekzistonte një faktor i mbrapshtë që ndikonte për të keq mbi energjitë shpirtërore të mbarë kombit. Dhe këtë faktor e denoncon në Novelë pikërisht Peshku i Kuq, ky shofer tricikli, që ka pamje aq vulgare, por që guxon e jep një shpjegim, që me siguri u ka djegur si hekur i skuqur krerëve të diktaturës enveriane. "Pse mburren disa se kanë qenë parrtizanë? Se e kuptuan se ashtu përfitojnë. Se shumë nga ata që luftuan, po e mjelin keq popullin, kaq vite. Apo jo? Këtë bëj libër zotëria jote, jo shkruan e më nxin vetëm mua se më mbërtheve që mora pesë lekë me triciklin. Ngjitur edhe një çikë më tej, zotrote, dhe hapi fletët. Dhe pastaj, pastaj do të shohësh njerëzit tanë se si do të t'i lexojnë librat. Do t'i përpijnë. Me tallona do të shiten, jo me urdhër e agjitacion. Dhe mua atëherë do të më vijë turp të bëj kontrabandën time... Më duket u ngatërrova. Çoç doja të shkoqitja, po sikur s'e thashë dot mirë, ë"?

Kurse lexuesi thotë: "Jo, or i miri dhe i ndershmi Peshku i Kuq! Jo, nuk u ngatërrova asnjë çikë dhe gjërat i fole si s'ka më mirë. Shumë më mirë nga ç'lejohej në atë shoqëri të djallosur fund e krye të socializmit real burokratik. Ti "u ngjite lart" dhe ia hape fletët lakrorit stalinian. Dhe shëmtimi doli në pah fare qartë. Ky është regjimi që e shpall veten "popullor" dhe "sjellës të lumturisë" për kombin, por në të vërtetë është rendi i parazitizmit, që e trajton popullin si një lopë që duhet mjelur nga klika e të privilegjuarve. Dhe deomos klika nuk do të çajë kryet për energjitë krijuese të kombit, dhe për talentet e njerëzve të thjeshtë.

Por Peshku i Kuq hap dhe fletë të tjera; ai zbulon edhe këtë gjëmë: kjo është edhe mbretëria e mediokritetit zyrtar: "Komiteti (pushteti) duhet t'i shikojë dhe kafkën (kapaciteti nintelektual e moral) atij që emëron në një post me rëndësi. Një i paditur, një i pandershëm, po e emërove në një

post me rëndësi. s'është më *Një*, ai është *Një Hata*. Se ai ushqen, shpërndan, shtrin mediokritetin si metastaza". Rendi stalianian në Evropën lindore ka qenë pikërisht "Një Hata" e tillë: mbretëria e MEDIOKRITETIT. Në postet e rëndësishme, që nga ato më kryesoret, shpërndaheshin metastazat e paaftësisë, të mediokritetit, të pandershmerisë shoqërore. Dhe atdheu i Peshkut të Kuq këtë Hata e përjetonte në variantin më të zi, në variantin enverian. Këtë thotë Peshku i Kuq. Dhe Djaloshi i Pashëm nuk mbetet pas tij në denoncim. Ai kërkon prerazi: "Mjaft më; mediokrit duhet të nënshkruajnë daljen e tyre në pension". D.m.th. bën thirrje që krerët e regjimit dhe tërë suita e tyre kaba, të vetëmënjahohen, në mos po do të flaken, sepse: "Mjaft më", durimi popullor po sos. Por mbretëria e mediokritetit nuk dëshironte aspak të largohej nga skena, donte të vazhdonte lojën e tmerrshme" të mjeljes së popullit". Katër vjet pas botimit të *Novelës*, popullit tonë si dhe popujve evropianolindorë, iu desh që ta kryente operacionin revolucionar të shkulljes kirrugjike të vatrës së metastazave.

Këto mendime të dy miqtë i mbron edhe Rrëfyesi, si shkrimtar i ndershëm që është. Duke u mbështetur tek romani për "shokun Zylo", ai argumenton se jetojmë në rendin ku postet kyçe të shtetit e të partisë, të mbarë jetës shqiptare i kanë në zotërim Zylot, njerëzit e paaftë, që përhapin ngado frymën e mediokritetit, sepse kjo është atmosfera e volitshme ku ata mund të vegjetojnë. Zylot mendojnë kryesisht për vete, për njerëzit e vet (për Diogjenët, fëmijët e tyre, të cilëve u sigurojnë poste e karrierë të rehatshme). Përpiqen për miqtë e tarafet e veta. As që çajnë kryet për nevojat jetike të popullit. As që mendojnë t'u hapin rrugë të lirë energjive aq të mëdha të kombit. Përbuzin aftësitë e njerëzve pa mbrojtje, i shpërfillin talentet si ata të dy miqtë. Sigurisht që edhe në këtë mbretëri diç kryhet, diç e mirë realizohet, sepse është një popull i tërë që për dekada të shumta punon e robotet. Por bëhet shumë më pak nga sa duhej e mundej. Dhe kostua e çdo përparimi është tepër e lartë për popullin. Sigurisht autori në *Novelë* përpiqet t'i maskojë disi këto konkluzione të vetat, por nuk është e vështirë

t'i deshifrosh arsyetimet e Rrëfyetit kur ai flet për romanin e Zylos.

Po si do të bëhet katharsisi, pastrimii jetës shqiptare nga kjo e keqe që po e moleps rëndë? Kjo është një pyetje tejet delikate dhe e rrezikshme. Por Novela tenton me guxim t'i japë një përgjigje. Sigurisht që nga autori i Novelës "Ata të dy e të tjerë..." nuk mund të kërkojmë që në kushtet e diktaturës, të viti 1986, kur nuk kishte asnjë shenjë të qartë të asaj përmbysjeje të habitshme shpëtimtare që ndodhi në Lindje në v.1989-1991, të paraqiste zgjidhje të qartë e të plotë. Dhe as që ishte e lejueshme kjo, siç e dimë. Merita e Novelës është se edhe në ato kushte ajo parandjeu dhe shprehu në gjuhë "të shifruar" disa nga proceset e ardhshme, përkrahu kërkesa që do të bëheshin shumë më sistematike e rrënjësore pas 5 vjetësh dhe do të merrnin formën e një revolucioni demokratik mbarëllindor.

6

Formën e parë të katharsisit shoqëror e pamë të propozohet nga Djaloshi i Pashëm: "Mediokrit të japin vetë dorëheqjen".

D.m.th. vullnetarisht krerët e regjimit të largoheshin nga pushteti. Kuptohet vetiu se kjo ishte një kërkesë utopie. Rrëfyeti nuk e thotë kot: se "Tek Djaloshi i Pashëm (dhe te Peshku i Kuq) ka diçka nga Don Kishoti". Kjo s'është fyerje, aq më pak përqeshje. Është konstatimi realist, që ende nuk ishin pjekur kushtet për gjetjen e një zgjidhjeje të mirëfilltë të problemit që shqetësonte mbarë Lindjen: ç'do të bëhet me rendin e socializmit totalitar? Por në utopinë e "dorëheqjes vullnetare" sidoqoftë përmbahej edhe një element me vitalitet: kërkesa për zëvendësimin e domosdoshëm të drejtuesve mediokrër e parazitare, që në fakt don të thoshte zëvendësim i tërë rendit që ata drejtonin e përfaqësonin. "Pra "donkishotizmi" i Djaloshit të Pashëm përmbante një moment racional shumë të rëndësishëm. Prandaj autori thotë: "Është fatkeq ai tek i cili nuk

do të kishte një grimë nga Don Kishoti”.

Që Novela nuk e kishte fjalën për zevëndësimin vetëm të disa kuadrove, sidomos të dorës së dytë, e kuptojmë edhe nga kjo: Djaloshi të Pashëm i ka mbetur në mendje një mendim i Sami Frashërit që ai e citon me admirim: “Shqiptarët as në qeverit as në besë, nuk donin një vetë, që bën çdo, po u kish ënda këshillën e kuvendin e të shumëve”. Që ky citat bënte aluzion për diktaturën personale të atij që “bën ç’do në shtet”, d.m.th. një tipar themelor të rendit shtetëror në Shqipërinë enveriane, as që vihet në dyshim. Është kërkesa për një rend shtetëror ku s’ka kult e tërëpushtet të një diktatori, por ku vendos shumica. Demokracinë evropiane- ja ç’kërkonte Samiu. Ato fraza konvencionale që Djaloshi i Pashëm shton pas citatit të Samiut (për “vijën e masave që e zbaton *Partia jonë*” etj) nuk e fshehin dot të vërtetën dhe as e shpëtuan dot Novelën nga goditja e rendit zylian. Rrëfyesi në fund të Novelës na njofton figurativisht se ç’rend dëshëron ai për atdheun e vet, pasi të flaken mediokrit: “Do të sjellim, DIELL! Do të të montojmë. Dhe do të zgjedhim në krye një Sekretar të Parë. o Diell... Dhe dielli dëgjonte këto fjalë të sinqerta, e shihte atë dorë që dëshëronte të votonte lirshëm. Dhe i fiakëruar e i bukur shpërndante drejtësi...” Populli duhet të votojë lirshëm për drejtuesit e vet dhe atëherë ai si do të dijë të zgjedhë njerëz të denjë, do të dijë të ndërtojë një rend racional, që shpërndan dritë e drejtësi. Kësaj rruge populli ynë i hyri pas kthesës rrënjësore të v.1990-1991. Sigurisht nuk mund të thuash se idealja “e dritës dhe e drejtësisë” u realizua plotësisht. Për këtë nevojitet kohë. Sidoqoftë rruga u gjet dhe varet prej përpjekjeve tona ritmi i ecjes në këtë rrugë.

Protagonistët e Novelës përmendin edhe dy mjete të tjera për katharsis: artin dhe miqësinë e vërtetë. Ata janë të bindur se roli i artit, i së bukurës, është kolosal dhe i pazëvendësueshëm, kur është fjala për ta pastruar moralisht jetën nga shëmtirat e deformimet dhe për ta humanizuar, fisnikëruar atë. “Arti duhet të përgatitë ditë më të mira... Të bëjë që e ardhmja të flakërojë”, thotë Djaloshi i Pashëm; që të

bukurën edhe artin e bukur e ka si "Marsejzë" të vetën.

Është ide e madhe dhe e lashtë prej shekujsh. Përmban një të vërtetë jetike që do të mbetet aktuale sa të jetë jeta. Embrionin e kësaj ideje e gjejmë tek teza e Aristotelit për katharsisin. E mbrojtën Kanti, Shileri, Gëte. E proklamoi Dostojevski me aforizmin: "Bukuria do të shpëtojë botën". Kjo ide lëviz e gjallon nëpër tërë lirikën e shkëlqyer naimiane të "Fjalët e qiririt". Është ideja bazë e fjalimit të Solzhenicinit më 1973, kur mori çmimin Nobel. Sa më qartë e thellë ta kuptojë e ta realizojë një shoqëri këtë ide, aq më mirë do të jetë për të.

Novela flet edhe për një mjet tjetër pastrimi, moral: për MIQËSINË e vërtetë midis njerëzve, midis intelektualëve. Sidomos midis artistëve. Miqësi që të mbështetet mbi parime të larta etike, mbi idealet e përbashkëta humaniste, demokratike e estetike. Novela përshkroi një tip të miqësisë të tillë, atë midis "Atyre të dyve". Rrëfyesi propozon diçka që mund të duket si emfatike e naive: Po sikur Lidhja e shkrimtarëve dhe e artistëve të oragnizojnë plenum të posaçëm kushtuar miqësisë së singertë midis artistëve të vërtetë? Rrëfyesi mediton: sa gjë e bukur të dëgjosh në radio e në televizor lajmin: "Vazhdojnë punimet e Plenumit të miqësisë parimore". Nuk është puna tek ndonjë plenum. Është thirrja që bëhet për ta çliruar atmosferën tonë artistike intelektuale, nga tërë ato gjëma që mbolli për dekada diktatura: nga frika, hipokrizia, konformizmi, nënshtrimi para zyrtarëve, heshtja e frikësuar, intriga. etj. Mos është kërkesë utopike kjo e Novelës? Po a nuk ekzistonte një atmosferë e mrekullueshme e shëndetshme, e pастër midis intelektualëve dhe krijuesve të Rilindjes sonë? Mos arriti vailë diktatura e zyrtarëve të shkulë nga rrënjët përgjithmonë këto lule të jetës shpirtërore kombëtare? Sigurisht që jo. Koha e demokracisë do të bëjë që të ringjallet e të zhvillohet trashëgimia e çmuar e kohës së lumtur rilindase. Të paktën këtë shpresë shpall e mbron Novela "Ata të dy e të tjerë..."

Nuk vriten vetëm njerëzit, shpirti dhe vullneti njerëzor. Vriten edhe krijimet e mendjes dhe të fantazisë, të shkencës dhe të artit (veçse këto zakonisht ringjallen).

Edhe Novelën "Ata të dy e të tjerë" e vranë me një nga ekzekutimet e llahtarshme mesjetare, kur të dënuarin e shqyenin me kuaj më katërsh. Novela u shqye më dysh: gjysma e trupit i mbeti në revistën "Nëntori" (Nr.4, v.1986), gjysma tjetër u gri në makineri. Figurat delikate artistike u kthyen në karton banal. Dhe kjo vrasje u shoqërua nga fyerja e rëndë e shpirtit të shkrimtarit tonë Koço Kosta dhe nga helmi i tërë atmosferës sonë letrare artistike.

Në këtë vëllim ribotohet i plotë verdikti i frikshëm zyrtar kundër Novelës (artikulli i "Nëntorit" në Nr.5, v.1986). Kësi gjërash nuk duhet të harrohen. Harresa është shumë e dobishme kur fshin nga mendja ngarkesat e tepërta. Por është gabim dhe faj kur ajo vërtit në lumin Lete kujtimin e ngjarjeve mësimdhënëse.

Dhe, siç dëshmohet, vepra botohet e plotë, njësh sot. Botohet dhe, sigurisht, lexuesi nisët që patjetër përveç vlerave artistike, do të kërkojë edhe atë realitet të zymtë të paradisavitësh që synoi të jepte autori. Bëj mendim se, për fat të keq, realiteti ynë i tanishëm, domosdo fare ndryshe nga dikur, nuk ka arritur t'i mënjanoj apo shtyjë në një masë të **dëshirueshme mjafton nga problemet e trishtuara që ngrihen në Novelë. MEDIOKRITETIN, sidomos (një mediokritet i shfaqur, ndryshe këtë rradhë). Dhe rryshfctin. Dhe zhvatjet!Përkundrazi. Përkundër. Përkundër.**

Dhe ky fakt, që nuk e dëshërojmë që nuk e dëshërojmë, ndihmon akoma që vepra të jetë edhe më e freskët, edhe më AKTUALE (Gjithsesi në këtë konstatim do të dëshiroja të isha i pasaktë, të mos kisha të drejtë!)

Më poshtë do të paraqes kryesisht një kronikë të shkurtër të atyre që ngjanë. Një kronikë e thjeshtë, për tragjizmin e artistit e të artit në diktaturën moniste. Të shumë kanë qenë artistët tanë që u përfshinë nga vorbulla e tragjizmit. Rasti i K.Kostës është një ndër më flagrantët.

8

Siç thamë, në Nr.4,v.1986 në "Nëntori" u botua pjesa e parë e novelës "Ata të dy e të tjerë". Vepra ngjalli interes të veçantë. Pritej me kërshtëri pjesa e dytë në Nr.5. Po në vend të saj ndodhi një lëkundje sizmike e frikshme, që e kishte epiqendrën në pultin e komandës së diktaturës. U duk hapur se kjo Novelë kishte fyer, zemëruar, tërbuar dikë lart, tepër lart, në sferën eprore të Olimpikut. Dhe, si në ethe, aty u vendos fati i Novelës, i Autorit dhe i të tjerëve. Dhe u vendos nga njerëz krejt profanë në çështjet e artit, të estetikës. Ata nuk donin t'ia dinin për shije letrare dhe as për dinjitetin artistik;

Nisi kështu kryqzata antiartistike, një nga më të rëndat që ka përjetuar arti ynë nën diktaturën. (Pak më parë ishin kritikuar zyrtarisht dy krijime në prozë: e I.Kadaresë dhe e F.Arapit).

Ai shtet aq i pazoti në fushat ku lipsej kulturë, mençuri e vitalitet, e zotëronte në mënyrë të përsosur mjeshtërinë, për të organizuar netë të Shën Bartolomeut në jetën shoqërore-politike, artistike.

9

U dha urdhër të bllokohej **Novela që kishte nisur të qarkullonte**. Të hidhej në karton Nr. 5 i "Nëntorit" (një sasi

revistash Nr.5 u rrëmbye në shtypshkronjë dhe u lexuan fshehtaz). Dy drejtuesit e revistës, D.Shapilo dhe Xh.Spahiu u larguan nga revista.

Në KQ të PPSH u bënë moledhje me kuadro kryesorë të lëmit ideologjik. Ky aeropag do të drejtonte kryqëzatën në Tiranë dhe në rrethe.

U vendos të botohej një artikull kritik në "Nëntori" ku verditiktit barbar të Olimpfit kundër Novelës, do t'i jepej një veshje "teorike-estetike". Ky është artikulli që autori kërkoi vetë të botohet në këtë vëllim. Domethënë: të ribotohet.

Në jetën letrare artistike shqiptare, që nga koha mitike e Barletit dhe e Buzukut e deri në mes të shek.XX kurrë nuk kanë ndodhur atentate kaq të frikshme sa ato të kryera nga diktatura moniste në 45 vjetët e saj. Dhe ky artikull, me tërë ato që pasuan, është nga shfaqjet më të shëmtuara të arbitraritetit diktatorial në art tek ne. Aty Novela paditet për tërë asortimentet e mundëshme të mëkateve. Deri dhe për homoseksualizëm (ndërsa ajo flet për miqësi vëllazërore artistësh). Për vulgaritet (kurse ajo është plot deiikatëse). Për gjuhë të shturur e të varfër (kur dihej se krijimtaria e K.Kostës shënon një nga kulmet e përdorimit mjeshtëror të gjuhës në prozën tonë). Për mungesë të plotë arti (kurse Novela, siç e pamë, është vepër novatore, me konceptim poetik, gjithë lirizëm e finesë dhe bënte thirrje në mbrojtje të artit të mirëfilltë, të krijimit të lirë, të atmosferës së miqësisë, të sinqertë midis artistëve).

Vepra kishte goditur thundrën e Akilit. E pamë se shumë nga akuzat e artikullit kishin bazë reale dhe ishin të mjafta për ta tërbuar Përbindëshin zyrtar. Ja ndonjë nga "mëkatet" reale, ashtu siç formulohen në artikullin e "Nëntorit": "...Në të, në planin politik, çdo gjë është vënë së prapthi... Realiteti ynë mohohet... Novela është plot mllef kundër ish-partizanëve, që... tani po e mjelin socializmin... Nuk vjen asnjë jehonë e aksioneve revolucionare... S'ka asgjë të përbashkët me realizmin socialist," Dhe mbi të gjitha: "*Novela shpreh mosbesim ndaj Partisë dhe vijës së drejtë të saj*".

Këto nuk ishin shpifje; veçse nuk përbënin "mëkat", por

ishin meritë e madhe e Novelës, që është vepër disidente me vlerë estetike. Dhe që arriti të botohet. Dhe që u godit publikisht.

Artikulli i "Nëntorit" që flamuri teorik i kryqzatës. Me urdhër me shkrim, sipas porosisë së KQ, u ngarkuan zyrtarisht tërë degët e LSHA që të mbledheshin dhe të goditnin Novelën, sipas artikullit orientues. Duhej krijuar klima e "revoltës unanime" të mbarë frontit artistik kundër frymës së Novelës.

10

Kryesia e LSHA deomos që e dënoi rëndë Novelën. Dhe pas saj, gjithë degët me radhë. Gjë fort e dhimbshme të shikoje si krijues, ndër më të shqurait (të gjithë të njohur të K.Kostës e disa dhe miq të afërt të tij), detyroheshin tani të asistonin në ceremoninë e kobshme të torturimit moral të kolegut, apo dhe mikut të tyre dhe të shqyerjes së një vepre të talentuar; të mos nxirrin dot nga goja fjalët e mëshirës dhe të keqradhjes që ua thoshte zemra. Pushkini në poezinë "I ndërtova vetes një monument" guxoi e shkroi: "Kërkova mëshirë për të rënë". Por në enverizëm mëshira humane ishte faj i pafalshëm.

Ky ka qenë një nga krimet më të zeza të diktaturës ndaj personalitetit e dinjitetit të artistëve tanë.

Se ç'bëhej në disa degë, ku goditja amplifikohej, e dëshmon ky detaj (sipas gazetës "Alternativa SD" e 16.8.1991): Kryesuesi i mbledhjes në Elbasan kërcënohej: "Pa çohu ti...! Pse hesht ti për novelën reaksionare të K.Kostës?! Solidarizohesh ti me mendimin e autorit?" Dhe; "i ziu njeri, që të shpëtonte nga një qarkullim i ri, propozonte të varej K.Kosta". Komike, por përmban thelbin e së vërtetës. Në mbledhjen e Fierit, ku banonte familjarisht K.Kosta, nja dy ultra thirrën: "Të arrestohet! Të arrestohet!" Pra gjatë kryqëzatës u kultivua një atmosferë delirante frikësimi, shantazhi, pasigurie të padurueshme për artistët e vërtetë. Kur K.Kosta që kishte aq

emër në letërsi, zvarritej kësisoj, ç'mund të pritnin të tjerët?
Kështu nxitej autocensura.

1 1

Për autorin vendosën edhe këto masa ndëshkimi: të përjashtohesh nga Komiteti drejtues i LSHA, madje edhe si anëtar i Lidhjes; t'i hiqej orari i reduktuar dhe e drejta e lejes krijuese; të përjashtohesh nga lista e kandidatëve për profesion të lirë; mbi të gjitha, *t'i hiqej e drejta e botimit për tre vjet. U-pushua nga puna dhe, me miratim nga lart, u dërgua në prodhim në një fshat të largët "për riedukim".*

Në ritualin e shenjtë të kurbaneve të tilla monizmi përherë parashikonte edhe autokritikën e mëkatarit. Përndryshe vringëllonte edhe më egër sopata mbi rebelin dhe mbi familjen. "Fajtori" duhej të thërrisre: "Mea culpa, mea maxima culpa!" (Ky ritual ishte trashëguar nga stalinizmi. Le të kujtojmë mbledhjet alla-Zhdanov, apo tablonë e dënimit të "Doktor Zhivagos" në romanin e Kadaresë). Njerëz si S.Malëshova, M.Kokalari, K.Trebeshina apo M.Myftiu etj, që i mbrojtën hapur veprat dhe pikëpamjet e veta "heretike", kanë qenë të rrallë në Evropën Lindore.

"Autokritikën" me shkrim K.Kosta e ndërtoi me mjaft shkathtësi. Po këtë "shkathtësi" e diktoi aparati i KQ, prandaj në një mbledhje tjetër partiaku i Fierit uluriti, duke tundur lart letrën e autokritikës: "Kjo autokritikë është formale...Trego se kush e ka lexuar novelën në dorëshkrim. Nga kush je nxitur?"

Po nga goja e K.Kostës nuk doli asnjë fjalë kompromentuese për askënd, asnjëherë.

Ato që kanë ndodhur në Fier, janë përshkruar nga K.Kosta me hidhërim, por edhe me humorin e tij karakteristik, në një letër që ai ato ditë e dërgoi dorazi me njeri të sigurtë. Kjo letër dhe disa të tjera të po asaj kohe që disponojnë miqtë e tij, janë dokumente psikologjike interesante.

Domosdo që ekzistonte edhe rreziku i arrestimit. Shumëkush ishte i bindur për këtë. Partia ku i Fierit i komunikoi Koços: "Edhe sekretari i parë (anëtar i Byrosë Politike të KQ) tha: Novela është fashiste. Bën thirrje. Duhet të hyjë në burg..."

Shkrimtari u përgatit për më të keqen. Në një letër ai shkruante: "Shpresoj të mos turpëroj djalin, vajzën, gruan e të tjerë. Do ta ruaj dinjitetin. Po ndodhi ndryshe e të më lenë pa shresë, do të vras veten. Po nuk jam aq i dobët". Në një letër tjetër prekëse ai linte amanet familjen. (Sa e sa artistë tanë kanë përjetuar çaste të tilla!) Nuk e arrestuan, por siç e pohon, ankthi i gjatë i pritjes ishte më i rëndë se vetë goditja. Ishte mësuar me përndjekje: për më se 15 vjet e kishin mbajtur si mësues të 8-vjeçares nëpër fshatra të largëta, ndonëse ishte shkrimtar i afirmuar. Me urdhër të aparatit të KQ më 1972 romanit të tij të parë, "Qafa e botës" iu hoq çmimi i parë në konkursin kombëtar dhe u tërhoq edhe nga shtypshkronja ("për gabime ideore"); Më pas në Gjirokastër i dhanë një dënim prej 6 muajsh me punë fizike me akuzën qesharake "për punë agjenturore". Akuzë që u hodh poshtë. Po sidoqoftë goditja e vitit 1986 ishte dërmuese.

E dërguan në kooperativën e Greshices, një nga fshatrat më të largëta të Mallakstrës. Ishte kohë korrjeje. Që ditën e parë i dhanë në dorë një kazëm e një drapër. Banonte në një kasolle balte dhe aty i futën edhe një ish-"të burgosur" të Spaçit. Shkonte rrallë në familje. Nuk po përmend privacionet ekonomike dhe fyerjet cinike të zyrtarëve dhe rrugaçëve. As karantinën.

Pas gjashtë muajsh një vendim i ri: emërim në arsim në tetëvjeçare. Por ama sërish në fshat. Në Liboishë. Sikur të ishte zgjedhur me dorë, për ta munduar: duhej të nisej për në fshat

në orën 4, pa gdhirë, se s'kishte tren tjetër për aty. Dhe të kthehej natën me trenin e orës 22.00. Ose të priste në shi o në vapë buzë xhadesë për ndonjë makinë të rastit. Dhe ishte me shëndet të drobitur. Si kaloi viti shkoilor, mori guximin dhe deklaroi se nuk do të shkonte më në atë fshat. Pas shumë sorollatjesh groteske duke e lënë pa punë: pa rrogë shtatë muaj e emëruan mësues në Fier. Përherë mbeteshin në fuqi sanksionet e tjera, sidomos ndalimi për botim. Emri s'i përmendej gjëkund në shtyp. Por kohët po bëheshin përherë e më të vëshira për zyrtarët arbitrarë, që vazhdonin ta martirizonin shkrimtarin. Për K.Kostën foli dhe masmedia e huaj, që nga SHBA deri te BS e Gorbaçovit. U dëgjua edhe zëri dinjitoz i kolegëve vëllezër kosovarë: Isuf Berisha dhe Shkëlzen Maliqi, në gazetën "Fjala" më 1.1.1987. në kryeartikullin ata shkruanin: "K.Kosta qysh në shkrimet e para u imponua me talentin dhe individualitetin e vet krijues dhe si i tillë u çmua lart nga kritika letrare... Na mbetet vetëm të shpresojmë se redaksia e "Nëntorit" do ta kuptojë se *ndalimi i botimit të pjesës së dytë të kësaj proze është me pasoja të shumta negative...*"

Dhe e cilësojnë K.Kostën: "shkrimtar i cili për mendjen tonë *hyn në rradhën e prozatorëve më të mirë të gjeneratës së vet*".

14

Megjithatë mllëfi zyrtar shfaqej herë-herë deri në forma absurde, tejet qesharake. Goditja e fundit: në dhjetor 1990?i m'u në prak të kolapsit të plotë të monizmit, kur sapo ishte shpallur pluralizmi partiak dhe kur ishte krijuar partia e parë opozitare: KE i KP të rrethit të Tiranës lajmëron me një shkresë se nuk aproven propozimin e Lidhjes për ta emëruar K.Kostën në Shtëpinë Botuese të LSHA! Mirëpo cikli i monizmit ishte mbyllur. Po niste cikli i demokracisë dhe i lirisë artistike.

Novela e K.Kostës ka mbetur vepër e freskët, madje është si e rinuar. Është vepër arti, nga ato që s'i vret dot veçse përkohësisht.

Po Olimpi monist, kryqëzatat e tij, artikulli - verdikt e të tjera shëmtira ku janë sot vallë?

III

15

Edhe unë kam qenë: e di se në ç'dhomëz "të bukur" përdhese, të paprekur kurrë nga një rreze dielli, tërë lagështi edhe në muajin qershor, banon prej katër vitesh ende familjarisht Koço Kosta sot në Tiranë.

TRIMGJATA

Qershor 1994



SHQIPTARET...

*«As në qeverit
as në besët nuk
donin një vetë, që
bën ç'do, po u
kish ënda këshi-
llën e kuvendin' e
shumëve»*

Samir Frashëri